



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Kolegji Universitar “I Biznesit”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Jola BODE

Prof. Asoc. Dr. Artan SPAHIU

Tetor / 2025

Tabela përmbledhëse e të dhënave të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR nr.236, datë 15.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike / 10 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shatatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2020-2021– 7 PAE / 1 PAK; Viti akademik 2021-2022– 9 PAE / 5 PAK; Viti akademik 2022-2023– 17 PAE / 8 PAK; Viti akademik 2023-2024– 17 PAE / 5 PAK; Viti akademik 2024-2025– 15 PAE / 12 PAK; Ngarkesa mësimore 2024-2025 70.1% PAE / 29.9% PAK;

18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2020-2021– 13 studentë; Viti akademik 2021-2022– 11 studentë; Viti akademik 2022-2023– 16 studentë; Viti akademik 2023-2024– 22 studentë; Viti akademik 2024-2025– 32 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si njësi kryesore në përbërje të Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB). KUB është institucion i arsimit të lartë jo publik i licencuar me VKM nr. 651, datë 14.09.2011, “Për licencimin si Institucion i Arsimit të Lartë”. Ky institucion ka nisur aktivitetin akademik në vitin akademik 2011-2012, fillimisht me emërtimin “Akademia Profesionale e Bisnesit” me urdhërin nr. 3, datë 04.01.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me një përbërje prej dy fakultetesh, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë.

Me Urdhërin nr 39, datë 30.01.2018, është riorganizuar duke shtuar në përbërje edhe një njësi tjetër, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale. KUB ka realizuar akreditimin institucional në vitin 2012 dhe më tej, akreditimet periodike në vitin 2017 dhe 2022. Me vendim nr. 3, datë 07.01.2022, “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar i Biznesit” është akredituar institucionalisht për 4 vite akademike. Vlefshëmëria e akreditimit është deri më datë 06.01.2026. Gjatë vitit akademik 2020-2021 me urdhërin nr. 236, datë 15.07.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka riorganizuar programet e studimit Bachelor në “Drejtësi” dhe “E drejtë Bisnesi” në Programin e Integruar të Nivelit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”.

Programi i Integruar i Nivelit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, është një program studimi i cili ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Ky fakultet ka në përbërje tre njësi bazë:

1. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;

Ky program studimi akreditohet dhe diplomon studentët për herë të parë. Programin e Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” është i cili realizohet në një kohëzgjatje normale

prej 5 (pesë) vite akademike me 300 ECTS. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë: Master i Shkencave në “Drejtësi”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit synon paisjen e studentëve me njohuritë themelore shkencore në të gjitha disiplinat, duke u ofruar mundësinë e konceptimit të vlerës teorike, praktike, studimore dhe aplikative të parimeve dhe normave juridike në veprimtarinë e shoqërisë dhe institucioneve të saj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve të institucionit për akreditimin për herë të parë të Programit të Integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” zhvilluar pranë Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale të Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale të Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB).

Në përputhje me kërkesën e KUB për nisjen e procedurës së akreditimit të Programit të Integruar të cilit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë caktoi: **Prof. Asoc. Dr Jola Bode si dhe Prof. Asoc. Dr Artan Spahiu** si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e Programit të Integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqësuesja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Procedura e vlerësimit të jashtëm filloi me trajnimin e grupit të vlerësimit të jashtëm pranë ASCAL, vijoi me takime paraprake për shqyrtimin e dokumentacionit, ndarjen e punës dhe organizimin e vizitës pranë institucionit si dhe hartimin e axhendës së takimeve. Përfaqësuesja e ASCAL dërgoi axhendën e takimeve pranë institucionit i cili konfirmoi dakortësinë e tij.

Vizita në Kolegjin Universitar të Biznesit, u realizua në datën 04 dhe 05 Qershor 2025. Në përputhje me axhendën e takimeve, GVJ, gjatë vizitës dy ditore realizoi takimet me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si dhe Përgjegjësen e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Zyrës së Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës etj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi gjithashtu vizita pranë Sekretarisë Mësimore, bibliotekës si dhe vëzhgoi në tërësi ambientet e zhvillimit të mësimin për këtë program studimi. Pas vizitës në institucion, GVJ pasi diskutoi problematikat e paraqitura dhe rishqyrtoi të gjitha materialet e vëna në dispozicion nga institucioni, filloi punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ). Raporti i Vlerësimit të Jashtëm bazohet në dokumentacionin e dosjes së vetvlerësimit depozituar nga institucioni, e aksesueshme në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e marrë gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara nga GVJ në institucion.

Kolegji Universitar "I Biznesit", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 97/17 Prot, datë 01.10.2025. Kolegji Universitar "I Biznesit", më datë 10.10.2025, njofton, me anë të shkresës me Nr.524 Prot, datë 08.10.2025 "*Dërgohen komente mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e integruar të studimit ...*".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Në lidhje me komentin për konkluzionin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e **Standardit I.1, Kriteri 3:**

GVJ merr në konsideratë komentin e institucionit, bazuar në evidencën e paraqitur, "*Rregullorja e Programit të Studimit MSH në Drejtësi*", miratuar me Vendim të Senatit Akademik të KUB Nr. 10. datë 17. 09. 2020. Raporti në këtë pikë ndryshon. Si, konkluzion, Standardi I.1, do të konsiderohet se "përmbushet plotësisht".

2. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e **Standardi 1.2, Kriteri 1;**

GVJ ka konstatuar gabimin në plotësimin e evidencave (nr.4, nr.6.3 dhe dok.nr.84) dhe nuk është shprehur nëse kemi të bëjmë me gabim material apo gabim substancial. Bazuar në sqarimin dhe komentin e IAL-së, GVJ e ndryshon formulimin e konstatimit në Standartin 1.2, Kriteri 1, në këtë mënyrë: "**Sa më sipër, nga GVJ konstatohet si gabim material plotësimi i evidencave (nr.4, nr.6.3 dhe dok.nr.84)**".

3. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e **Standardi 1.2, Kriteri 2;**

GVJ e merr në konsideratë komentin e institucionit, duke e pranuar atë. Raporti në këtë pikë ndryshon, duke e hequr nga RVJ konstatimin "**Gjykohet se bashkimi i fushave të studimit të ekonomisë, drejtësisë dhe shkencave sociale në një fakultet të vetëm, nuk krijon kushte optimale për të ofruar programin e integruar 5 vjeçar të drejtësisë**".

4. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e sqarimin/komentin e **Standardi 1.2, Kriteri 3;**

Në kushtet kur ky konstatim është evidentuar edhe në trajtimin e Standartit II.2, GVJ e ndryshon raportin sa i përket konstatimeve të këtij kriteri. Raporti në këtë pikë ndryshon duke e hequr nga RVJ konstatimin "**Nga GVJ gjykohet se duhet të shtohet stafi i brendshëm i këtij departamenti për të krijuar kushte optimale për të ofruar programin e integruar 5 vjeçar të drejtësisë.**"

5. Në lidhje me komentën e paraqitur në shkresën e IAL-së, se “Standardi I.2, duhet të konsiderohet “përbushet plotësisht”:

GVJ nuk është dakort me konkluzionin pasi IAL ka angazhuar në mësimdhënie edhe staf akademik me kualifikimin “Master Shkencor”, ndërkohë që kjo bie ndesh me kërkesat e nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015. **Për rrjedhojë raporti nuk ndryshon dhe Standardi I.2, konsiderohet “përbushet kryesisht”.**

6. Në lidhje me komentën për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përbushjen e **Standardit I.3, Kriteri 4:**

Nga GVJ, në përbushje sa më të mirë të kriterit të standartit është sugjeruar, apo rekomanduar që nga Fakulteti apo Departamenti përgjegjës të hartohen raporte periodike edhe më të detajuara, apo më analitike, për çdo fushë të bashkëpunimit të parashikuar në marrëveshje dhe jo vetëm për mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të projekteve Erasmus. **Ky rekomandim nuk e cënon përbushjen e standartit I.3 që konsiderohet se “përbushet plotësisht”.**

7. Në lidhje me komentën përmbysës të fushës I, sipas të cilit nga IAL pretendohet se shkalla e përbushjes së Fushës I – “Ofrimi i programit të studimit”, duhet të konsiderohet se “përbushet plotësisht”:

GVJ nuk është dakort me këtë koment, por mbetet në qëndrimin se niveli i përbushjes së standarteve të Fushës I “Ofrimi i programit të studimit”, të konsiderohet se “Përbushet kryesisht”.

8. Në lidhje me komentën për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përbushjen e **Standardit II.2, Kriteri 1:**

GVJ në këtë pikë i mbetet qëndrimit të mbajtur në raport. Kjo sepse nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, me një staf vetëm me 8 pedagogë si staf akademik të brendshëm, mbulohen 1 program i integruar (PICD) në drejtësi, 2 MSH në drejtësi dhe 2 Bachelor në shkencë sociale (“Marrëdhënie ndërkombëtare”, “Diplomaci dhe Studime evropiane”). Sipas standarteve të cilësisë të arsimit të lartë, stafi akademik i njësisë bazë duhet të ketë fushë akademike dhe kërkimore në përputhje me programet e studimit që afron departamenti. **Duke qenë se ky departament mbulon programe studimi që i përkasin edhe fushave të kërkimit të shkencave sociale dhe jo vetëm drejtësi, nga GVJ gjykohet se duhet të shtohet stafi i brendshëm i këtij departamenti për të krijuar kushte optimale për të ofruar programin e integruar 5 vjeçar të drejtësisë.**

9. Në lidhje me komentën për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përbushjen e **Standardit II.2, Kriteri 3:**

Nga GVJ është verifikuar formalisht plotësimi i kërkesave të standartit, si dhe i parashikimeve të Rregullores së Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, ku në nenin 9 “Funksionet dhe Detyrat e Përgjegjësit të Departamentit”, pika 2/b, parashikohet se: “Drejtuesi i Departamentit ka detyrë: *...(b). Të mbikqyrë dhe monitorojë gjithë procesin e përgatitjes, rishikimit, përmirësimit dhe realizimit të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, që mbulon Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Kur e gjykon të nevojshme Drejtuesi i Departamentit, cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori informon vazhdimisht drejtuesin e njësisë përkatëse, për ecurinë e programit të studimit*”. Në këtë aspekt, nga GVJ nuk u konstatua asnjë akt formal për caktimin/emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe as ndonjë raportim formal i koordinatorit për drejtuesin e Departamentit.

Gjithsesi, pas paraqitjes së komenteve nga IAL-ja, nga GVJ merret në konsiderate evidenca shtesë: Urdhëri i Rektorit të KUB, Nr.357 prot. datë 08.10.2024 “Për caktimin e Koordinatorit të Programit të Integruar Master i Shkencave në Drejtësi”, ku disponohet për mërimin e Dr.Bajram Ibraj në pozicionin e Koordinatorit të Programit të Integruar “Master i Shkencave në Drejtësi”. Raporti i vlerësimit të jashtëm ndryshon në lidhje me këtë pikë, sa i përket Koordinatorit të Programit.

10. Në lidhje me komentin, sipas të cilit nga IAL pretendohet se shkalla e përmbushjes së standartit II.2 duhet të konsiderohet se “përmbushet plotësisht”:

GVJ është dakort me këtë koment, duke konsideruar se niveli i përmbushjes së standartit II.2 është “Përmbushet plotësisht”.

11. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e Standardit II.4, Kriteri 4:

Nga GVJ është rekomanduar të punohet më shumë në këtë drejtim, duke siguruar pjesëmarrjen e sa më shumë studentëve të këtij programi studimi në projektet Erasmus +. **Ky rekomandim nuk e çënon përmbushjen e standartit II.4 që konsiderohet se “përmbushet plotësisht”.**

12. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e Standardit II.6, Kriteri 4:

GVJ i është referuar evidencave të RBV (Tabela nr.18 “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit”), nga ku rezulton se të ardhurat nga grandet për kërkim dhe kontratat e projekteve zënë një peshë të vogël në të ardhurat e IAL-së. Kështu për vitin 2021 dhe 2022, të ardhurat nga grandet për kërkim dhe kontratat e projekteve janë 0.6% të të ardhurave të IAL-së, ndërsa në vitin 2023 janë 0.51% (pra janë ulur). **Sa më sipër, GVJ ka sugjeruar që të punohet më shumë për shtimin e nivelit të të ardhurave nga grandet për kërkim dhe kontratat e**

projekteve. Ky rekomandim nuk e cënon përmbushjen e standartit II.6 që konsiderohet se “përmbushet plotësisht”.

13. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e Standardit III.1, Kriteri 3:

Nga GVJ është konstatuar se nuk provohet që KUB të ketë organizuar trajnime për stafin akademik dhe administrativ. Evidenca nr.99, të cilës i referohet IAL-ja, nuk i referohet trajnimeve që kanë ndihmuar në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe didaktike të stafit. Evidenca nr.99 i referohet “Programit Ndërmjetës i Pasurive të Paluajtshme”, program i cili ka si qëllim aftësimin profesional të Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme dhe certifikimin e tyre me qëllim Licensimin për ushtrimin ligjor të aktivitetit të tyre profesional nga Ministria e Drejtësisë. **Sa më sipër, Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

14. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e Standardit III.4, Kriteri 6:

Në raport evidentohet se nuk rezulton e provuar se nga KUB se janë marrë masa konkrete për të mbështetur financiarisht dhe institucionalisht nismat studentore. Në këtë kuptim nga GVJ është sugjeruar që nga IAL të merren masa që të promovohet financiarisht çdo inisiativë (projekt kerkimor, studim) për zhvillimin e ideve inovative nga studentët e programit të integruar të studimit “Msc në Drejtësi”. **Sa më sipër, Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

15. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e Standardit III.6, Kriteri 3:

IAL në komentet e saj i referohen Evidencës nr.27 të ngarkuar në sistem. Nga verifikimi i GVJ u konstatua se në paketën e dokumentave bashkëngjitur RVB-së, evidentohet një dokument (Dok. 27) me emërtimin “Udhëzues për Përgatitjen e Praktikës Profesionale” me dy dokumenta me emërtimin: 1. Model raporti TIP për kryerjen e praktikës; 2. Marrëveshje bashkpunimi TIP për Praktikën Profesionale. Në fakt ky emërtim është vetëm titulli i dokumentit, i cili nuk i korrespondon përmbajtjes reale të këtij dokumenti. Pasi aty janë bashkëngjitur dokumentat e përgatitjes së temës së diplomës dhe nuk ka asnjë dokument për procedurat e praktikës profesionale. Për këtë arsye, nga GVJ sugjerohet që nga KUB të miratohet një udhëzues i plotë për procedurat, afatet dhe modelet e dokumentave që duhet të hartojë studenti për të plotësuar detyrimet e praktikës profesionale, sipas kërkesave të planit mësimor. **Sa më sipër, Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

16. Në lidhje me komentin për konstatimin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e Standardit IV.1, Kriteri 1:

Bazuar në informacionin e siguruar nga evidencat përkatëse, GVJ ka rekomanduar që institucioni të mundësojë që i gjithë stafi akademik që përfshihet në procesin e mësimdhënies në këtë program

studimi të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Gjithashtu ka rekomanduar që në rastet kur personeli akademik mbulon më shumë se sa një lëndë mësimore/modul, ngarkesa të mundësojë mbulimin e lëndëve që kanë natyra, veçori, dhe fusha studimore të përafërta dhe përputhen me fushën akademike kërkimore të personelit akademik që mbulon këto lëndë/module. IAL në komentet e saj mbi këtë konstatim nuk ka referuar në evidenca konkrete për të mbështetur këto komente. **Sa më sipër, Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Integruar të Nivelit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave në “Drejtësi” është program studimi që ofrohet për një kohëzgjatje 5 vjeçare, me 300 ECTS. Programi i studimit është riorganizuar nga Bachelor në “Drejtësi” dhe Bachelor në “E Drejtë Biznesi” në Program të integruar “Master i Shkencave në Drejtësi”, me Urdhërin e MASR Nr. 236, date 15.7.2020, ku në pikën 1 është disponuar: <i>“Riorganizimi për shkak të ligjit të programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Drejtësi” dhe “Bachelor” në “E Drejtë Biznesi” me 180 kredite, në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi” që realizohet me 300 kredite dhe kohëzgjatje normale 5 vite akademike (10 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë”</i>. Pra IAL-ka ka riorganizuar dy programe Bachelor në 1 Program PICD “Msc”. Ky program ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësi bazë pjesë përbërëse e Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, në Kolegjin Universitar të Biznesit. Në përfundim studenti pajiset me diplomë universitare “Master i Shkencave” në “Drejtësi”.

	Programi i integruar i ciklit të dytë të studimit "Master i Shkencave në Drejtësi" nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ai mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026; <i>Urdhëri i MASR Nr. 236, date 15.7.2020 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Drejtësi" dhe Bachelor në "E drejtë biznesi", në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", në Kolegjin Universitar të Biznesit".</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është në përputhje me misionin e KUB, i cili është <i>"Të formojë specialistë të lartë dhe shkenctarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standartve të demokracisë në vend"</i> (neni 4, gërma "a" e Statutit të KUB). Ai ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë të KUB dhe Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Ai ka si synim formimin e specialistëve në fushën e Drejtësisë, duke u fokusuar në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave që lidhen drejtpërdrejt me këtë fushë. Kjo pasqyrohet në kurrikulën e programit të studimit dhe në planin mësimor. Në mbështetje të nenit 20(5), të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kolegji Universitar ofron programe studimi në ciklin e parë dhe/ose të dytë të studimeve dhe programe studimi me karakter profesional. Programi në vlerësim (Msc në "Drejtësi") është program i ciklit të dytë të studimeve, specifikisht <i>program i integruar i studimeve të ciklit të dytë</i>, në fushën e drejtësisë, i organizuar me 300 kredite dhe me kohëzgjatje pesë vite akademike (neni 75, pika 3, gërma (b) e Ligjit Nr.80/2015). <i>Evidenca nr.2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026" dhe "2024-2030";</i> <i>Evidenca nr.32 "Dosja e programit të studimit" "Kurrikula e Programit MSHD" dhe "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi";</i>

	<i>Urdhëri i MASR "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Drejtësi" dhe Bachelor në "E drejtë biznesi", në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", në Kolegjin Universitar të Biznesit";</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi" është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të Statutit të KUB (neni 4), Planit Strategjik të Zhvillimit të KUB 2021-2026 (dok.2); Rregullores së Programit të Studimit (doc.7). Programi realizohet në përputhje me strategjinë e institucionit, të parashikuar në "Planin Strategjik të Zhvillimit të KUB "2021-2026" dhe "2024-2030". Sipas Planit Strategjik 2024-2030 misioni i IAL-së (KUB) deri në vitin 2030 është "Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë kërkues dhe shkenctarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen ekonomisë dhe standartve të demokracisë në vend". Rregullorja e Programit të Studimit MSH në Drejtësi është miratuar me Vendim të Senatit Akademik të KUB Nr. 10 datë 17. 09. 2020. Kjo rregullore është miratuar përsëri me Vendim të Senatit Akademik të KUB nr.25, datë 25.11.2024, pas riorganizimit të Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Me të njëjtin vendim Senati (nr.25, datë 25.11.2024) janë miratuar edhe Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si dhe Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. <i>Evidenca "Statuti i KUB" - Statuti i Institucionit të Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar i Biznesit", miratuar me Urdhër Nr. 39 datë 10.01.2018 të MASR, ndryshuar me Urdherat: nr. 361 datë 23.12.2020; nr, 113 datë 25.05.2021; nr. 505 datë 08.09.2023 dhe nr, 567 datë 12.1 1.2024, me ndryshime në zbatim të shkresave Nr.954 dhe Nr.959, datë 05.02.2024 dhe Nr.6074/3, datë 18.11.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</i> <i>Evidenca nr.2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026" dhe "2024-2030";</i> <i>Evidenca Dok.nr.5 "Rregullore e FEDSHC";</i> <i>Evidenca Dok.nr.6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale";</i> <i>Evidenca nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit".</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e	Programi i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi" është hartuar dhe zhvillohet duke pasur parasysh interesat kombëtare

zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit. Ky program është zhvilluar në përputhje me strategjitë kombëtare: -Strategjinë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020. -Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, ku ndër fushat me prioritet për integrimin e vendit në BE pëcaktohen <i>"Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve gjyqësore; Rritja e luftës kundër korrupsionit; Rritja e luftës kundër krimit të organizuar; Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat mbi pronën"</i>. -Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë 2021-2025 e cila ka në fokus që në fazën e parë <i>"Përqasjen e sistemit të drejtësisë në Shqipëri me standardet më të mira evropiane"</i>. Gjithashtu, programi i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi" është hartuar dhe zhvillohet duke pasur parasysh jo vetëm interesat kombëtare por edhe prirjet e zhvillimit global.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KUB ofron programin e integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Drejtësi", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, duke synuar në ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i> <i>Si mangësi konstatohet se "Rregullorja e Programit të Studimit MSH në Drejtësi" është e miratuar me Vendim të Senatit Akademik më datë 25.11.2024, në vitin e fundit akademik të këtij programi studimi 2024-2025, duke mos patur një rregullim të brendshëm specifik ky program për 4 vitet akademike të mëparshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Kolegji Universitar i Biznesit është krijuar sipas VKM Nr.651, datë 14.9.2011 “Për licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit”, me emërtimin fillestar *Akademia Profesionale e Biznesit* dhe i organizuar fillimisht me dy fakultete: *Fakulteti i Ekonomisë* dhe *Fakulteti i Drejtësisë*. Fakulteti i Drejtësisë fillimisht ofronte dy programe studimi të ciklit të parë: Bachelor në “Drejtësi” dhe Bachelor në “E drejtë biznesi”, të cilat sipas Urdhërit të MASR Nr. 236, datë 15.7.2020, janë riorganizuar, për shkak të ligjit, në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi” me 300 kredite.

Me Urdhërin nr 39, datë 30.01.2018, KUB është riorganizuar duke shtuar në përbërje edhe një njësi tjetër kryesore, *Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale*.

Me Urdhërin e MASR nr.113, datë 25.05.2021 “Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar të Biznesit”, *Fakulteti i Drejtësisë* i KUB është riorganizuar në *Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale*. Ky i fundit ka në përbërje tre njësi bazë:

1. **Departamenti i Drejtësisë;**
2. Departamenti i Shkencave Politike;
3. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Me Urdhërin e MASR nr.165, datë 16.04.2024 “Për hapjen dhe riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar të Biznesit”, dy fakultetet *Fakulteti i Ekonomisë* dhe *Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale* është riorganizuar në një të vetëm: *Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale*. Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, ku përfshihet edhe programi i studimit objekt vlerësimi dhe akreditimi, ka në përbërje tre njësi bazë:

1. Departamenti i Menaxhimit;
2. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
3. **Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;**

Stafi akademik i Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale është i kualifikuar dhe i përmbush kriteret ligjore të kërkuar nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, si njësi bazë që ofron këtë program studimi (neni 25, pika 4 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se “*Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të*

	<i>punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë”).</i> Për vitin 2024-2025, ky Departament ka gjithsej 16 pedagogë, nga të cilët 8 janë pedagogë efektiv me kohë të plotë (PAE), nga ku: - 2 ka titullin “Profesor i Asociuar”; - 6 kanë gradën Dr; dhe 8 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 1 ka titullin “Prof.Dr”; - 7 kanë gradën Dr.; Konstatohet se aktualisht, KUB i ka kapacitetet akademike, të kërkuara si kriter ligjor, për këtë program studimi. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga personel akademik i kategorisë “Profesor”, “Lektor” “Asistent Lektor” i punësuar si PAE dhe PAK. Si mangesi nga GVJ u konstatua se: a. Nga verifikimi i dokumentacionit (Tabelat nr.6 dhe 7, ankes RVB) konstatohet angazhimi në mësimdhënie edhe i stafit akademik (PAE dhe PAK) me kualifikimin “Master Shkencor”, çka bie ndesh me kërkesat e nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015, ku parashikohet se: <i>“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”</i>. b. Nga kryqëzimi i informacionit të Tabëlës nr.2 “Departamenti Përgjegjës”, Tabelës nr.4 “Ngarkesa totale e personelit akademik të programit PICD “MSH në Drejtësi”, Tabelës nr.6.3 “Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit”, Tabelës nr.12.3 “Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës” dhe Evidencës dok.nr.84 “Lista e pedagogëve të KUB për vitin akademik 2024-2025”, rezulton se: -Dr.F. L. i evidentuar si pedagog i brendshëm (PAE) në 2024-2025, sipas Tabelës nr.6.3, nuk rezulton si pjesë e stafit të asnjë departamenti, të asnjë njësie kryesore në këtë vit akademik (2024-2025). Ndërkohë që në Tabelën nr.2 dhe në të nr.12.3, rezulton si staf me kontratë (PAK) dhe jo staf efektiv. Në tabelën nr.4 ngarkesa e këtij pedagogu rezulton si PAE, kur duhet të jetë si PAK.
--	---

	-Dr.D. D., i evidentuar si pedagog i brendshëm (PAE) në 2024-2025, sipas Tabelës nr.6.3, rezulton si PAK në tabelën nr.2 dhe në Tabelën nr.12.3. Në tabelën nr.4 ngarkesa e këtij pedagogu rezulton si PAE, kur duhet të jetë si PAK. Në këto kushte, nëse do të bëjmë korrektimin e Tabelës nr.4 për ngarkesën e 2 pedagogëve si më sipër, rezulton se ngarkesa totale e mbuluar nga stafi PAK, për vitin akademik 2024-2025 nuk është 848, por 938 (duke shtuar 45 orë ngarkesë të lëndës “E drejtë penale ushtarake” dhe 45 orë të lëndës “Krimet e botës moderne/kibernetike”, të mbuluara respektivisht nga 2 pedagogët e mësipërm PAK. Për rrjedhojë nga stafi i jashtëm (PAK) për vitin 2024-2025 mbulohen 29.9% e ngarkesës totale (938/3139), ndërsa nga stafi i brendshëm mbulohen 70.1% e ngarkesës totale të planit mësimor (duke qënë në limitet e kufirit ligjor). Raporti PAE/PAK për vitin akademik 2024-2025 është 13 PAE/14 PAK. Sa më sipër, për vitin akademik 2024-2025, mbi 70% e ngarkesës së këtij programi studimi mbulohet nga personeli akademik efektiv, duke e përmbushur detyrimin ligjor. Sa më sipër, nga GJV konstatohet si gabim material plotësimi i evidencave (nr.4, nr.6.3 dhe dok.nr.84). <i>Evidenca “Tabelat përmbledhëse për aneks-RVB”, tabela 2, 4, 6.3, 12.3.</i> <i>Evidenca dok.nr.84 “Lista e pedagogëve të KUB për vitin akademik 2024-2025”</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe	Fakulteti ku përfshihet programi i studimit objekt vlerësimi ka pasur emërtime të ndryshme gjatë viteve akademike 2020-2021 deri në 2024-2025, sikurse e kemi sqaruar në kriterin më sipërm. Aktualisht Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, pranë të cilit ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në “Drejtësi”, zhvillon veprimtarinë akademike dhe shkencore në fushat e ekonomisë (financë, kontabilitet, menaxhim), drejtësië dhe shkencave sociale (marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, studime europiane) të përgjithme dhe specifike të këtij programi studimi. Ky fakultet aktualisht (viti akademik 2024-2025) ofron këto programe studimi:

udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<i>-Tre programe Bachelor:</i> Bachelor në Financë, A.Biznes dhe Institucione Financiare; Bachelor në Marrëdhnie Ndërkombëtare; Bachelor në Diplomaci dhe Studime Europiane; <i>-Katër programe Master i Shkencave:</i> Msc në Financë-Kontabilitet; Msc në Menaxhim Biznes; Msc në e Drejtë Civile dhe Tregtare; Msc në e Drejtë Penale. <i>-Katër programe Master Profesional:</i> MP në Financë-Kontabilitet; MP në Menaxhim biznesi. <i>-Një Program i Integruar i Nivelit të Dytë:</i> Msc (PI) në Drejtësi. Vetë emërtimi i Fakultetit përmbledh të gjitha fushat e përgjithshme të studimit, në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Programi i studimi PICD “Master i Shkencave në Drejtësi” ofrohet duke u referuar në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në përfundim të tij lëshohet diploma përkatëse bazuar në Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 të MASR “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës”. <i>Evidenca Tabela 3 “Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen në njësinë përgjegjëse”;</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i integruar (PICD) Masteri i Shkencave në “Drejtësi” ofron njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e të drejtës. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, të Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, përgjegjëse për këtë program studimi. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale mbulon fushat akademike e kërkimore të drejtësisë dhe shkencave sociale. Nga ky departament ofrohen një program i integruar PICD në drejtësi, dy programe Master i Shkencave në drejtësi (MSc në E drejtë civile dhe tregtare; MSc. në E drejtë penale) dhe dy programe Bachelor në shkencë sociale (“Marrëdhënie ndërkombëtare”; “Diplomaci dhe Studime evropiane”). <i>Evidenca “Tabelat përmbledhëse për aneks RVB”- Tabela nr. 1, 2 dhe Tabela 3;</i> <i>Evidenca Dok.nr.7 “Rregullore e Programit të Studimit”;</i>

Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N / A			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në IAL është ngritur dhe funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë menaxhon procesin e rekrutimit të studentëve; qëndron pranë tyre në vazhdimësi për zhvillimin e karrierës profesionale të tyre; orienton dhe asiston studentët nëpërmjet guidave, panarireve, konsultave dhe trajnimeve të ndryshme, për ti përgatitur për tregun e punës (nenet 3-7 të Rregullores së Zyrës së Studentit dhe Këshillit të Karrierës). <i>Evidenca Dok.nr.20 “Organigrama e KUB”.</i> <i>Evidenca Dok.nr.9 “Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillit të Karrierës”.</i> <i>Evidenca Dok.nr.104 “Fletë-Palosje Informative viti akademik 2023-2024”.</i> <i>Evidenca Dok.nr.105 “Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024”.</i> <i>Evidenca Dok.nr.110 “Program i Panairit Eëork and Study”.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” formalisht është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</i> <i>KUB duhet të mos angazhojë në mësimdhënie staf akademik (as PAE dhe as PAK) me kualifikimin “Master Shkencor”, pasi kjo bie ndesh me kërkesat e nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Brenda institucionit ekziston një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi mes strukturave akademike dhe atyre administrative në nivel fakulteti dhe rektorati. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit. Detyrat dhe përgjegjësiwë ndahen mes njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. KUB në përgjithësi dhe në vecanti Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi efektive brenda institucionit për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiwe. Këto detyra përcaktohen në: Rregulloren e KUB, Rregulloren e Departamentit dhe atë Programit të Studimit dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit. <i>Evidenca Dok.nr.5 "Rregullore e KUB";</i> <i>Evidenca Dok.nr.5 "Rregullore e FEDSHC";</i> <i>Evidenca Dok.nr.6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale";</i> <i>Evidenca Dok.nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit PICD MSH Drejtësi";</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në kuadër të mbarëvajtjes së realizimit të programit të studimit, nga KUB janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, si dhe me subjekte të tjera private dhe publike dhe aktorë të biznesit. Lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër institucional (janë lidhur nga KUB), duke përfutuar këtu edhe stafi akademik dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Janë nënshkruar marrëveshjes bashkëpunimi me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim bashkëpunimin në një sërë fushash, si

	dhe programe mobiliteti partnere ku krahas pedagogëve për mësimdhënie dhe/ose trajnim ka patur edhe studentë. KUB është përfshirë në shumë projekte zhvilluese akademike dhe shkencore, veçanërisht në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë (kryesisht Erasmus+/KA107 – ICM). Nëpërmjet marrëveshjeve të krijuara është e mundur shkëmbimi i stafit për dhënien e mësimi në universitetet homologe, si dhe shkëmbimi i studentëve përmes programit Erasmus+. Nga intervistat e zhvilluara nga GVJ, rezultoi se për periudhën 2020-2025 numerohen 21 mobilitete studentësh në kuadër të projekteve Erasmus+, në të tre fakultetet (njësitë kryesore). Nga këta, 2 studentë i përkasin programit të studimit në vlerësim (PICD MSH në "Drejtësi). <i>Evidenca Dok.nr.21 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë;</i> <i>Evidenca Dok.nr.24 – Marrëveshje bashkëpunimi KUB-UAMD;</i> <i>Evidenca Tabela nr.22 – "Raport i përfutueshmërisë së KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve";</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në funksion të realizimit të praktikave profesionale, institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh. KUB ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mundësi të tjera bashkëpunimi ku mund të marrin pjesë studentët e programit të studimit. Marrëdhëniet e bashkëpunimit janë vendosur edhe me subjekte e institucione vendase (studio avokatore, noterie, etj.), ku realizimi i praktikave profesionale, intershipeve mbetet një ndër komponentët kryesor, së bashku me krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. <i>Evidenca Dok.nr.21 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë;</i> <i>Evidenca Dok.nr.23 – Model marrëveshje TIP: KUB – IAL/Biznes, Sipërmarrje, OJF, etj;</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia	Për zbatueshmërinë dhe përfitimin nga marrëveshjet e lidhura, nga KUB zhvillohen analiza të detajuara, të paraqitura në raporte

përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve ndërkombëtare. Në këto raporte paraqiten të dhëna të detajuara për përfitueshmërinë dhe mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të projekteve ndërkombëtare (psh. Raporti i dhjetorit 2024). Nga GVJ u konstatua se nga Fakulteti apo/dhe nga Departamenti përgjegjës për programin e studimit PICD “MSH në Drejtësi” nuk hartohen raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit specifikisht në funksion të realizimit të këtij programi studimi. <i>GVJ sugjeron që nga Fakulteti apo/dhe nga Departamenti përgjegjës për programin e studimit PICD “MSH në Drejtësi”, të hartohen raporte edhe më të detajuara mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit specifikisht në funksion të realizimit të këtij programi studimi (PICD “MSH në Drejtësi”). Ky raportim mendojmë se duhet të analizohet për çdo fushë të bashkëpunimit të parashikuar në marrëveshje dhe jo vetëm për mobilitetin e stafit dhe studentëve.</i> <i>Evidenca Dok.Nr.22 “Raport i përfitueshmërisë së KUB nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve”;</i>
Konkluzione	<i>Në IAL ekziston një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi mes strukturave akademike dhe atyre administrative për mbarëvajtjen e programit të studimit në vlerësim. Rregullorja e KUB, Fakultetit dhe Departamentit përgjegjës për programin e studimit përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë e strukturave për organizimin dhe ofrimin e programit të studimit.</i> <i>Në nivel institucional (si KUB, jo si fakultet apo departament), janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me entitete të ndryshme, institucione dhe subjekte private, kryesisht për realizimin e praktikës së studentëve por jo vetëm. KUB është përfshirë në shumë projekte akademike dhe shkencore, veçanërisht në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë.</i> <i>Për zbatueshmërinë apo përfitimin nga marrëveshjet e lidhura, në kuadër të mbarëvajtjes specifikisht të programit të studimit “PICD MSH në Drejtësi”, sugjerojmë që nga Fakulteti apo Departamenti përgjegjës të hartohen raporte periodike të detajuara për çdo fushë të bashkëpunimit të parashikuar në</i>

	<i>marrëveshje dhe jo vetëm për mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të projekteve Erasmus.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese dhe kreditet e secilës lëndë janë të përcaktuara qartë në dokumentat e programit (Kurrikulën dhe Planin Mësimor) në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit “Master i Shkencave në Drejtësi” ka një kohëzgjatje 5 vjeçare, të cilës i përkojnë në total 300 kredite. Secili vit përbëhet nga 2 semestra, secili me nga 15 javë. Forma e studimit është me kohë të plotë. Për çdo vit student fiton 60 kredite, duke respektuar kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Programi i studimit detajohet sipas planit mësimor, i cili përkthen çdo lëndë specifike në orë dhe kredite. Kjo ngarkesë përkthehet në total 7500 orë, nga të cilat 3071 orë mësimore në auditor (leksione dhe seminare) dhe 4429 orë pune të pavarur të studentit.

	<i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca Dok.nr.7 "Rregullore e programit të studimit".</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Sikurse përcaktohet në Rregulloren e Programit të studimit, 5-vjeçar, "Master i Shkencave në Drejtësi", (neni 3) ky i fundit synon: "Pajisjen e studentëve me dije të thelluara shkencore, në të gjitha disiplinat, duke u ofruar mundësinë e konceptimit të vlerës teorike, praktike, studimore dhe aplikative të parimeve dhe normave juridike në veprimtarinë e shoqërisë dhe institucioneve të saj. Krijimin e kompetencave profesionale për të zhvilluar karrierën personale me vlerë juridike në vendimarrjet me efekte ekonomike, sociale dhe politike. Pajisjen e studentëve me njohuri dhe teknika për punë të pavarur shkencore në fushën teorike të krijimit të shoqërive, qarkullimit të mallrave dhe teknologjisë, pronësisë intelektuale dhe marrëveshjeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Pajisjen e studentëve me dije të thelluara për të vlerësuar të drejtën dhe sjelljen në përputhje me Kodin Civil dhe Penal, si dhe procedurat përkatëse. Zhvillimin e bashkëpunimit me të gjitha institucionet publike dhe private, që janë pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë të vendit, rajonal dhe perëndimor. Pajisja e studentëve me dije të thelluara për të qenë konkurrenës në tregun e punës dhe kërkimin shkencor në fushën e të drejtës". Sa më sipër, këto objektiva synojnë formimin e një game të gjerë profesionistësh dhe specialistësh të fushës së drejtësisë, të kualifikuar për të kontribuar në sistemin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Evidenca Dok.nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit DIND";</i> <i>Evidenca Dok.nr.3 "Mendimi i Dekanit të FEDSHS";</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Pjesë e kurrikulës dhe Planit Mësimor në programin e integruar të studimit "Msc në Drejtësi", është dhe Praktika Profesionale, e cila është parashikuar si lëndë e detyrueshme, në vitin e V-të, me 12 Kredite. Studenti nuk mund të diplomohet pa kryer detyrimin e praktikës. Sipas Kurrikulës së Programit të Integruar Msc "Drejtësi", e gjithë ngarkesa e programit (300 kredite), në 5 vite akademike, sipas lëndëve përkatëse ndahet në: A - Lëndë Bazë (15% -20%) - 58 ECTS;

	B - Lëndë Karakterizuese të Programit (45% -55%) - 164 ECTS C - Lëndë ndërdisiplinore/Integruese (12%-15%) - 40 ECTS D - Lëndë plotësuese (6%-8%) - 24 ECTS. Këtu përfshihet dhe praktika profesionale me 12 kredite. E - Detyrime përmbyllëse (3% - 5%) - 14 ECTS <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	KUB nuk gëzon status të veçantë si IAL. Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, që ofrohet nga KUB respekton një përputhshmëri prej së paku 70% në përmbajtje me programet e studimit që ofrohen në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë - PICD MSH “Drejtësi - nga IAL të tjera në RSH, në përputhje me parashikimin ligjor (<i>neni 86, pika 2, e Ligjit nr.80/2015</i>). Ky kriter ligjor për harmonizimin e programit të studimit krijon mundësinë e transferimit të studentëve, por njëkohësisht krijon një hapësirë ose autonomi për 30% fleksibilitet, për të adresuar qasje specifike të IAL-ve të ndryshme kundrejt tregut të punës apo kërkimit shkencor. Në këtë mënyrë, kriteri ligjor i mësipërm promovon një harmonizim kombëtar të programit, duke ruajtur njëkohësisht diversitetin ndërmjet IAL-ve publike dhe jo publike. <i>Evidenca Dok.nr.32 “Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi”, Lidhja 2/1 “Kurrikula e programit MSH “Drejtësi”; “Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”;</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet	Në zbatim të nenit 86, të Ligjit nr.80/2015, IAL-të në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për arsimin kanë filluar procesin e kodifikimit të programeve të studimit, bazuar në VKM Nr.310, datë 11.5.2022 “<i>Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i>”, si dhe në Udhëzimin e MAS Nr.31, datë 15.11.2022 “<i>Për</i>

kodifikimi i lëndëve të programit.	<i>procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</i> Në këtë kuadër, në zbatim të parashikimeve normative, KUB ka bërë propozimin përkatës në lidhje me kodifikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, specifikisht për kodin 75MS0421S. Shkresa e KUB për këtë qëllim mban nr.340 Prot., datë 25.07.2024. Aktualisht konstatohet se nga Ministria përgjegjëse për arsimin nuk rezulton të jetë konfirmuar ky kod. <i>Evidenca Dok.nr.35 “Shkresë dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimit”;</i> <i>VKM Nr. 310, datë 11.05.2022; Udhëzim i MAS Nr. 31, datë 15.11.2022;</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Aktualisht ky program studimi nuk është i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Konkluzione	<i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese dhe kreditet e secilës lëndë janë përcaktuar qartë në dokumentat e programit të studimit (Kurrikulën dhe Planin Mësimor), në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program respekton një përputhshmëri prej 70% në përmbajtje me programet e të njëjtës fushë dhe të njëjtit cikël, në IAL-të e tjera të RSH.</i> <i>Programi i studimit, 5-vjeçar, “Master i Shkencave në Drejtësi” synon formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë profesionistësh të fushës së drejtësisë. Objektivat e Programit të Studimit, KUB i ka paraqitur në Rregulloren e Programit të Studimit.</i>

	Për programin e studimit, KUB ka bërë propozimin për kodifikimin përkatës, por ende nuk ka marrë miratimin e kodit nga MAS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Drejtësi” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si njësia kryesore dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale , si njësia bazë. Ndër vite, emërtimi i këtyre njësive ka qenë i ndryshëm, sipas organizimit të brendshëm të KUB. Të dhënat e Fakultetit për pesë vitet akademike mbi kualifikimin e stafit akademik janë si më poshtë vijon:										
	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	-	3	-	2	1	2	-	1	2	4
	Prof. Asoc.	2	-	1	1	2	-	2	-	2	-
	Dr./PhD.	8	4	12	5	10	8	14	7	13	7
	Msc.	11	5	8	4	8	3	5	3	5	1
	Totali	21	12	21	12	21	13	21	11	22	12
	Stafi akademik i Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (sipas emërimit që ka pasur në vite) është i kualifikuar dhe përbërja e stafit i përmbush kriteret ligjore minimale të kërkuara nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, si njësi bazë që ofron këtë program studimi (neni 25, pika 4 e Ligjit Nr. 80/2015										

“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”).

Përbërja e departamentit për pesë vite akademike është si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	2	-	-	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-	1	-	2	-
Dr./PhD.	3	1	3	4	5	4	5	2	6	7
Msc.	4	1	4	3	2	1	1	4	-	-
Totali	7	4	7	7	7	6	7	7	8	8

Nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, me një staf në limitet e kriterit ligjor (aktualisht vetëm me 8 pedagogë si staf akademik të brendshëm), mbulohen 1 program i integruar (PICD) në drejtësi, 2 MSH në drejtësi dhe 2 Bachelor në shkencë sociale.

Sipas standarteve të cilësisë të arsimit të lartë, stafi akademik i njësisë bazë duhet të ketë fushë akademike dhe kërkimore në përputhje me programet e studimit që afron departamenti. Duke qenë se ky departament mbulon programe studimi që i përkasin edhe fushave të kërkimit të shkencave sociale dhe jo vetëm drejtësi, nga GVJ gjykohet se duhet të shtohet stafi i brendshëm i këtij departamenti për të krijuar kushte optimale për të ofruar programin e integruar 5 vjeçar të drejtësisë

Me vendim nr. 3, datë 07.01.2022, “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar i Biznesit”, kjo IAL është akredituar institucionalisht për 4 vite akademike. Vlefshmëria e akreditimit është deri më datë 06.01.2026.

Evidenca “Tabelat përmbledhëse për aneks-RVB”, tabela 1 “Numri i personelit me ndarjet”; Tabela 3 “Të dhëna tabelore

	<i>për numrin e programeve të studimit, që ofrohen nga njësia përgjegjëse</i>”; <i>Evidenca Dok.nr.112 “Çertifikatë Akreditimi KUB”;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Pjesë e Planit Mësimor në programin e integruar të studimit “Msc në Drejtësi”, si pjesë e lëndëve plotësuese (Kategoria D) në vitin e V-të, janë parashikuar edhe veprimtaritë formuese praktike: a. Klinikë e Ligjit me 6 Kredite; b. Praktika Profesionale, e cila është parashikuar si lëndë e detyrueshme, me 12 Kredite. Studenti nuk mund të diplomohet pa plotësuar detyrimin e Klinikës së Ligjit dhe Praktikës Profesionale, pasi janë parashikuar si lëndë. Si Klinika e Ligjit dhe Praktika mësimore mbikqyren nga staf akademik i brendshëm që është pedagogu përgjegjës i caktuar prej departamentit. <i>Evidenca Dok.nr.32 “Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi”, Lidhja 2/1 “Kurrikula e programit MSH “Drejtësi”; “Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”;</i> <i>Tabelat pjesë të RVB “Tabela nr.4”;</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Referuar Rregullores së Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, miratuar me vendimin nr 25, datë 25.11.2024 të Senatit Akademik, në nenin 9 “Funksionet dhe Detyrat e Përgjegjësit të Departamentit”, pika 2/b, parashikohet se: “Drejtuesi i Departamentit ka detyrë: ..(b). Të mbikqyrë dhe monitorojë gjithë procesin e përgatitjes, rishikimit, përmirësimit dhe realizimit të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, që mbulon Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Kur e gjykon të nevojshme Drejtuesi i Departamentit, cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori informon vazhdimisht drejtuesin e njësisë përkatëse, për ecurinë e programit të studimit”. GVJ konstaton se për programin e studimit (PICD) M.SH në “Drejtësi”, është caktuar një pedagog i departamentit Dr. B. I., në rolin e koordinatorit të programit të studimit. Koordinatori i programit është ngarkuar të ndjekë zbatimin e programit në

	përputhje me kornizën ligjore dhe aktet rregullative të IALP "Kolegji Universitar i Biznesit", të koordinojë procesin akademik dhe zhvillimin e praktikave profesionale të programit në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si dhe të informojë periodikisht pranë drejtuesit të Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. <i>Evidenca Dok.nr.5 "Rregullore e FEDSHC";</i> <i>Evidenca Dok.nr.6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale";</i> <i>Evidenca nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit".</i>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, aktualisht i përmbush detyrimet ligjore minimale për organizimin dhe strukturën akademike.</i> <i>Në kushtet kur Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka vetëm 8 pedagogë si staf akademik të brendshëm, të cilët mbulojnë 5 programe studimi (1 program i integruar në drejtësi, 2 MSH në drejtësi dhe 2 Bachelor në shkencë sociale), <u>sugjerohet</u> që të shtohet stafi i brendshëm i këtij departamenti për të krijuar kushte optimale për të ofruar programin e integruar 5 vjeçar të drejtësisë.</i> <i>KUB është IAL e akredituar dhe vlefshmëria e akreditimit institucional është deri më datë 06.01.2026.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon	Njësia bazë, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, pjesë e njësisë kryesore (Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale), si njësia përgjegjëse e programit të studimit në vlerësim, disponon të gjitha informacionet e nevojshme për

informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të integruar “Msc në Drejtësi”. Departamenti dhe drejtuesi i tij disponon të gjitha materialet dhe aktet rregullatore të KUB, që lidhen me programin e studimit, përfshirë Statutin dhe rregulloren e institucionit, rregulloren e Fakultetit, Departamentit dhe atë të programit PIND, kurrikulat e programit të studimit, planin mësimor, silabuset, etj. Të gjitha këto informacione janë të publikuara dhe të aksesueshme në mënyrë transparente në faqen zyrtare të KUB (https://kub.edu.al/aktet-ligjore/), duke siguruar transparencë dhe mundësi të plotë për konsultim për të gjithë palët e interesuara, përfshirë studentët, stafin akademik dhe administrativ. <i>Evidenca Dok.nr.52 “Udhëzues institucion për zhvillimin dhe përdorimin e portalit të KUB”;</i> <i>Evidenca Dok.nr.5 “Rregullore e FEDSHC”;</i> <i>Evidenca Dok.nr.6 “Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale”;</i> <i>Evidenca Dok.nr.7 “Rregullore e Programit të Studimit”.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në dokumentacionin e programit të integruar të studimit “Msc në Drejtësi”, përfshihet edhe <i>plani mësimor</i> i programit PICD Msc në “Drejtësi”. Ky Plan Mësimor jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit (gjithsej 300 kredite, të ndarë në 5 vite akademike, secili me 2 semestra, në total 7500 orë ngarkesë, nga të cilat 3071 orë mësimore në auditor dhe 4429 orë pune të pavarur të studentit). Në vitin e V-të përfshihet edhe lënda “Klinikë e ligjit” me 6 kredite dhe “Praktikë profesionale” me 12 kredite. Dokumentacioni i programit të studimit parashikon dhe detyrimin e frekuentimit nga ana e studentëve të orëve të zhvilluara në auditor. Kështu, neni 24 i Rregullores së Programit të Studimit parashikon se <i>“Studentët, si rregull, duhet të frekuentojnë jo më pak se 50 % të orëve të zhvilluara në auditor, për secilën lëndë”.</i> <i>Evidenca Dok.nr.32 “Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi”, Lidhja 2/1 “Plani mësimor i</i>

	programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"; <i>Evidenca Dok.nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit".</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në Rregulloren e programit të studimit PIND Msc në "Drejtësi" parashikohen në mënyrë të detajuar kriteret e pranimit dhe transferimit të studimeve. Kështu në nenin 5 "Kriteret e pranimit", pika 1, 2 dhe 3, jepen detaje në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në programin e studimit: <i>Pranimi i studentëve në Programin e integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi", bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me VKM dhe në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të përditësuara për çdo vit akademik. Kriteri bazë për pranimin e studentëve në Programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi" është përfundimi me sukses i studimeve të maturës shtetërore. Kriteret shtesë për pranimin në ciklin e dytë të studimeve miratohen dhe shpallen çdo vit nga KUB dhe i dërgohen ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore".</i> Neni 25 i kësaj Rregullore përcakton procedurën dhe kriteret për transferimin e studimeve. KUB pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga IAL vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në IAL të tjera. Sa i përket ekuivalentimit të studimeve, në KUB është miratuar një Rregullore e veçantë "Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve" Nr.11, datë 26.11.20218, miratuar me Vendim Senati Akademik nr.18. datë 26.11.2018, amenduar me Vendim Senati Akademik, datë 30.09.2023. Kjo rregullore përcakton kriteret e ekuivalentimit të studimeve, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit përkatës të ekuivalentimit. <i>Evidenca Dok.nr.7 "Regullore e programit të studimit DIND";</i> <i>Evidenca Dok.nr.39 "Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme	Programi i studimit PIND paraqet një strukturë të qartë dhe të organizuar për komponentët e tij akademikë, duke siguruar harmonizimin me standardet institucionale dhe praktikat e

për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	miratuara në arsimin e lartë. Ai përmban informacion të plotë mbi programet lëndore (syllabuset), praktikat, leksionet e seminarët, si dhe orët laboratorike, duke mbuluar të gjithë komponentët formues të programit, si brenda, ashtu edhe jashtë auditorit, si dhe kreditet e caktuara në ECTS, duke mundësuar kështu një orientim të saktë për kohën që studenti duhet të investojë për secilën lëndë. Syllabuset e lëndëve janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Sylabusi i detajuar miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i departamentit dhe titullari i lëndës. <i>Evidenca "Tabelat PIND", Tabela nr.14;</i> <i>Evidenca nr.32.4 "Silabuset Programi PIND "Drejtësi";</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga dokumentacioni i verifikuar, GVJ konstaton se programi i integruar i studimit Msc në "Drejtësi", sa i përket përmbajtjes së tij, pra lëndëve/moduleve dhe strukturës akademike, nga viti akademik 2020-2021 deri në 2024-2025 nuk ka pësuar ndryshime. Kjo pasi ky program është në proces akreditimi për herë të parë (shiko tabelën nr.11 "Ndryshime në planin mësimor, karahasuar me programin e licensuar"). <i>Evidenca "Tabelat PIND", Tabela nr.11.</i>
Konkluzione	<i>Njësia bazë, si dhe njësia kryesore disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit PI "Msc në Drejtësi".</i> <i>Plani mësimor i programit PI "Msc në "Drejtësi" jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Programi i studimit PIND paraqet një strukturë të qartë dhe të organizuar për komponentët e tij akademikë.</i> <i>Në aktet rregullatore të KUB (rregulloren e programit të studimit dhe në atë të ekuivalentimit) parashikohen në mënyrë të detajuar kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit PI “MSH në Drejtësi” është i strukturuar në mënyrë që të sigurojë për studentët njohuri teorike dhe aftësi praktike, të cilat janë thelbësore për punësim të suksesshëm në fushën e studimit, si dhe për mundësi të tjera të avancimit akademik në ciklin e tretë të studimeve. Emërtimi i programit është në përputhje të plotë me fushën e studimit që mbulon, duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë midis ofertës akademike dhe kërkesave të tregut të punës. Përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve është organizuar në mënyrë që të mundësojë një thellim të njohurive dhe zhvillimin e aftësive që janë të nevojshme për një karrierë të suksesshme. Lëndët e programit, së bashku me mundësitë e praktikave, ndihmojnë studentët të përgatiten për t’u përballur me sfidat e profesionit të tyre dhe të jenë të gatshëm për të kontribuar në mjediset profesionale të ndryshme. Kjo strukturë e programit të studimit siguron që studentët të kenë një kuptim të plotë të teorisë dhe praktikës në fushën e tyre dhe të jenë të gatshëm për të ndjekur mundësi punësimi ose zhvillim të mëtejshëm akademik. <i>Evidenca Dok.nr.7 “Regullore e programit të studimit DIND”</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të	Programi PI Master i Shkencave në Drejtësi, me një total prej 300 kreditesh ECTS, është hartuar për të përmbushur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe për t’i pajisur studentët me njohuri dhe aftësi të thelluara në fushën e drejtësisë. Mënyra se si është ndërtuar Kurrikula dhe Plani Mësimor mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, të parashikuar në Rregulloren e Programit të Studimit (neni 3).

nxënit dhe kërkimit shkencor.	Organizimi i programit siguron shpërndarjen e balancuar të lëndëve/modulave në vite akademike dhe semestra. Ai mbulon të gjitha disiplinat kryesore të drejtësisë, përfshirë të drejtën civile, penale, publike, ndërkombëtare si dhe aspekte plotësuese dhe ndërdisiplinore si <i>Mikroekonomi, Metodat kërkimi, Klinikë e ligjit etj.</i> <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit ndjek rregullat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ku 1 kredit ECTS i korrespondon 25 orëve të ngarkesës totale të studentit, përfshirë orët në auditor dhe studimin e pavarur të studentit. Programi i studimit detajohet sipas planit mësimor, i cili përkthen çdo lëndë specifike në orë dhe kredite. Kjo ngarkesë përkthehet në total 7500 orë, nga të cilat 3071 orë mësimore në auditor dhe 4429 orë pune të pavarur të studentit. Struktura e programit, lëndët e paraqitura në Planin Mësimor dhe raporti <i>teori-praktikë</i> i paraqitur në të është në përputhje me profilin e programit të integruar të studimit PI "Master i Shkencave në Drejtësi", duke përmbushur standardet e profilit të akademik dhe profesional të këtij programi. Ky program është i përafërt me programe të ngjashme të institucioneve të arsimit të lartë ndërkombëtar, duke garantuar konkurrueshmëri dhe krahasueshmëri në nivel global. <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca nr.32.4 "Silabuset Programi PIND "Drejtësi";</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Studimet, në këtë program studimi, janë me kohë të plotë, të organizuara në lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Sipas Kurrikulës së Programit të Integruar Msc "Drejtësi", e gjitha ngarkesa e programit (300 kredite), në 5 vite akademike, sipas lëndëve përkatesë ndahet në: A - Lëndë Bazë (15% -20%) - 58 ECTS;

mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	B - Lëndë Karakterizuese të Programit (45% -55%) - 164 ECTS C - Lëndë ndërdisiplinore/Integruese (12%-15%) - 40 ECTS D - Lëndë plotësuese (6%-8%) - 24 ECTS. Këtu përfshihet dhe praktika profesionale me 12 kredite. E - Detyrime përmbyllëse (3% - 5%) - 14 ECTS Sipas Planit Mësimor, praktika profesionale ka 12 kredite. Për të siguruar arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin pas përfundimit të tyre, programi i studimit ndërthur formimin teorik dhe praktik, duke u mbështetur në praktikat më të mira të universiteteve të huaja dhe duke lehtësuar kështu transferimin dhe mobilitetin akademik. Përmbajtja e kurrikulës dhe standardizimi i ngarkesës akademike sigurojnë krahasueshmëri me programe të ngjashme ndërkombëtare, duke mbështetur mobilitetin e studentëve përmes programeve si <i>Erasmus+</i>. Nga intervistat e zhvilluara nga GVJ, rezultoi se për periudhën 2020-2025, kanë përfutur mobilitet nga programet <i>Erasmus+</i> (ndër të tjerë) edhe 2 studentë të programit të studimit në vlerësim (PI "MSH në Drejtësi). <u>GVJ sugjeron</u> që duhet të punohet më shumë në këtë drejtim, duke siguruar pjesëmarrjen e sa më shumë studentëve të këtij programi studimi në projektet Erasmus +. <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca Tabela nr.22 – "Raport i përfutueshmërisë së KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve";</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë	Na verifikimi i syllabuseve konstatohet se titullari (pedagogu) i lëndës përgatit leksione për lëndën, të cilat azhurnohen periodikisht. Ato konstatohen që përgjithësisht të jenë të viteve të fundit 2024 dhe 2023. Syllabuset (programet e lëndëve/modulet) të programit PIND përditësohen në mënyrë të rregullt, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën ligjore dhe kërkesat e tregut të punës. Programet e lëndëve rishikohen në fillim të çdo

dhe ndihmëse të viteve të fundit.	viti akademik nga titullari i lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. <i>Evidenca nr.32.4 "Silabuset Programi PIND "Drejtësi";</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i integruar PI "Msc në Drejtësi" është hartuar, në përputhje me misionin e KUB, për të garantuar përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në fushën e drejtësisë. Përmbajtja e programit ka një raport të balancuar mes njohurive teorike dhe aftësive praktike, duke përfshirë lëndë të rëndësishme të ligjit dhe aktivitete praktike si klinika ligjore dhe praktika profesionale. Programi ndërthur teorinë me praktikën, duke synuar të nxisë studentët në përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nëpërmjet një kurrikule që adreson në mënyrë efektive kërkesat aktuale për formimin në këtë disiplinë. <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca nr.32.4 "Silabuset Programi PIND "Drejtësi";</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi adreson zhvillimin e aftësive të studentëve në dy drejtime kryesore: a. Studentët janë të aftë të aplikojnë metodologji të avancuara kërkimore për të analizuar probleme komplekse juridike dhe për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të fushës së drejtësisë. Në këtë mënyrë, programi mundëson një kalim të përshtatshëm dhe të suksesshëm në nivele më të avancuara të studimeve, duke përfshirë studime post-universitare, si programet e ciklit të tretë (Doktoraturë) ose Master Ekzekutiv; b. Kurrikula përfshin zhvillimin e aftësive kyçe si analiza ligjore, interpretimi i legjislacionit, përgatitja e dosjeve dhe aftësitë komunikuese, të cilat janë thelbësore për ushtrimin e profesioneve juridike. Në këtë mënyrë, programi i përgatit studentët për role profesionale në drejtësi, duke përfshirë pozicione si avokat, gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor dhe role në administratën publike apo organizata ndërkombëtare.

	<i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Kurrikula e programit MSH "Drejtësi"; "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca nr.32.4 "Silabuset Programi PIND "Drejtësi";</i> <i>Evidenca Dok.nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit"</i>			
Konkluzione	<i>Programi i Integruar i Studimit "Msc në Drejtësi" është i strukturuar në mënyrë që të sigurojë për studentët një kombinim të njohurive teorike dhe aftësive praktike, të cilat janë thelbësore për punësim të suksesshëm, si dhe për mundëson avancimin akademik në ciklin e tretë të studimeve.</i> <i>Mënyra se si është ndërtuar Kurrikula dhe Plani Mësimor mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, të parashikuar në aktet rregullatore të KUB. Struktura e programit, lëndët e paraqitura në Planin Mësimor dhe raporti teori-praktikë i paraqitur në të është në përputhje me profilin akademik dhe profesional të programit të integruar të studimit "Master i Shkencave në Drejtësi".</i> <i>Për periudhën 2020-2025, kanë përfutur mobilitet nga programet Erasmus+ edhe 2 studentë të programit të studimit PI "MSH në Drejtësi. <u>GVJ sugjeron</u> që duhet të punohet më shumë në këtë drejtim, duke siguruar pjesëmarrjen e sa më shumë studentëve të këtij programi studimi në projektet Erasmus +.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës,	Programi i integruar i studimit Msc në "Drejtësi", sa i përket përmbajtjes së tij, pra lëndëve/moduleve dhe strukturës akademike, nga viti akademik 2020-2021 deri në 2024-2025 nuk ka pësuar ndryshime. Kjo pasi ky program është në proces

gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	akreditimi për herë të parë (shiko tabelën nr.11 “Ndryshime në planin mësimor, karahasuar me programin e licensuar”). <i>Evidenca “Tabelat PIND”, Tabela nr.11.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni ka një angazhim të fortë për të përfshirë studentët në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit PIND. Ai nxit një atmosferë të hapur për diskutime, duke mbajtur kontakte të rregullta dhe konsultime me studentët aktualë nëpërmjet Këshillave Studentore. Aktet rregullatore (Statuti i KUB, nenet 17, 23, 72, 73, 74 dhe 72) parashikojnë përfshirjen e studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit. Sipas këtyre dispozitave statutore, studentët përfaqësohen me anëtarë në Senatin Akademik, Këshillin Etikës dhe Nj.S.B.C. Studentët organizohen në Këshilla Studentore. Në këtë mënyrë studentët kanë mundësi të japin mendimin dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidenca Dok.Nr.2 “Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026, Kreu 5.2;</i> <i>Statuti i Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit”, miratuar me Urdhër Nr. 39 date 10.01.2018 të MASR, të ndryshuar deri në nëntor 2024.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Programi i studimit Msc në “Drejtësi”, në përfundim të këtij viti akademik, plotëson ciklin e plotë 5 vjeçar dhe ende nuk ka pësuar ndonjë përmirësim apo përshtatje. Në të ardhmen Departamenti i së Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, duhet të zhvillojë mbledhje dhe të marrë mendimin e stafit, studentëve dhe aktorëve të tjerë (institucione, biznese, etj) për të marrë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kurrikulës së programit në përputhje me zhvillimet e fundit.

Konkluzione	<i>Aktet rregullatore të KUB sigurojnë përfshirjen e studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit. Sipas Statutit të KUB studentët përfaqësohen me anëtarë në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe Nj.S.B.C.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor, në nivel institucional, parashikohen në Planin Strategjik të Zhvillimit të KUB 2021-2026, kreu 5.6. Ndërkohë që objektivat kryesore të Programit të Integruar të Studimit përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit, neni 3. Kështu, një nga objektivat e programit të studimit është pajisja e studentëve me dije të thelluara shkencore dhe aftësimi i tyre për kërkim të avancuar shkencor, në fushat e ndryshme të Drejtësisë. Studentët promovohen duke u angazhuar në projekte kërkimore dhe publikime shkencore. Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale vlerëson si prioritet aftësimin për punë kërkimore – shkencore në fushën e studimit për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”. <i>Evidenca Nr.7 “Rregullorja e programit të studimit”;</i> <i>Evidenca Dok.Nr.2 “Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026”;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë	Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale në KUB bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Sipas nenit 6, pika 2, të Statutit të KUB, liria akademike garantohej nëpërmjet parimit të së drejtës për: të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese dhe

akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	profesionale; të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore; për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik. Nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale zhvillohen gjithashtu edhe aktivitete përtej procesit normal akademik, ku ftohen personalitete të fushave të ndryshme. <i>Evidenca Dok.nr.68 "Plani veprimtarisë akademike dhe shkencore për vitin akademik 2022-2023, në KUB";</i> <i>Evidenca Dok.nr.77. "Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-ve partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus+";</i> <i>Evidenca Dok.nr.88 "Lista e personaliteteve të ftuara për leksione të hapura KUB".</i> <i>Evidenca Tabela nr.20 "Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit".</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Kolegji Universitar i Biznesit në bashkëpunim me Qeverinë Studentore të KUB, si dhe tre njësitë kryesore të tij, ka krijuar një traditë të përvitshme në organizimin e Konferencës Kombëtare Studentore. Në këtë mënyrë nga strukturat përgjegjëse të programit të studimit promovohet pjesëmarrja studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore. "Strategjia e Kërkimit Shkencor të KUB 2024-2030", si pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit të IAL 2024-2030, parashikon si objektiv "Përfishirjen e studenteve në kërkimin shkencor dhe veprimtaritë kërkimore si mundësi për të realizuar objektivat e kërkimit shkencor, si kërkesë për formimin profesional dhe qytetar, si rrugë për të rritur cilësinë e përvetësimit të programeve mësimore, si mënyrë për pasurimin e CV-ve të tyre që në kohën e studimeve universitare dhe për orientimin e tyre në tregun e punës". Studentët e programit të studimit PI "MSH në Drejtësi", nën drejtimin e pedagogëve të programit, angazhohen edhe në aktivitetet kërkimore individuale të stafit akademik, si dhe në projekte kërkimore në nivel Departamenti, Fakulteti dhe më gjërë.

	<i>Evidenca Dok.nr.2. "Plani Strategjik i Zhvillimit të IAL 2024-2030".</i> <i>Evidenca Dok.nr.33. "Program i Konferencës Shkencore Studentore";</i> <i>Evidenca Dok.nr.34. "Punimi i një studenti nga IAL partnere në Konferencën Studentore";</i> <i>Evidenca Dok.nr.102. "Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB".</i> <i>Evidenca Tabela nr.22 "Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit".</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në Planin Strategjik të Zhvillimit të IAL 2024-2030, në kreun VI parashikohet edhe "Strategjia e kërkimit shkencor të KUB (2024-2030)". Sipas parashikimeve në strategjinë e kërkimit shkencor, KUB financon aktivitetet kërkimor si Konferenca Ndërkombëtare, Botime Shkencore, Revista Shkencore. Sipas evidencave të RBV, rezulton se të ardhurat nga grandet për kërkim dhe kontratat e projekteve zënë një peshë të vogël në të ardhurat e IAL-së. Kështu për vitin 2021 dhe 2022, të ardhurat nga grandet për kërkim dhe kontratat e projekteve janë 0.6% të të ardhurave të IAL-së, ndërsa në vitin 2023 janë 0.51%. <i>Sa më sipër, GJV sugjeron që të punohet më shumë për shtimin e nivelit të të ardhurave nga grandet për kërkim dhe kontratat e projekteve.</i> <i>Evidenca Dok.nr.2. "Plani Strategjik i Zhvillimit të IAL 2024-2030", kreu VI "Strategjia e kërkimit shkencor të KUB (2024-2030)".</i> <i>Tabelat PIND – Tabela nr.18 "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit".</i>
Konkluzione	<i>Prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor, në nivel institucional dhe të programit të studimit, parashikohen në Planin Strategjik të Zhvillimit të KUB, si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. IAL bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik.</i>

	<i>Në mbështetje të Strategjisë së Kërkimit Shkencor të KUB, studentët e programit të integruar të studimit "MSH në Drejtësi", angazhohen në aktivitetet kërkimore-shkencore.</i> <i>Sipas parashikimeve në strategjinë e kërkimit shkencor, KUB financon aktivitetet kërkimore-shkencore.</i> <i>GVJ sugjeron që nga autoritetet drejtuese dhe stafi akademik të punohet më shumë për angazhimin institucional në projekte ndërkombëtare për të siguruar shtimin e nivelit të të ardhurave nga grantet për kërkim dhe kontratat e projekteve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Drejtimi i kërkimit shkencor realizohet nga njësitë bazë dhe njësia kryesore, duke i'u përgjigjur kërkesave të kohës për studime e projekte kërkimore shkencore, ku janë përfshirë edhe personeli akademik, si dhe studentet. Projektet kërkimore dhe artikujt e ndryshëm shkencorë i referohen dinamikave të kuadrit ligjor Shqiptar. Projektet e mëdha kërkimore inkurajojnë ndërdisiplinartetin dhe mundësojnë koordinimin shkencor, ndërmjet departamenteve. KUB ka marrëveshje me IAL dhe institucione arsimore të tjera për realizimin e punëve kërkimore shkencore. Marrëveshjet e bashkëpunimit të KUL me IAL të tjera kanë në fokus, ndër të tjera, edhe angazhimin e personelit akademik për të realizuar kërkimore në bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore. <i>Evidenca Dok.nr.2. "Plani Strategjik i Zhvillimit të IAL 2024-2030", kreu VI "Strategjia e kërkimit shkencor të KUB (2024-2030)";</i>

	<i>Evidenca Dok. 31. "Raporti Vjetor i Veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, Shkencave Sociale, Viti Akademik 2022-2023, 2023-2024";</i> <i>Evidenca Tabela nr.22 "Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit".</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Referuar evidencave të RVB, aktivitetet kërkimore-shkencore të stafit akademik, të njësië bazë përgjegjëse për programin e studimit, paraqitet si më poshtë: - Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Departamentit – 55; - Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti – 3; - Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti – 3; - Numri aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit – 12; - Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore – 526; - Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang KUB – 1; Njësia përgjegjëse e programit të studimit (Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale) angazhohet për të adresuar kërkesat për studime dhe projekte kërkimore shkencore, duke përfshirë në këtë proces personelin akademik, sipas profilizimit të tyre akademik dhe shkencor, si dhe studentët. Projektet kërkimore i referohen dinamikave dhe fushave prioritare të financimit të projekteve ndërkombëtare dhe prioriteteve kombëtare. <i>Evidenca "Tabelat PIND", Tabela nr.19";</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale parashikon realizimin e disa Konferencave Kombëtare ose ndërkombëtare, përgjatë një viti akademik. Konferencat i vijnë në ndihmë personelit Akademik dhe studentëve për arritjen e objektivave kërkimore shkencore. Referuar Raportit Vjetor të Veprimtarive, GVJ konstaton se njësia kryesore organizon dhe aktivitete (leksione të hapura, psh), ku marrin pjesë pedagogët, studentët dhe të ftuar të tjerë, për të siguruar përmbushjen e objektivave të programit të studimit. IAL

	organizon dhe aktivitete periodike (vjetore) si psh konferenca shkencore studentore, ku angazhohen edhe studentët. <i>Evidenca Dok. 31. "Raporti Vjetor i Veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, Shkencave Sociale, Viti Akademik 2022-2023, 2023-2024";</i> <i>Evidenca Tabela nr.22 "Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit";</i> <i>Evidenca Dok. 88. "Lista e personaliteteve të ftuar për Leksione të Hapura KUB";</i> <i>Evidenca Dok.nr.33. "Program i Konferencës Shkencore Studentore";</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me prioritetet e KUB, të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të IAL-së, si dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, duke shfrytëzuar eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Të diplomuarit në këtë program studimit, të cilët do të zotërojnë një diplomë universitare "Master i Shkencave" në "Drejtësi" mund të punësohen si juristë në institucione të ndryshme publike, në entitete private, apo si profesionistë në sistemin gjyqësor (magjistratë pas përfundimit të shkollës së magistraturës osë avokatë, pas përfudimit të shkollës së avokatisë). Realizimi i këtij kriteri do të dëshmohet nga rezultatet e vëzhgimit sistematik të tregut të punës në Shqipëri, pas përfudimit të vitit akademik 2024-2025. <i>Evidenca Dok.nr.2. "Plani Strategjik i Zhvillimit të IAL 2024-2030";</i> <i>Evidenca Dok.44. "Studim tregu për programin e studimit, Master Shkencave në "Drejtësi";</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme	Njësia kryesore dhe njësia bazë kanë bërë të mundur që përmbajtja e këtij program studimi të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe sidomos me ligje specifike si "Ligji për Noterinë", "Ligji për Avokatinë", "Ligji për ndërmjetësimin", "Ligji për shërbimin e përmbartimit gjyqësor", aktet ligjore dhe nënligjore për pranimin në Shkollën e Magjistraturës etj, duke iu dhënë mundësinë studentëve të

për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	aplikojnë për marrjen e licencës së profesionit përkatës (Avokat, Noter, Ndërmjetës, Përmbarues Gjyqësor etj). Ende nuk është rregulluar me akte normative organizimi i provimit të shtetit në drejtësi dhe marrja e licenës profesionale përkatëse, sipas parashikimit të nenit 82, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr.80/2015. <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë në Drejtësi është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, si dhe Strategjinë e Zhvillimit të IAL-së. <i>Evidenca Dok.nr.2. "Plani Strategjik i Zhvillimit të IAL 2024-2030";</i> <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>			
Konkluzione	<i>Drejtimi i kërkimit shkencor realizohet nga njësia kryesore dhe njësia bazë, duke i'u përgjigjur kërkesave të kohës për studime e projekte kërkimore shkencore, ku janë përfshirë edhe personeli akademik, si dhe studentet. Nga IAL parashikohen realizimi i disa Konferencave Kombëtare ose ndërkombëtare, përgjatë një viti akademik. Konferencat i vijnë në ndihmë personelit Akademik dhe studentëve për arritjen e objektivave kërkimore shkencore.</i> <i>Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me prioritetet e KUB, të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të IAL-së, në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, si dhe në kuadrin ligjor për arsimin e lartë. Njësia kryesore dhe njësia bazë kanë bërë të mundur që përmbajtja e këtij program studimi të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke i mundësuar studentëve për të hyrë në tregun e punës si profesionistë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, për programin e integruar të studimit “Msc në Drejtësi” janë të parashikuara në aktet rregullatore të IAL-së. Kështu: Sipas nenit 88 të Rregullores së KUB: “Procesi mesimor përbëhet nga leksionet, projektet, punimet në laborator, praktikatat, punimet në terren, seminare dhe punime të tiera të ngjashme të parashikuara në programin mesimor, detyrat e kursit, provimet e formimit dhe teza e diplomës. Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e vlerësimit të vazhduar gjithësemestral (pjesëmarrje, aktivizim, ese, detyra kursi, prezantime, teste të ndërmjetme, etj) dhe vlerësimit në provimin përfundimtar”. Një parashikim të ngjashëm e gjejmë tek neni 41 i Rregullores së F.E.D.Sh.S “Procesi mesimor”. Ndërsa neni 12 i Rregullores së Programit të Studimit, detyrimet e studentit ndaj lëndës janë që: “Të marrë pjesë në leksionet, seminarët, projektet, elementët e tjerë sipas syllabusit të lëndës dhe punimin e diplomës (mikrotezës) brenda kufizimeve si më poshtë: Në rastet e ndjekjes për herë të parë të një lënde, studenti është i detyruar të frekuentojë leksionet dhe seminarët, jo më pak se në masën 50% të orëve mesimore dhe të plotësojë 100% detyrimet e punës individuale të përcaktuara në syllabusin e lëndës dhe nga pedagogu përgjegjës”.

	Kontrolli i dijeve siguron vlerësimin e progresit të studentëve dhe përvetësimin e kompetencave profesionale të programit. Ai realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit si dhe nëpërmjet vlerësimit në provimin përfundimtar. <i>Evidenca Dok. Nr.4. "Rregullore e KUB".</i> <i>Evidenca Dok. Nr.5. "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS".</i> <i>Evidenca Dok. Nr.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga verifikimi i kurrikulës, planit mësimor dhe syllabuseve rezulton se nga personeli akademik përdor një gamë të gjerë metodash për t'u përshtatur stileve të ndryshme të të nxënit, duke përfshirë: - Mësimdhënie në auditor: <i>leksione, seminare dhe ushtrime me kazuse që përfshijnë raste praktike dhe analiza studimore;</i> - Mësim i personalizuar: <i>ndihmë individuale për studentët përmes konsultimeve akademike gjatë orëve të zyrës;</i> - Përdorim i teknologjive inovative: <i>platforma mësimore online dhe burime dixhitale që ofrojnë fleksibilitet për mësimnxënie;</i> - Mësim në terren dhe praktika profesionale: <i>përfshirje në situata reale pune për të lidhur njohuritë teorike me zbatimin praktik.</i> Nga vizita në IAL, nga GVJ u konstatua se personeli akademik siguron mundësi mbështetëse për studentët duke: - Organizuar sesione të rishikimit dhe përsëritjes, për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë dhe përforcojnë materialet mësimore; - Përdorur metoda të ndryshme vlerësimi, duke përfshirë testime me shkrim, ese, projekte, prezantime dhe detyra grupore, për të vlerësuar gjithëpërfshirshëm përvetësimin e njohurive; - Siguruar që materialet mësimore janë të aksesueshme në formate të ndryshme, duke lehtësuar aksesin për të gjithë studentët.

	<i>Evidenca Dok. Nr.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i> <i>Evidenca Dok.nr.32 "Dosja e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Drejtësi", Lidhja 2/1 "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga verifikim i dokumentacionit nuk rezulton që KUB të sigurojë ndonjë program trajnimi të strukturuar për stafin akademik të tij, me qëllim për të përmirësuar kompetencat didaktike të pedagogëve. Gjithsesi mobiliteti i pedagogëve nëpërmjet programeve ERASMUS+ synon edhe përmirësimin e kompetencave didaktike të pedagogëve. <i>Sugjerohet që IAL të sigurojë dhe ofrojë periodikisht programe trajnimi për stafin akademik të tij, me qëllim për të përmirësuar kompetencat didaktike të pedagogëve për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në programin e integruar të studimit "Msc në Drejtësi" zotëron nivelin e duhur të ekspertizës dhe profesionalizmit, në fushën e tyre akademike dhe për lëndët me të cilat ngarkohen. Puna e tyre shtrihet në disa drejtime të rëndësishme, të cilat mbështesin dhe përmirësojnë përvojën e të nxënit për studentët. Materiali mësimor përcillet në një mënyrë që është e përshtatshme për nivele të ndryshme të kuptimit dhe të përgatitjes së studentëve. Personeli akademik aplikon një shumëllojshmëri metodash për të rritur angazhimin e studentëve dhe për të promovuar mësimin efektiv: - <i>Përdorimi i metodave interaktive:</i> Përfshirja e teknikave si diskutimet në grup, rastet studimore, zgjidhja e problemeve dhe prezantimet nga studentët. - <i>Mësimi i bazuar në projekte:</i> Studentët angazhohen në projekte praktike dhe kërkimore, duke forcuar lidhjen mes teorisë dhe praktikës. - <i>Teknologjia si mjet mësimor:</i> Përdorimi i platformave dixhitale dhe mjeteve vizuale për të ilustruar koncepte komplekse. Personeli akademik e vendos studentin në qendër të procesit mësimor dhe i nxit ata të zhvillojnë mendimin e tyre në mënyrë të pavarur. Përmes pyetjeve sfiduese dhe analizës së rasteve komplekse, studentët inkurajohen të analizojnë, argumentojnë

	dhe mbrojnë pikëpamjet e tyre. <i>Evidenca Tabelat PIND, Tabela nr.6 "Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit";</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia Kryesore (Fakulteti) dhe Njësia Bazë (Departamenti) kryejnë vlerësime sistematike të formave dhe metodave të mësimdhënies. F.E.D.Sh.S është i angazhuar për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në mënyrë sistematike në vlerësimet e brëndshme të bëra nga drejtuesi i departamentit në salla auditori si dhe në vlerësimin e deklarimeve në formularin e performancës akademike vjetore. Organizimi i pyetësorëve dhe marrja e mendimit të studentëve, në lidhje me format dhe metodat e mësimdhënies është një aktivitet periodik shumë i rëndësishëm, i organizuar nga strukturat përgjegjëse të programit të studimit. Rezultatet e këtyre pyetësorëve synojnë vlerësimin dhe përmirësimin e performancës akademike. <i>Evidenca Dok. Nr.75. "Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB".</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e	Në nivel institucional janë ngritur struktura dhe njësi specifike, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura koordinojnë dhe bashkërendojnë veprimtaritë me njësitë kryesore dhe bazë, duke mbështetur zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë (NJSBC) është një strukturë autonome dhe e përhershme në organizimin e universitetit. Kjo njësi kryen vlerësime periodike mbi rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, duke propozuar ndryshime dhe përmirësime të nevojshme. Propozimet bazohen në udhëzimet e sigurimit të cilësisë sipas standardeve të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe legjislacionit në fuqi. NJSBC bashkëpunon ngushtë me Fakultetin dhe Departamentin, duke realizuar aktivitete të planifikuara për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja mësimdhënëse inkurajohet në të gjitha nivelet, përfshirë departamentet. Personelit akademik u kërkohet të integrojnë në procesin mësimor metoda inovative që nxisin përfshirjen dhe të

aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	nxënit aktiv të studentëve. Në formatet e hartuara për përgatitjen e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të përcaktojë qartë për çdo temë metodat pedagogjike që do të përdorin gjatë mësimdhënies. Personeli akademik ka marrë trajnime edhe për përdorimin e platformave on linë të mësimdhënies, sikurse është Udhëzuesi institucional për zhvillimin dhe përdorimin "GOOGLE APPS". Personeli akademik i këtij programi studimi ka patur mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe periudha e shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+KA1. <i>Evidenca Dok.Nr.14. "Rregullore e Zyrës së NjsBC";</i> <i>Evidenca Dok.Nr.45. "Plani vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024";</i> <i>Evidenca Dok.Nr.46. "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024";</i> <i>Evidenca Dok. Nr.75. "Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetesorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB".</i> <i>Evidenca Dok.Nr.54. "Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin "GOOGLE APPS"</i>
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, për programin e integruar të studimit "Msc në Drejtësi" janë të parashikuara në aktet rregullatore të IAL-së. Personeli akademik aplikon një shumëllojshmëri metodash mësimdhënëse për të rritur angazhimin e studentëve dhe për të promovuar mësimin efektiv, si dhe siguron mundësi mbështetëse për studentët, duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi. Njësia Kryesore (Fakulteti) dhe Njsëia Bazë (Departamenti) kryejnë vlerësime sistematike të formave dhe metodave të mësimdhënies.</i> <i><u>Sugjerohet që IAL të sigurojë dhe ofrojë periodikisht programe trajnimi për stafin akademik të tij, me qëllim për të përmirësuar kompetencat didaktike të pedagogëve për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik.</u></i> <i>Personeli akademik i angazhuar në programin e integruar të studimit "Msc në Drejtësi" zotëron nivelin e duhur të</i>

	<i>ekspertizës dhe profesionalizmit, në fushën e tyre akademike dhe për lëndët me të cilat ngarkohen.</i> <i>Në nivel institucional janë ngritur struktura dhe njësi specifike, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura koordinojnë dhe bashkërendojnë veprimtaritë me njësitë kryesore dhe bazë, duke mbështetur zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sipas nenit 88 të Rregullores së KUB, vlerësimi i studentit përbëhet nga dy komponentë (i) <i>vlerësimi i vazhduar gjithësemestral</i> (pjesëmarrje, aktivizim, ese, detyra kursi, prezantime, teste të ndërmjetme, etj) dhe (ii) <i>vlerësimi në provimin përfundimtar</i>”. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 13, parashikon se “Vlerësimi për lëndën/modulin është = Vlerësimi i vazhduar + vlerësimi për Provimin Përfundimtar”: 1.Vlerësimi i Vazhduar – 1 deri 40 pikë, nga të cilat: - Pjesëmarrje (1-10 pikë) - Aktivizim (1-10 pikë) - Teste, detyra kursi, ese (1-20 pikë) 2. Provimi Përfundimtar – 1 deri 60 pikë. Totali i pikëve (1+2 =1-100 pikë) Kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive janë të parashikuara edhe në syllabuset e lëndëve. Kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, të detajuara në aktet rregullatore të sipërpërmendura, bëhen publike dhe njihen nga të gjithë studentët.

	<i>Evidenca Dok. Nr.4. "Rregullore e KUB".</i> <i>Evidenca Dok. Nr.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u shpjegohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), si dhe nga çdo pedagog në auditor për lëndët përkatëse, i cili i njofton studentët me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit ka si component të rëndësishëm vlerësimin e vazhdueshëm (deri në 40%). Kështu çdo syllabus përmban një seksion të titulluar "Kontrolli i Vazhdueshëm", ku përcaktohet vlerësimi i studentëve në përputhje me tipologjinë e lëndës. Po ashtu, studentët mund të përfitojnë nga platforma KUB, si dhe nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm, i ofruar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Njoftimet e detajuara për detyrat dhe provimet e lidhura me lëndën janë të disponueshme në platformën KUB. <u>https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-drejttese-dhe-shkencave-sociale/</u> <i>Evidenca Dok. Nr.42. "Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës";</i> <i>Evidenca Dok.Nr.32.4 "Syllabus për programin PIND Drejtësi".</i> <i>Evidenca Dok.Nr.52. "Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e portalit KUB"</i>

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm, duke përdorur metoda të larmishme, të cilat i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve ndahet në disa komponentë, të cilët përcaktohen sipas rregullores së programit të studimit PIND: - Pjesëmarje (1-10 pikë) - Aktivizim (1-10 pikë) - Teste, detyra kursi, ese (1-20 pikë) Ky proces parashikon një larmi formash, si: diskutime, seminare, detyra kursi, ushtrime për raste gjyqësore, projekte dhe aktivitete të tjera të organizuara. Vlerësimi i vazhduar është një komponent i rëndësishëm i vlerësimit final, i cili jo vetëm nxit studentët të mësojnë gjatë gjithë vitit, por dhe krijon fleksibilitet për pedagogun që të përdorë atë formë vlerësimi që i përgjigjet më mirë përthithjes së dijeve në lëndën përkatëse. <i>Evidenca Dok. Nr.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i>			
Konkluzione	<i>Kriteret kryesore të vlerësimit janë të parashikuara në Rregulloren e KUB, ndërsa metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të detajuara (të pikëzuara) në Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve. Të gjitha këto janë dokumente, të cilat bëhen publike dhe njihen nga të gjithë studentët.</i> <i>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u shpjegohen studentëve gjatë javës së orientimit, si dhe nga çdo pedagog në auditor për lëndët përkatëse, i cili i njofton studentët me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit.</i> <i>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit ka si komponent të rëndësishëm kontrollin e vazhdueshëm. Kjo formë vlerësimi, e ndarë në disa komponentë, nxit studentët të mësojnë gjatë gjithë vitit dhe është një tregues për të kuptuar nëse studentët po e kuptojnë materialin që po u ofrohet dhe nëse po arrihen objektivat mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar akteve rregullatore të KUB, nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar. Vlerësimi i vazhdueshëm, i cili pikëzohet deri në 40 pikë, përbëhet nga këto komponentë: a. Pjesëmarje (1-10 pikë); b. Aktivizim (1-10 pikë); c. Teste, detyra kursi, ese (1-20 pikë). Sa më sipër vlerësimi me notë për lëndën varet nga prezenca dhe niveli i diskutimit në seminare, nga detyrat e kursit (ese, prezantime, projekte), si dhe nga provimi përfundimtar, i cili ka një peshë 60% të vlerësimit final. Kjo metodologji vlerësimi synon të: a. Përfshijë aspekte të ndryshme të të nxënit – duke balancuar vlerësimet teorike dhe praktike; b. Nxisë angazhimin e vazhdueshëm të studentëve, përmes një kontrolli të shpërndarë gjatë gjithë semestrit; c. Sigurojë një vlerësim objektiv dhe të drejtë, duke shmangur varësinë vetëm nga provimi përfundimtar; Vlerësimi i njohurive dhe përcaktimi i notës parashikohet në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. <i>Evidenca Dok. Nr.32.4 "Syllabus për programin PIND Drejtësi";</i> <i>Evidenca Dok. Nr.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i> <i>Evidenca Dok. Nr.107. "Formular vlerësimit të vazhduar TIP".</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmanjin forma të	Në KUB, vlerësimi i provimeve për lëndët/modulet e këtij programi studimi nuk realizohet nëpërmjet sistemeve elektronike të testimit apo/dhe vlerësimit të provimeve. Tezat sekretohen për çdo provim nga Sekretaria Mësimore. Rregullorja e provimeve të KUB, neni 9, pika 6 parashikon se:

ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<i>"Pedagogu bën shpërndarjen e tezave të provimit tek çdo, student dhe sekretaria mësimore bën sekretimin duke hequr pjesën që është emri dhe duke shënuar një numër për të fshehur identitetin e çdo student".</i> <i>Evidencë Dok.Nr.73. "Model Tezë Provimi Formatit TIP".</i> <i>Evidenca Dok. Nr.64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Teza për provimin ndërtohet sipas temave të shpjeguara në lëndën përkatëse. Ajo përmban pyetjeve me alternative, si dhe pyetje me shtjellim, si dhe/ose kazuse për zgjidhje. Përcaktimi i notës si vlerësim përfundimtar i lëndës kryhet në përputhje me syllabusin, i cili përmban detaje të qarta mbi strukturën e vlerësimit dhe komponentët përbërës, bazuar në përcaktimet e akteve rregullatore. <i>Evidenca Dok. Nr.32.4 "Syllabus për programin PIND Drejtësi";</i> <i>Evidenca Dok. Nr.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i> <i>Evidencë Dok.Nr.73. "Model Tezë Provimi Formatit TIP".</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas përfundimit të provimeve, studentët kanë mundësinë të marrin pjesë në seanca sqaruese, ku pedagogët u ofrojnë shpjegime të detajuara mbi mënyrën e vlerësimit të tyre. Në këto seanca, studentët mund të shqyrtojnë në detaje korrigjimin e bërë, të kuptojnë arsyetimin pas vlerësimeve dhe të marrin komente të personalizuar për përmirësim të mëtejshëm. Kjo metodologji garanton një proces të drejtë, transparent dhe të orientuar drejt zhvillimit akademik të studentëve, duke nxitur gjithashtu ndërtimin e një marrëdhënieje të shëndetshme pedagog-student. Pedagogët e lëndës në korrigjimin e detyrave, eseve dhe provimeve mbajnë një qëndrim konstruktiv për vlerësimin e detyrave dhe provimeve, duke u fokusuar në dhënien e feedback-ut cilësor për studentët. Në procesin e vlerësimit të njohurive përfshihen edhe komentet e pedagogut dhe këshillat e dhëna për përmirësimin në të ardhmen. <i>Evidencë Dok.Nr.73. "Model Tezë Provimi Formatit TIP".</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti merr masa për monitorimin e provimeve. Gjatë zhvillimit të provimit, salla mund të monitorohet nga pedagogu i lëndës, nëse numri i studentëve është deri në 20 studentë. Nëse numri i studentëve që japin provimin është më i madh, atëherë monitorimi bëhet nga pedagogë të caktuar me miratim nga Departamenti (neni 13 i Rregullores për zhvillimin e provimeve në KUB). Rregullat e moskopjimit parashikohen në mënyrë strikte, në nenin 15 të Rregullores së Provimeve. Në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: <i>“2. Masat Disiplinore” - Në rast se studenti kapet me kopje, ose nuk zbaton rregulloren e provimit, studenti ndërpret provimin duke u larguar nga provimi dhe pedagogët plotësojnë një procesverbal për këtë vepër, i cili firmoset nga pedagogët përkatës. Ky procesverbal i dorëzohet dekanit/drejtorit të fakultetit ose kolegjit përkatës, i cili më pas mer një vendim mbi masat disiplinore që do të zbatohen për rastin konkret”</i>. Plagjiatura dhe kopjimi janë të ndaluara sipas Rregullore së KUB. <i>Evidenca Dok. Nr.64 “Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB”;</i> <i>Evidenca Dok. Nr.7. “Rregullore e Programit të Studimit”;</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e provimeve të KUB parashikon procedurën dhe afatet kohore për dorëzimin e rezultateve mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet, si rregull, brenda 1 (një) jave nga data e zhvillimit të tyre. Neni 16 i Rregullores së Provimeve parashikon se: <i>“Marrja e rezultateve të provimit dhe publikimi i tyre” – “Rezultatet e provimeve duhet të depozitohen në sekretarinë mësimore, si rregull, brenda afatit të një jave nga data e zhvillimit të provimit, pasi më parë këto u janë treguar studentëve me gjithë provimet e korrigjuara, për të parë gabimet, të cilat dorezohen në sekretarinë mësimore me zarf të mbyllur. Pedagogu firmos për dorëzimin e këtyre dokumenteve në formularin e sekretarinë mësimore”</i>. Pasi i merr rezultatet e provimeve, Sekretaria Mësimore bën hedhjen e tyre në sistemin e KUB me ID të studentëve. <i>Evidenca Dok. Nr.64 “Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB”;</i>

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Aktet rregullatore garantojnë të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, si dhe për të bërë apelim mbi vlerësimin e bërë nga pedagogu. Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online. Rregullorja e provimeve, në nenin 16, parashikon procedurën që mundëson studentin të kërkojë apelimin e vlerësimit. Kështu rregullorja parashikon shprehimisht se: <i>"2. Me marrjen e rezultateve, sekretaria mësimore bën hedhjen e tyre ne kompjuter, si dhe i afishon ato me ID/ose NIM të studentëve në WEB e KUB ose i komunikon edhe me forma te tjera. 3. Në raste të apeliimeve nga ana e studentëve për rezultatet e marra, ateherë sekretaria mësimore pret kërkesa me shkrim të bëra prej studentëve, të cilat i duhen drejtuar departamentit përkatës. Këto kërkesa me shkrim prej studentëve duhet të bëhen jo më vonë se 5 (pese) ditë nga data e shpalljes së rezultateve.</i> <i>Evidenca Dok. Nr.64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB";</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në aktet rregullatore parashikohet gjithashtu edhe procedura e shqyrtimit të apeliimeve dhe e rivlerësimit të provimit nga komisioni përkatës. Kjo procedurë zhvillohet në mënyrë transparente, dokumentohet dhe arkivohet në sekretarinë mësimore. Neni 16 i Rregullores së Provimeve të KUB parahikon se: <i>4. Apelimet e studentëve të depozituara në afatin e caktuar pranë sekretarisë dorëzohen departamenteve përkatëse, të cilët bëjnë shqyrtimin e këtyre kërkesave me komisione të ngritura prej tyre enkas për këto raste. 5. Pas shqyrtimit me komision të kërkesave të studentëve, departamentet dorëzojnë në sekretarinë mësimore qëndrimet e këtyre komisioneve për secilën kërkesë. Rezultatet e shqyrtimit prej departamenteve, sekretaria mesimore ua komunikon studentëve, duke bërë afishimin, sipas rasteve, të ndryshimeve apo mosndryshimit të rezultateve për rastet e ankimuara".</i> Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, si dhe arkivohen. <i>Evidenca Dok. Nr.64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB";</i>

Konkluzione	<i>Referuar akteve rregullatore të KUB, nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të vlerësimit të vazhdueshëm (40%) dhe provimit përfundimtar (60%). Teza për provimin ndërtohet sipas temave të shpjeguara në lëndën përkatëse dhe në çdo rast sekretohet nga Sekretaria Mësimore.</i> <i>Rregullorja e provimeve të KUB parashikon në mënyrë të detjuar procedurën e zhvillimit të provimit dhe detyrat e strukturave përkatëse, si dhe studentëve. Gjithashtu parashikon afatet kohore për dorëzimin e rezultateve mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Departamenti merr masa për monitorimin e provimeve, si dhe për të siguruar një procedurë të rregullt të provimit, duke ndaluar kopjimin dhe veprime të tjera të studentit.</i> <i>Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online dhe aktet rregullatore garantojnë të drejtën e tyre për t'u njohur me vlerësimin, si dhe procedurën që mundëson studentin të kërkojë apelinin e vlerësimit. Gjithashtu parashikohet në mënyrë të detajuar procedura e shqyrtimit të apeliemeve dhe e rivlerësimit të provimit nga komisioni përkatës.</i> <i>Pedagogët e lëndës në korrigjimin e detyrave, eseve dhe provimeve mbajnë një qëndrim konstruktiv për vlerësimin e detyrave dhe provimeve, duke u fokusuar në dhënien e feedback-ut cilësor për studentët. Studentët kanë mundësinë të marrin shpjegime të detajuara mbi mënyrën e vlerësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	Programi i integruar “Msc Në Drejtësi”, i shtrirë në 5 vite me 300 ECTS, ka për qëllim thellimin e njohurive të studentëve, duke synuar të pajisë studentët me një bazë të gjerë dhe të thellë të njohurive juridike. Programi i integruar ofron një kombinim

profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	të ekuilibruar mes teorisë, praktikës dhe kërkimit shkencor. Ai synon të përgatisë juristë të aftë, profesionalë dhe etikë, duke i pajisur ata me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kontribuar në zhvillimin e sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë. Ky objektiv realizohet përmes një plani studimor të strukturuar, që mbulon parimet themelore të drejtësisë dhe ligjit. Fushat kryesore të së drejtës, si e drejta civile, penale, publike dhe ndërkombëtare. Programi përqendrohet në formimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve përmes mësimit të bazuar në raste studimore dhe analiza konkrete të praktikave juridike, simulimeve të proceseve gjyqësore (gjyqe simuluese) për zhvillimin e aftësive argumentuese dhe të zgjidhjes së konflikteve, angazhimit të studentëve në projekte të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, si dhe organizata joqeveritare që ofrojnë shërbime juridike. Thellimi i njohurive dhe aftësive profesionale konsiderohen si objektiva të Programit të Studimit. <i>Evidenca Dok.nr.7 "Rregullore e Programit të Studimit";</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sipas Kurrikulës së Programit të Integruar MSH "Drejtësi", e gjitha ngarkesa e programit (300 kredite), në 5 vite akademike, sipas lëndëve përkatesë ndahet në: A - Lëndë Bazë (15% -20%) - 58 ECTS; B - Lëndë Karakterizuese të Programit (45% -55%) - 164 ECTS C - Lëndë ndërdisiplinore/Integruese (12%-15%) - 40 ECTS D - Lëndë plotësuese (6%-8%) - 24 ECTS. Këtu përfshihet "Gjuha e Huaj, anglisht", "Klinika e ligjit" dhe "Praktika profesionale". E - Detyrime përmbyllëse (3% - 5%) - 14 ECTS. Programi përfshin lëndë dhe module që trajtojnë përdorimin e teknologjisë, si p.sh. E drejta e pronësisë intelektuale dhe krimet kibernetike. Lëndë me fokus human dhe social: Lëndë si filozofia e së drejtës, u mësojnë studentëve të analizojnë kontekstin social të çështjeve juridike. Studentët marrin pjesë në klinikën ligjore dhe projekte komunitare, duke u përfshirë në zgjidhjen e çështjeve reale sociale dhe ligjore që prekin grupe të ndryshme shoqërore.

	<i>Evidenca nr.32 "Dosja e programit të studimit" "Kurrikula e Programit MSHD" dhe "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi";</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Kompetencat dhe aftësitë që studenti fiton gjatë ndjekjes së një lënde janë të përcaktuara në programin e studimit dhe syllabuset përkatëse. Këto kompetenca analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës për të siguruar që objektivat mësimore të jenë përmbushur. Pedagogët, përpara përfundimit të lëndës, përgatisin një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të trajtuara gjatë semestrit. Në këtë përmbledhje përfshihen edhe studentët përmes diskutimeve, duke marrë mendimin e tyre mbi materialin dhe sugjerimet për përmirësime të ardhshme. Përmes detyrave të kursit dhe eseve, pedagogët vlerësojnë se sa mirë studentët kanë kuptuar dhe përvetësuar materialin. Këto detyra shërbejnë si një mjet për të identifikuar pikat e forta dhe ato që kanë nevojë për përmirësim. Para testimeve të pjesshme dhe përfundimtare, studentët orientohen nga pedagogët për t'u fokusuar te çështjet më të rëndësishme dhe prioritetet e lëndës. Ky proces ndihmon studentët të strukturojnë mësimin e tyre në mënyrë më efektive. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik evidenton çështjet dhe konceptet më të rëndësishme, duke i ndihmuar studentët të identifikojnë njohuritë që do t'u nevojiten në vijim. Pedagogët ndalen më gjatë në elementët e materialit që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët gjatë semestrit, duke i shpjeguar më hollësisht për t'ua bërë më të qarta. Për të adresuar çështjet specifike dhe për të ndihmuar studentët të përgatiten për provim, pedagogët janë në dispozicion për konsulta gjatë orëve të takimit zyrtar, të përcaktuara në fillim të semestrit. Këto praktika ndihmojnë në përforcimin e njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët, duke siguruar një përfundim cilësor të lëndës. <i>Evidenca Dok. Nr.32.4 "Syllabus për programin PIND Drejtësi".</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra	Nga vizita në institucion u evidentua se stafi akademik synon që mësimdhënia të realizohet, duke synuar zhvillimin e kompetencave dhe aftësive praktike e profesionale të studentëve. Ky model u mundëson studentëve të aplikojnë dhe zhvillojnë më tej njohuritë teorike në praktika profesionale.

në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup gjatë analizës dhe interpretimit të rasteve konkrete. Pedagogët krijojnë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe angazhohen në kërkime shkencore të avancuara, duke u shërbyer si model studentëve. Gjatë orëve të seminarit, studentët angazhohen në zgjidhjen e rasteve studimore, duke zhvilluar aftësitë për të punuar në grup. Për të mundësuar mobilitetin dhe zhvillimin profesional të studentëve, personeli akademik bashkëpunon me institucione dhe kompani partnere, duke ndërthurur metodat e mësimdhënies me praktikat e tregut të punës. Programi përfshin lëndë të dedikuara për zhvillimin e aftësive praktike, duke përfshirë analizën e rasteve studimore gjatë seminareve. Qëllimi i seancave në institucione private apo organe të administratës publike është t'u ofrojnë studentëve njohuritë bazë mbi menaxhimin e karrierës dhe t'i informojnë për tregun e punës dhe qasjen ndaj tij, përmes ekspertëve të fushës të ftuar. Praktika profesionale është një komponent i detyrueshëm i programit dhe synon të lidhë njohuritë teorike me profesionin përkatës, duke i familjarizuar studentët me realitetet e tregut të punës. Studentët zhvillojnë praktikat në institucione private dhe administrata shtetërore. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për të siguruar zhvillimin profesional të studentëve në ambiente pune reale. <i>Evidenca Tabela PIND, Tabela nr.5 "Institucionet dhe organizatat bashkëpunues në rag programi, për praktikat profesionale";</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik, si ai efektiv ashtu edhe ai me kontratë, luan një rol të rëndësishëm në promovimin e zhvillimeve të reja shkencore dhe teknologjike, duke organizuar orë të hapura, seminare dhe leksione të dedikuara për tema bashkëkohore, brenda ose jashtë strukturës së programit të studimit. Çdo pedagog kontribuon në kërkimin shkencor sipas fushës së tij të ekspertizës dhe drejtimit të kërkimit ku është i përfshirë. Ky kontribut ndihmon jo vetëm në avancimin e fushës përkatëse, por edhe në pasurimin e përmbajtjes së mësimdhënies. Në F.E.D.Sh.S në KUB organizohen rregullisht leksione të hapura nga pedagogë të brendshëm dhe ekspertë të ftuar, duke përfshirë personalitete me përvojë në fushat e shkencës,

	teknologjisë, drejtësisë dhe aktualitetit. Këto leksione shërbejnë për të sjellë një perspektivë të re dhe për të thelluar njohuritë mbi çështje që lidhen me teorinë dhe praktikën. Leksionet dhe seminarët zhvillohen si pjesë e lëndëve të caktuara të programit të studimit dhe në formë aktiviteteve jashtë kurrikulës. Ato janë të hapura për të gjithë studentët dhe për personelin akademik, duke krijuar një hapësirë për shkëmbimin e ideve dhe për zhvillimin e kompetencave. Studentët kanë mundësinë të ndjekin leksione dhe seminare për të zgjeruar horizontin e tyre akademik dhe për të mësuar nga përvoja praktike e ekspertëve të fushës. Ky angazhim ndihmon në zhvillimin e aftësive kritike dhe në krijimin e një lidhjeje më të ngushtë midis teorisë dhe praktikës. <i>Evidenca Dok.Nr.88 "Lista e personaliteteve të ftuara për leksione të hapura KUB";</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga GVJ nuk u konstatua ndonjë rast, kur studimi apo kërkimi i realizuar nga studentët e programit të integruar të studimit "Msc" në "Drejtësi", apo edhe nga studentë të programeve të tjera KUB-it në përgjithësi, të jenë mbështetur financiarisht nga IAL. Por në vizionin e kërkimit shkencor, të parashikuar në strategjinë e kërkimit shkencor të KUB (pjesë e planit strategjik të zhvillimit të KUB), IAL inkurajon përfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore-shkencore. Nga <u>GVJ sugjerohet</u> që nga IAL të merren masa që të promovohet financiarisht çdo inisiativë (projekt kërkimor, studim) për zhvillimin e ideve inovative nga studentët e programit të integruar të studimit "Msc në Drejtësi". <i>Evidenca Dok.Nr.2 "Plani strategjik i zhvillimit të KUB", kreu VI, Strategjia e kërkimit shkencor të KUB 2024-2030";</i>
Konkluzione	<i>Programi i integruar "Msc në Drejtësi" ofron një kombinim të ekuilibruar mes teorisë, praktikës dhe kërkimit shkencor. Programi përqendrohet në formimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve përmes mësimit të bazuar në raste studimore dhe analiza konkrete të praktikave juridike. Staf akademik synon që mësimdhënia të realizohet, duke synuar</i>

	zhvillimin e kompetencave dhe aftësive praktike e profesionale të studentëve. Programi përfshin lëndë dhe module që trajtojnë përdorimin e teknologjisë, si p.sh. E drejta e pronësisë intelektuale dhe krimet kibernetike, si dhe lëndë me fokus human dhe social si filozofia e së drejtës. Kompetencat dhe aftësitë që studenti fiton gjatë ndjekjes së një lënde janë të përcaktuara në programin e studimit dhe syllabuset përkatëse. Pedagogët, përpara përfundimit të lëndës, përgatisin një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të trajtuara gjatë semestrit. Në KUB organizohen rregullisht leksione të hapura nga pedagogë të brendshëm dhe ekspertë të ftuar, duke përfshirë personalitete me përvojë në fushat e shkencës, teknologjisë, drejtësisë dhe aktualitetit. Këto leksione shërbejnë për të sjellë një perspektivë të re dhe për të thelluar njohuritë mbi çështje që lidhen me teorinë dhe praktikën. Nga <u>GVJ sugjerohet</u> që nga IAL të merren masa që të promovohet financiarisht çdo inisiativë (projekt kerkimor, studim) për zhvillimin e ideve inovative nga studentët e programit të integruar të studimit "Msc në Drejtësi".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Kurrikula dhe plani mësimor i programit të integruar të studimit "Msc në Drejtësi" parashikojnë si detyrim përmbyllës "Mbrotjtje të mikrotezës" me 14 kredite. Detyrimi përmbyllës parashikohet në aktet rregullatore të KUB. Për të përmbyllur detyrimet e tyre, studentët e programit duhet të mbrojnë diplomën.

	Rregullorja e KUB parashikon përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse dhe procedurën për mbrojtjen e mikrotezës në kreun XIV (nenet 104-110) të saj. Rregullorja e Fakultetit parashikon një procedure të posaçme për mbrojtjen e diplomës nga studentët në kreun IX (neni 53-59). Po kështu Rregullorja e Departamentit bën parashikimin për mbrojtjen e diplomës në nenin 31 dhe 32 të saj. Në këto parashikime normative paraqitet në mënyrë të detajuar çdo procedure që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, deri tek procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. <i>Evidenca nr.32 "Dosja e programit të studimit" "Kurrikula e Programit MSHD" dhe "Plani mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi";</i> <i>Evidenca Dok.4. "Rregullore e KUB";</i> <i>Evidenca Dok.5. "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS";</i> <i>Evidenca Dok.6. "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale";</i> <i>Evidenca Dok.7. "Rregullore e Programit të Studimit".</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Aket rregullatore parashikojnë të drejtën dhe detyrimin e studentit që të diplomohet duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Procedurat dhe afatet e propozimit, përgatitjes dhe prezantimit të temës së diplomës janë të përcaktuara në paketë udhëzuese të posaçme. Në këtë paketë përmbledhen edhe formularë tip standart për të unifikuar procedurat përkatëse. Njësia bazë miraton drejtuesit e temave të diplomës. Pedagogu udhëheqës duhet të ketë minimalisht gradën shkencore. Çdo anëtar i personelit akademik, njofton fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash. <i>Evidenca Dok. 118. "Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë".</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna	Në këtë program të integruar studimit, PI "Master i Shkencave" në "Drejtësi", detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, bazuar në kërkesat e nenit 75, pika 5 e Ligjit Nr.80/2015, ku parashikohet se:

gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>“Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer”.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Pedagogu udhëheqës e orienton dhe ndihmon studentin, duke zhvilluar seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq. Në aktet rregullatore dhe në paketën udhëzuese për mbrojtjen e diplomës parashikohet zhvillimi i seancave, që trajtojnë çështje të tilla si: <i>Përcaktimin e objektit të temës dhe përzgjedhjen e problematikës që do të trajtohet; Ndërtimin e strukturës së punimit; Grumbullimin e materialit; Trajtimin e aspekteve metodologjike; Miratimin e draftit, etj.</i> Punimi i diplomës përpara dorëzimit për mbrojtje nga studenti, duhet të marrë edhe firmën e pedagogut udhëheqës. <i>Evidenca Dok. 118. “Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë”;</i> <i>Evidenca Dok.4. “Rregullore e KUB”;</i> <i>Evidenca Dok.5. “Rregullore e Njësisë Kryesore FEDSHS”;</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sipas temës dhe fushës së studimit, si dhe brenda mundësive, KUB i ndihmon studentët për të realizuar studimet e tyre, duke u krijuar lehtësira të ndryshme. Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: trajtimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore, punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj. Institucioni mund të ndihmojë studentët, duke shpërndarë pyetësorët e tyre, tek studentët e tjerë nëpërmjet koordinatorëve. Gjithashtu, institucioni nëpërmjet lëshimit të vërtetimit të studentit (me kërkesë të studentit) mund të ndihmojë procesin e mbledhjes së të dhënave jashtë institucionit. <i>Evidenca Dok. 118. “Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë”;</i>

	<i>Evidenca Dok.4. "Rregullore e KUB";</i> <i>Evidenca Dok.5. "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS"</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. <i>Evidenca Nr.10 "Dokumenti për punimin e diplomës", pika B.II.13.4. Procedura e mbrojtjes;</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar të Rregullores së KUB, institucioni pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Ministria e Arsimit dhe Sportit përcakton elementët përbërës të diplomës, format dhe procedurat për regjistrimin e saj. Perpara se të lëshohet nga institucioni, çdo formë diplome regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit. Gjithashtu Rregullorja e KUB parashikon, në mënyrë të detajuar, procedurën e tërheqjes së diplomës, e cila bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit në regjistrin përkatës. <i>Evidenca Dok.4. "Rregullore e KUB";</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përputhje me kërkesat ligjore (kuadrit rregullator për arkivat), institucioni i arsimit të lartë, ruan një kopje të dokumentacionit të regjistrimit të studentit. Gjithashtu KUB disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, e cila mundëson informacione për studentët në çdo kohë.
Konkluzione	<i>Kurrikula dhe plani mësimor i programit të integruar të studimit "Msc në Drejtësi", në KUB, parashikojnë si detyrim përmbyllës "Mbrojtje të mikrotezës" me 14 kredite. Aktet rregullatorë, si Rregullorja e KUB, Rregullorja e fakultetit, si dhe Rregullorja e programit të studimit parashikon një procedure të posaçme për mbrojtjen e diplomës nga studentët. Për më tepër KUB ka miratuar një paketë të posaçme</i>

	udhëzuese në lidhje me procedurat e mbrojtjes së temës së diplomës. Departamenti dhe stafi akademik asistojnë studentët në punimin e diplomës. Pedagogu udhëheqës e orienton dhe ndihmon studentin, duke zhvilluar seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq. Dhe vetë IAL ndihmon studentin në përgatitjen e pyetësorëve apo terheqjen e informacioneve nga institucione të tjera. Punimi i diplomës vlerësohet me note nga komisioni përkatës. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, pajiset me diplomën përkatëse, e cila mund të tërhiqet vetëm personalisht prej studentit, apo përfaqësuesit me prokurë. Pas përfundimit të studimeve nga studentin, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional/Shkencor” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Njësia bazë dhe ajo kryesore, nëpërmjet bashkëpunimit që KUB ka me aktorë të tregut të punës, ofrojnë mundësi të shumta për praktikë profesionale pranë institucioneve pritëse. Godinat dhe infrastruktura në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, përfshirë edhe në këtë program të integruar studimi (PI “MSH” në “Drejtësi”) plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të pajisura me sistem ëireless. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me softëaret përkatës, për të mundësuar mësimdhënien dhe kërkimin. Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni.

	<i>Evidenca Tabela PIND, Tabela nr.5 "Institucionet dhe organizatat bashkëpunues në rag programi, për praktikat profesionale";</i> <i>Evidenca Tabela PIND, Tabela nr.16 "Mjediset e KUB";</i> <i>Evidenca Tabela PIND, Tabela nr.17 "Të dhëna për platformën on line/struktura teknologjike";</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Studentëve të këtij programi studimi, nëpërmjet marrëveshjeve bashkëpunimi që ka KUB me institucione publike, apo organizma private, u mundësohet kryerja e praktikave profesionale, me qëllim përfitimin e kompetencave profesionale. <i>Evidenca Dok.Nr.23 "Model Marrëveshjeje TIP-KUB me IAL, Biznes, Sipërmarrje, OJF etj";</i> <i>Evidenca Tabela PIND, Tabela nr.5 "Institucionet dhe organizatat bashkëpunues në rag programi, për praktikat profesionale";</i>
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Referuar akteve të brendshme rregullatore, si Rregullorja e programit të studimit, Kurrikula dhe Plani Mësimor, në programin e integruar "Msc në Drejtësi", praktika profesionale është pjesë e lëndëve plotësuese dhe ka një ngarkesë prej 12 kreditesh akademike. Për rrjedhojë ajo duhet të vlerësohet me notë nga komisioni përkatës, i ngritur nga përgjegjësi i departamentit. Sa më sipër veprimtaria e studentit gjatë praktikës duhet të formalizohet dhe dokumentohet. Nga KUB nuk është miratuar ndonjë udhëzues për procedurat, afatet dhe dokumentat që duhet të hartojë studenti për të plotësuar detyrimet e praktikës, sipas kërkesave të planit mësimor. Në paketën e dokumentave bashkëngjitur RVB-së, evidentohet një dokument (Dok. 27) me emërtimin "Udhëzues për Përgatitjen e Praktikës Profesionale" me dy dokumenta me emërtimin: 1. Model raporti TIP për kryerjen e praktikës; 2. Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikrat Profesionale. Në fakt ky emërtim nuk i korrespondon përmbajtjes reale të këtij file. Pasi aty janë bashkëngjitur dokumentat e përgatitjes së temës së diplomës dhe nuk ka asnjë dokument për procedurat e praktikës profesionale. <i>Nga GVJ sugjerohet që nga KUB të miratohet një udhëzues i plotë për procedurat, afatet dhe modelet e dokumentave që</i>

	<i>duhet të hartojë studenti për të plotësuar detyrimet e praktikës, sipas kërkesave të planit mësimor. Në këtë udhëzues duhet të përmbahen modelet: kërkesa drejtuar institucionit/entit privat për kryerjen e praktikës profesionale; raporti i studentit praktikant; raporti i institucionit/entit pritës për rezultatet e studentit; raporti i vlerësimit të pedagogut udhëheqës, etj.</i>			
Konkluzione	<i>KUB, nëpërmjet bashkëpunimit që ka me aktorë të tregut të punës, ofron mundësi të shumta për praktikë profesionale pranë institucioneve pritëse. Studentëve të këtij programi studimi u mundësohet kështu kryerja e praktikave, me qëllim përfitimin e kompetencave profesionale.</i> <i>Praktika profesionale është pjesë e lëndëve plotësuese dhe ka një ngarkesë prej 12 kreditesh akademike e për rrjedhojë ajo duhet të vlerësohet me notë nga komisioni përkatës.</i> <i>Konstatohet se nga KUB nuk është miratuar ndonjë udhëzues orientues ndaj studentëve për procedurat, afatet dhe dokumentat që duhet të hartojë studenti për të plotësuar detyrimet e praktikës.</i> <i>Nga GVJ sugjerohet që nga KUB të miratohet një udhëzues i plotë për procedurat, afatet dhe modelet e dokumentave që duhet të hartojë studenti për të plotësuar detyrimet e praktikës profesionale, sipas kërkesave të planit mësimor. Në këtë udhëzues duhet të përmbahen modelet: Kërkesa drejtuar institucionit/entit privat për kryerjen e praktikës profesionale; Raporti i studentit praktikant; Raporti i institucionit/entit pritës për rezultatet e studentit; Raporti i vlerësimit të pedagogut udhëheqës, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në “Drejtësi”, ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si një nga njësitë bazë të të Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (FEDSHS). Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale gjatë vitit akademik 2024-2025 ka angazhuar gjithsej 16 anëtarë staf akademik nga të cilët 8 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 8 staf akademik me kontratë (PAK).

Të dhënat për përbërjen dhe kualifikimin shkencor të stafit të Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale për të pesë vitet akademike janë si vijon:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	2	-	-	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-	1	-	2	-
Dr./PhD.	3	1	3	4	5	4	5	2	6	7
Msc.	4	1	4	3	2	1	1	4	-	-
Totali	7	4	7	7	7	6	7	7	8	8

Kjo përbërje është në përputhje me parashikimet e nenit 25/4 të “Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” i cili citon: “Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët tre me grada shkencore ose tituj akademik”.

Sa më sipër, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale plotëson kriterin ligjor mbi numrin e anëtarëve të personelit akademik efektiv në përbërje të departamentit si dhe nivelin e kualifikimit akademik.

Për sa i takon personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë që angazhohet në realizimin e programit të studimit, të dhënat që përcjell institucioni janë si më poshtë:

Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	-	-	-	2	-	1	-	3	-
Dr./PhD.	4	1	8	5	11	6	13	1	11	6
Msc.	2		1	-	4	2	3	4	1	6
Totali	7	1	9	5	17	8	17	5	15	12

Nga të dhënat më sipër evidentohet se në këtë program studimi, përveç stafit akademik me gradën shkencore “Doktor”, si dhe stafit akademik me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, janë angazhuar, ndonëse në një numër të vogël, edhe staf akademik të kategorisë MSc.

Ndonëse kjo kategori është angazhuar në procesin e mësimdhënies në cilësinë e asistent lektorëve, përfshirja në këtë program studimi e kategorisë Msc nuk përputhet me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik të nevojshëm për angazhimin akademik në këtë cikël studim në përputhje me nenin 59/6 të Ligjit Nr. 80/2015 i cili kërkon që: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.

Sa më sipër GVJ rekomandon që institucioni të mundësojë që i gjithë stafi akademik që përfshihet në procesin e mësimdhënies në

	<i>këtë program studimi të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor".</i> <i>Nga analiza e ngarkesës totale të personelit akademik në këtë program studimi konstatohet gjithashtu se në pak raste, veçanërisht mbi të dhënat që i referohen vitit akademik 2024-2025 ka pedagogë të cilët janë angazhuar në procesin e mësimdhënies në mbulimin e disa lëndëve/moduleve të cilat kanë natyrë, veçori dhe fusha studimore të ndryshme, si p.sh mjekësi ligjore dhe e drejtë bankare etj.</i> <i>GVJ rekomandon që në rastet kur personeli akademik mbulon më shumë se sa një lëndë mësimore, ngarkesa të mundësojë mbulimin e lëndëve që kanë natyra, veçori, dhe fushë studimore të përafërta dhe përputhen me fushën akademike kërkimore të personelit akademik që mbulon këto lëndë/module.</i> <i>Në funksion të rritjes së kualifikimit shkencor të personelit akademik, institucioni nxit kërkimin shkencor si dhe pjesëmarrjen e stafit në aktivitete shkencore brenda apo jashtë vendit. Nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte, kryesisht në kuadrin e programit Erasmus + si dhe marrëveshjeve me institucione partnere mundësohet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve. Institucioni mbështet veprimtarinë shkencore të stafit akademik nëpërmjet formave të financimit të botimeve të artikujve shkencore ose në revista prestigjioze me factor impakti.</i> <i>Evidenca "Tabela PIND "tabela 1, tabela 4, tabela 6.1-6.3, tabela 12.1-12.3</i> <i>Evidenca nr. 20 "Organigrama e KUB & Vendimi i Senatit Akademik"</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Për sa i takon mbulimit të ngarkësës mësimore, të dhënat mbi mbulimin e ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë në këtë program studimi janë si vijon. Për vitin akademik 2024-2025 në një total prej 3139 orësh mësimore që i referohen këtij program studimi, 2291 orë mësimore janë mbuluar nga personeli akademik efektiv dhe 848 orë mësimore janë mbuluar nga personeli akademik me kontratë. Përqindja e mbulimit të ngarkesës mësimore është në raportet 73% PAE / 27% PAK.

	Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, ngarkesa mësimore në këtë program studimi është shpërndarë dhe mbulohet në masën më të madhe nga personeli akademik efektiv. Ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë në përputhje me rregullimet e VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, ku parshikohet se: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”. <i>Evidenca “Tabela PIND, tabela 4”</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Punësimi i personelit akademik në KUB bëhet me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, bazuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Me qëllim përzgjedhjen e stafit në përputhje me kriteret ligjore, aktet e brendshme përmbajnë rregullime lidhur me procedurat e rekrutimit të stafit akademik, kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës, si dhe të drejtat e personelit akademik. Rregullime mbi punësimin e personelit akademik parashikohen edhe në kreun VIII të Rregullores së KUB. Aspekte mjaft të detajuar të parimeve dhe procedurave lidhur me punësimin parashikohen në Rregulloren e marrëdhënieve të punës së KUB. Kjo rregullore përcakton parimet themelore, kriteret e përgjithshme për të qënë punonjës i KUB, procesin e përzgjedhjes dhe emërimin, fillimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve si dhe aspekte të përgjegjësisë disiplinore. Me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë në marrëdhëniet e punës, kontratat e punës hartohen në përputhje me Kodin e punës dhe ligjin 80/2015 Për Arsimin e Lartë. Kontratat e punës për personelin me gradën shkencore “Doktor” si dhe personelin e kategorisë “Profesor” lidhen pa afat në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni zbaton detyrimet mbi mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore. <i>Evidenca nr.4 “Rregullore e KUB”</i>

	<i>Evidenca nr. 20 "Organigram e KUB& vendim i Senatit Akademik"</i> <i>Evidenca nr. 12 "Rregullore e marëdhënieve të punës në KUB"</i> <i>Evidenca nr. 78 "Kontratë pune FT_tip"</i> <i>Evidenca nr. 79 "Kontratë punë PT-tip"</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	KUB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me aktet e brendshme rregullatore. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik janë pasqyruar në një bazë të gjerë rregullatore, si Statuti, Rregullorja e KUB, Rregullorja e marëdhënieve të punës në KUB etj. Gjithashtu në procedurat e rekrutimit institucioni zbaton edhe Kodin e Punës si dhe aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë. Kriteret e punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga rektori. Kriteret për emërimin e personelit akademik, kanë në bazë kualifikimet përkatëse akademike dhe përvojat e nevojshme për vendin e punës. Departamenti bazuar në nevojat për staf, specifikon kriteret e përzgjedhjes, të cilat shpallen nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe publikohen në ëëbsite-in zyrtar të KUB. Përzgjedhje dhe procedura e rekrutimit realizohet në përputhje me aktet e brendshme. Përzgjedhja e personelit akademik bëhet, sipas kriterëve të shpallura nga institucioni për rekrutimin e personelit akademik nga një komision "ad - hoc" i ngritur nga Rektori. Përzgjedhja bëhet me konkurim ku vlerësohen përputhshmëria e dosjes me kriteret e përgjithshme dhe ato profesionale të shpallura. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 12 "Rregullore e marëdhënieve të punës në KUB"</i> <i>Evidenca nr. 78 "Kontratë pune FT_tip"</i> <i>Evidenca nr. 79 "Kontratë punë PT-tip"</i> <i>Evidenca nr. 84 "Lista e pedagogëve në KUB për vitin akademik 2023-2024"</i>

	<i>Evidenca nr. 85 " Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik në KUB"</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni dëshmon angazhim të personelit ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore. Ky program nuk ka në përmbajtje të kurrikulës orë laboratorike. Në funksion të programeve mësimore që ofron, Institucioni ka pjesë përbërëse të infrastrukturës së tij edhe disa laboratorë informatike të paisur me kompjutera të cilët funksionojnë edhe si salla interneti. Këta laboratorë përdoren edhe nga studentët e këtij programi për përgatitjen e detyrave të kursit, apo punimin e materialeve si pjesë e detyrimeve të lëndëve/moduleve. Për mirëmbajtjen e këtyre laboratorëve institucioni ka vënë në dispozicion personel ndihmës akademik. Për mirëmbajtjen e mjediseve dhe administrimin e procesit mësimor, gjithashtu angazhohen struktura të tilla si, Sekretaria Mësimore dhe struktura të tjera të shërbimeve . <i>Evidenca nr. "Tabelat PIND, tabela 16"</i> <i>Evidenca nr 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Bazuar në aktet regullatore të brendshme si dhe legjisalcionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, institucioni mban dhe administron të dhënat mbi personelin akademik të përfshirë në programin e studimit. Zyra e Burimeve Njëëzore administron dokumentacionin si dhe dosjet e personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë. Pjesë e dosjeve të personelit janë dhe kualifikimet profesionale. Bazuar në këto të dhëna dosjet e personelit përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke pasqyruar edhe përparimin në kualifikimin akademik apo, ngritjet në detyrë etj. Të dhënat mbi personelin efektiv dhe atë me kontratë të angazhuar në programin e studimit administrohen dhe nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si njësi përgjegjëse për administrimin e programit. Nga të dhënat e përcjella nga institucioni gjenerohet informacioni mbi kualifikimin shkencor, ngarkesën mësimore, si dhe lëndët ose modulet që mbulon personeli akademik i përfshirë në programin e studimit në çdo semestër dhe vit akademik. Institucioni plotëson gjithashtu detyrimet mbi përcjelljen e informacioni mbi personelin e

	angazhuar në programet e studimit për çdo njësi kryesore ose bazë, në strukturat kompetente të tilla si ASCAL dhe MAS. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 4, tabela 6.1-6.3, tabela 12.1-12.3"</i> <i>Evidenca nr.86 "Përmbajtje dokumtare e dosjes së stafit FT"</i> <i>Evidenca nr.87 "Përmbajtje dokumtare e dosjes së stafit PT"</i> <i>Evidenca nr.84 "Lista e pedagogëve në KUB për vitin akademik 2023-2024"</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Me qëllim nxitjen e bashkëpunimit akademik me institucione partnere, organizata apo përfaqësues e kompani biznesi, KUB ka lidhur një sërë marrëveshjesh me aktorë të tillë. Në këtë kuadër, një sërë marrëveshjesh me institucione publike, organizata profesionale e kompani biznesi janë lidhur edhe në funksion të këtij programi studimi. Një pjesë e këtyre marrëveshjeve janë lidhur për përbushjen e detyrimeve mbi zhvillimin e praktikës profesionale dhe i shërbejnë realizimit të praktikave për studentët e këtij programi. Marrëveshje të tilla bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe private si dhe kompani biznesesh, ndikojnë pozitivisht edhe në rritjen e mundësive të punësimit të studentëve pas diplomimit. Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale vë në dispozicion të studentëve pedagogët mbikqyrës për të mundësuar orientimin e studentëve dhe kordinimin me institucionet ku zhvillohet praktika. Praktika në këtë program studimi zhvillohet në vitin e pestë me një total prej 12 kreditesh. Përmbyllja e detyrimeve në këtë program bëhet më temë diplome. Studentët mbikqyren edhe udhëhiqen nga pedagogët e departamentit edhe në procesin e zhvillimit të temës së diplomës. Institucioni disiplinon me akte të posaçme aspektet që lidhen me zhvillimin e praktikave profesionale dhe mbrojtjen e diplomës. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 5"</i> <i>Evidenca nr. 21 " Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë"</i>

	<i>Evidenca nr 27 "Udhëzues për përgatitjen e praktikës profesionale"</i> <i>Evidenca nr.27.1 "Model raporti TIP për kryerjen e praktikës"</i> <i>Evidenca nr.27.2 "Marëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikat Profesionale"</i> <i>Evidenca nr 118 "Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë"</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni dëshmon angazhimin e duhur të personelit akademik në realizimin e praktikave profesionale. Për kryerjen e praktikave profesionale në këtë program studimi, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe private ku parashikohen edhe detyrimet e palëve në realizimin me sukses të praktikave profesionale. Në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për zhvillimin e praktikës profesionale, bizneset apo institucionet publike apo private ku do të zhvillohet praktika profesionale, përmbushin disa detyrime të caktuara. Kompanitë apo institucionet ku zhvillohet praktika e ndihmojnë studentin dhe e asistojnë gjatë kohëzgjatjes së zhvillimit të praktikës. Për këtë qëllim, mund të caktohet edhe një përfaqësues i cili mbikqyr studentët gjatë kohëzgjatjes së praktikës dhe mban lidhje me pedagogun përgjegjës për aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e praktikës. Në përfundim të praktikës profesionale institucioni ku kryhet praktika përgatit një vlerësim për secilin nga studentët pjesëmarrës. Ky vlerësim merret në konsideratë edhe nga Komisioni i mbrojtjes së praktikës i cili vlerëson studentët në përfundim të procesit. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 5"</i> <i>Evidenca nr. 27 "Udhëzues për zhvillimin e praktikës profesionale"</i> <i>Evidenca nr.27.1 "Model raporti TIP për kryerjen e praktikës"</i> <i>Evidenca nr.27.2 "Marëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikat Profesionale"</i>
Konkluzione	<i>Në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi janë angazhuar, ndonëse në një numër të vogël, edhe staf akademik të kategorisë Msc, çka nuk përputhet me kërkesat ligjore në fuqi për</i>

	nivelin e duhur të kualifikimit akademik të nevojshëm për angazhimin akademik në programet e integruara të nivelit të dytë. <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni të mundësojë që i gjithë stafi akademik që përfshihet në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Nga analiza e ngarkesës totale të personelit akademik në këtë program studimi konstatohet se në pak raste, veçanërisht në të dhënat që i referohen vitit akademik 2024-2025, ka pedagogë të cilët janë angazhuar në procesin e mësimdhënies në mbulimin e disa lëndëve/moduleve, të cilat kanë natyrë, veçori dhe fusha studimore të ndryshme, si p.sh mjekësi ligjore dhe e drejtë bankare etj. <u>GVJ rekomandon</u> që në rastet kur personeli akademik mbulon më shumë se sa një lëndë mësimore/modul, ngarkesa të mundësojë mbulimin e lëndëve që kanë natyra, veçori, dhe fusha studimore të përafërta dhe përputhen me fushën akademike kërkimore të personelit akademik që mbulon këto lëndë/module. KUB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik, bazuar në kritere të shpallura publikisht si dhe garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik. Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale dhe zhvillimin e temave të diplomave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin	KUB garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor në këtë program studimi. Referuar dokumentacionit, mjediset ku zhvillohet veprimtaria mësimore në këtë program studimi shtrihen në një sipërfaqe prej 2051 m ² .

e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Për zhvillimin e procesit mësimor në këtë program studimi janë në dispozicion 4 salla leksionesh me sipërfaqe prej 261 m², si dhe 8 klasa seminaresh me sipërfaqe 337 m². Institucioni disponon gjithashtu një sërë mjedisesesh në funksion të procesit mësimor si, një sallë biblioteke me sipërfaqe 47m², mjedis për fotokopjime dhe librari me sipërfaqe 26m², zyrë informacioni për studentët me sipërfaqe 4m² etj. Në këto mjedise janë ngritur dhe funksionojnë edhe laboratorë nga të cilët, dy janë laboratorë informatike që mund të përdoren nga studentët e këtij programi studimi. Mjediset e vëna në dispozicion për stafin akademik, atë ndihmës akademik dhe administrativ të cilat përbëhen kryesisht nga zyra, janë në total 211 m². Pjesë e mjediseve në funksion të studentëve dhe stafit janë gjithashtu edhe mjediset e shërbimit, mjediset shplohëse si kafeteri, nyjet hidrosanitare për studentët etj. Në të gjitha mjediset funksionon sistemi i palimituar në internet. Me qëllim krijimin e kushteve sa më optimale për zhvillimin një aktiviteti normal mësimdhënës dhe atij mbështetës, mjediset janë të paisura gjithashtu me sistem kondicionimi, sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, sistemin e fonisë, sistemin e emergjencës etj. <i>Evidenca nr. "Tabelat PIND, tabela 16"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore, si ato në funksion të procesit të mësimdhënies në këtë program studimi, ashtu edhe ato në funksion të stafit dhe shërbimit ndaj studentëve, janë paisura me mjetet e nevojshme teknologjike që mundësojnë zhvillimin normal të aktivitetit të përditshëm të institucionit dhe realizimin e procesit mësimor përmes përdorimit të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha sallat dhe ambientet e mësimdhënies janë të paisura me kopjuterat Lab Top, video projektorë, vidoprojektorë, kamera si dhe tabela shkrimi. Në të gjitha mjediset e zhvillimit të mësimdhënies, por edhe mjediset e tjera në funksion të procesit të mësimdhënies, mundësohet akses i palimituar në internet dhe mbulimi me

	sistemin e wi-fi. Të gjitha paisjet kompjuterike janë të lidhura në rrjet duke lehtësuar sistemin e komunikimit. Si studentët ashtu edhe stafi akademik, kanë akses në sistemet që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore në funksion të realizimit me sukses të procesit mësimor. <i>Evidenca nr. "Tabelat PIND, tabela 16"</i> <i>Evidenca nr.80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr.80.1 "Kontarta e qirasë e Godinës në përdorim KUB"</i> <i>Evidenca nr. 80.2 "Realcioni i ekspertit të pavarur për infrastrukturën e godinës në përdorim KUB"</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mjediset e institucionit, si klasat dhe laboratorët janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme që i shërbejnë edhe nevojave të aftësimit të studentëve në përputhje me objektivat formues të këtij programi studimi. Siç evidentohet në kriterin 2, mjediset e mësimdhënies së këtij institucioni janë të paisura me mjete audiovizive, kompjutera si dhe akses të palimituar në internet. Të gjitha paisjet kompjuterike janë të lidhura dhe mundësojnë aksesin në internet. Në të gjitha mjediset e mësimdhënies si dhe ato mbështetëse mundësohet sistemi i wi-fi. Paisje të tilla mundësojnë zhvillimin e procesit të mësimdhënies në përputhje me natyrën dhe objektivat formues të këtij programi studimi. <i>Evidenca nr. "Tabelat PIND, tabela 16"</i> <i>Evidenca nr.80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr.80.1 " Kontarta e qirasë e godinës në përdorim KUB"</i> <i>Evidenca nr. 80.2 "Realcioni i ekspertit të pavarur për infrastrukturën e godinës në përdorim KUB"</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas	Konsideruar larmishmërinë e programeve të studimit që ofron, KUB ka përshtatur mjediset e mesimdhënies me nevojat e zhvillimit cilësor të procesit të mësimdhënies dhe aftësimit teoriko praktik të studentëve. Për realizimin e këtij qëllimi, në mjediset e KUB janë ngritur dhe funksionojnë 4 laboratorë, laborator i mekanikës, laborator elektrik dhe i elektronikës si

natyrës së programit të studimit që ofron.	dhe dy laboratorët e informatikës. Njëri prej laboratorëve ka 20 komplete kompjuterash (PC) dhe laboratorit tjetër ka 50 të tillë. Programi i studimit Master i Shkencave (PI) “Në Drejtësi” nuk ka në përmbajtje orë laboratorike. Laboratorët e informatikës me kapacitetet dhe infrastrukturën e nvojshme aksesohen edhe nga studentët e këtij programi për arsye studimore dhe kërkimore. Studentët e këtij programi përdorin laboratorin për marrjen e informacioneve nga interneti, hartimin e detyrave të kursit, prezantimeve e detyrimeve të tjera lidhur me procesin mësimor. <i>Evidenca “RVB Program i Integruar në Drejtësi”</i> <i>Evidenca “Tabelat PIND, tabela 16”.</i> <i>Evidenca nr. 80 “Relacion mbi infrastrukturën e KUB”</i> <i>Evidenca nr.80.1 “ Kontrata e qirasë e godinës në përdorim KUB”</i> <i>Evidenca nr. 80.2 “Relacion i ekspertit të pavarur për infrastrukturën e godinës në përdorim KUB”</i> <i>Evidenca nr.80.1 “ Kontrata e qirasë e godinës në përdorim KUB”</i> <i>Evidenca nr. 80.2 “Relacion i ekspertit të pavarur për infrastrukturën e godinës në përdorim KUB”</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë	Lidhja e një numri të konsiderueshëm marrëveshesh me një sërë aktorësh si institucione shtetërore, organizata, kompani e biznese, mundëson zhvillimin e praktikës profesionale në kushte optimale infrastrukturore. Për shkak të natyrës së këtij programi studimi, i cili synon marrjen e njohurive të thelluara në fushën juridike, praktikën profesionale zhvillohet në mjediset e institucioneve me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi. Bazuar në marrëveshjet e lidhura mbi zhvillimin e praktikës profesionale, institucionet me të cilat lidhet marrëveshje marrin masat për sistemimin e studentëve në ambientet e tyre si dhe asistimin gjatë zhvillimit të praktikës. Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve dhe pedagogëve të ngarkuar për mbikqyrjen e praktikës krijon për studentët mundësinë për zhvillimin e praktikës profesionale në kushtet e nevojshme dhe në përputhje me nevojat e aftësimit praktik.

strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Evidenca nr. "Tabelat PIND, tabela 16" Evidenca nr.80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB" Evidenca nr. 21 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë"			
Konkluzione	KUB mundëson kapacitetet infrastrukturore të përshtashme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në programin Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi". Mjediset mësimore dhe ato mbështetëse janë të paisura me mjetet dhe teknologjinë e nevojshme për të mundësuar një proces mësimor në përputhje me objektivat formues të programit. Studentëve të këtij programi u mundësohet infrastruktura dhe kushtet e nevojshme për zhvillimin e praktikës profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve/moduleve pjesë e dosjes së vetvlerësimit evidentohet se literatura është një nga komponentët e programit të lëndëve. Syllabuset e lëndëve në këtë program mësimor përmbajnë si literaturën bazë, ashtu edhe literaturën ndihmëse. Duke qënë se ky program është në gjuhën shqipe, literatura e detyrueshme është gjithashtu në gjuhën shqipe, kryesisht në formën e teksteve bazë. Nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se literatura, specifikohet për secilën nga temat e leksioneve. Në raste kur lënda ose moduli nuk ka tekst bazë në gjuhën shqipe, studentëve u vihen në dispozicion ciklet e leksioneve të pregatitura nga titullari i lëndës. Materialet e pregatitura nga pedagogët mund të aksesohen nga studentët edhe nëpërmjet adresave elektronike.

	Pjesë e syllabuseve është gjithashtu edhe literatura ndihmëse e cila përbehet si nga burime në gjuhën shqipe, ashtu edhe nga burime në gjuhë të huaj. Nga syllabuset e vëna në dispozicion, konstatohet se burimet e literaturës përshtaten me natyrën e programit dhe përmbajtjen e syllabuseve. Burimet e literaturës janë të aksesueshme në fondin fizik të bibliotekës, ose në adresat on-line të bibliotekave dixhitale. Biblioteka e KUB mundëson aksesin në një sërë linqesh dhe burimesh on-line të literaturës që i referohet edhe këtij programi studimi. Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion leksione në formatin elektronik nëpërmjet adresave zyrtare të emailit si dhe platformës Google Class Room. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 13, tabela 17"</i> <i>Evidenca nr. 48 "Lista e teksteve të reja për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr. 74 "Guida e stafit për përdorimin e platformës Classroom-KUB"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Raalcion mbi infrastrukturën"</i> <i>Evidenca nr. 89 "Model përmbledhje leksioni nga libraria e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 90 "Marëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në përditësimin e literaturës në mbështetje të programit të studimit. Në përputhje me detyrimet si njësia përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi mësimor, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, përditëson programet mësimore. Çdo vit të ri akademik, titullarët e lëndëve përditësojnë dhe paraqesin në departament programet e reja të lëndëve. Në kuadrin e procesit të përditësimit të programeve mësimore, ndryshime pëson edhe literatura, e cila gjithashtu pasqyron risitë në literaturën juridike të fushës. Për këtë qëllim departamentet iniciojnë kërkesat për blerjen e literaturës në përshtatje me nevojat mësimore dhe shkencore. Mbi bazën e

	nevojave dhe kërkesave që vijnë nga departamentet mundësohet rinovimi i burimeve të bibliotekës. Bazuar në kërkesat e departamenteve, institucioni parashikon shpenzime për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës me tekste të rinj. Nga analiza e strukturës së shpenzimeve të kryera nga institucioni, evidentohet se pasurimi i fondit fizik dhe atij dixhital të bibliotekës me burime të reja të literaturës është një nga zërat e shpenzimeve që institucioni realizon në kuadrin e hartimit të buxhetit. Pjesë e përditësimit të literaturës janë edhe punimet shkencore të pedagogëve në formën e botimeve në revista shkencore apo pjesëmarrjes në konferenca. Gjithashtu KUB zhvillon çdo vit konferencën shkencore vjetore si dhe publikon revistën e tij periodike. Botimet e punimeve shkencore të kësaj natyre depozitohen në bibliotekën e KUB dhe shërbejnë edhe si burim i përditësimit të literaturës. <i>Evidenca nr. 48 "Lista e teksteve të reja për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr. 89 "Model përmbledhje leksioni nga libraria e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 90 "Marëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-bibloteka"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë së mësimdhënies, KUB ka ngritur dhe bërë funksionale bibliotekën si dhe ka rregulluar veprimtarinë e saj mbi bazën e një rregulloreje të veçantë. Bibloteka është e pozicionuar në të njëjtën godinë ku zhvillohet procesi i mësimdhënies në këtë program studimi, duke lehtësuar aksesin e studentëve. Bibloteka shtrihet në një sipërfaqe prej 47 m² dhe ka një kapacitet prej 50 personash. Studentët e këtij programi studimi mund të aksesojnë në bibliotekë të gjitha tekstet mësimore ose ciklet e leksioneve, pjesë e literaturës së lëndëve ose moduleve. Përveç fondit fizik, studentët mund të aksesojnë edhe fondin dixhital, i përbërë nga bibliotekat ndërkombëtare on-line ku mundësohet aksesin në një numër mjaft të gjerë tekstesh dhe artikujsh shkencorë. Aksesin jo vetëm ndaj burimeve fizike të literaturës, por edhe atyre on-line, i ndihmon studentët në gjetjen

	e burimeve të literaturës së nevojshme edhe për përmbushjen e detyrimeve të procesit mësimor, si, hartimin e detyrave të kursit, temave të diplomave apo detyrimeve të tjera në raport me lëndët. Nga vëzhgimi në mjediset e bibliotekës u konstatuan ambiente të përshtatshme për shfrytëzimin e burimeve të literaturës nga studentët. Biblioteka disponon një sallë leximi për studentët dhe stafin akademik e paisur me infrastrukturën e nevojshme. Në sallën e bibliotekës janë instalura gjithashtu kompjutera (lap top) me akses në internet. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 17".</i> <i>Evidenca nr. 48 "Lista e teksteve të reja për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 89 "Model përmbledhje Cikël Leksioni nga libraria e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 90 "Marëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i> <i>Evidenca nr. 92 "Rregullore e Bibliotekës"</i> <i>Evidenca nr 93 "Kërkese për tërheqje librash nga biblioteka_TIP"</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e KUB është e paisur me fondin fizik të përbërë nga burime të literaturës si në në gjuhën shqipe, ashtu dhe në gjuhë të huaj. Fondi fizik i bibliotekës disponon një numër prej rreth 7000 ekzemplarë tekstesh në dispozicion për qëllime studimore kërkimore, për të gjitha programet e studimit që ofron institucioni. Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, e cila përdoret për mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi". Komponet i rëndësishëm i fondit fizik të bibliotekës janë tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve të cilat janë edhe pjesë e literaturës së detyrueshme të programeve të lëndëve. Pjesë e këtij fondi janë gjithashtu, edhe revistat periodike shkencore si

	dhe materialet e konferencave shkencore të botuara në Proceeding që KUB zhvillon në kuadrin e veprimtarisë shkencore. Një komponent tjetër i burimeve të fondit fizik të literaturës, janë edhe botimet periodike të institucioneve shtetërore, kryesisht në formën e donacioneve. Burimet e bibliotekës pasurohen nëpërmjet donacioneve si dhe blerjeve që institucioni mundëson për pasurimin e fondeve të bibliotekës. <i>Evidenca nr. 48 "Lista e teksteve të reja për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 89 "Model përmbledhje Cikël Leksioni nga libraria e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Përveç burimeve fizike, një pjesë mjaft të rëndësishme të fondit të bibliotekës së KUB e zë fondi dixhital i bibliotekës, i cili përbëhet nga një sërë bibliotekash on-line. Fondi on-line i bibliotekës është mundësuar si pasojë e marrëveshjes dhe abonimit në JSTORE, i cili mundëson qasjen ndaj literaturës bashkohore të dixhitalizuar nëpërmjet aksesit në një sërë bibliotekash on-line. Institucioni financon këtë akses nëpërmjet rinovimit çdo një vit të abonimit në këtë platformë dixhitale. Studentëve të KUB u vihen në dispozicion e gjithë literatura në përbërje të fondit fizik dhe atij on-line të bibliotekës. Biblioteka mundëson akses të lirë në burimet e literaturës, pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe personelin akademik. Biblioteka dixhitale është lehtësisht e aksesueshme edhe nga ambientet e zyrës, ndërsa studentët mund ta aksesojnë nga biblioteka. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 17"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 90 "Marëveshje bashkëpunimi JSTORE/e-biblioteka"</i>

	<i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka ka një infrastrukturë të përshtashme dhe është e paisur me mjete si karrige, tavolina, etj që mundësojnë shfrytëzimin e saj dhe kërkimin e literaturës. Biblioteka është e paisur gjithashtu me mjete të tilla si, kompjutera Lab Top të cilat nëpërmjet aksesit në internet, lehtësojnë punën kërkimore dhe studimore të studentëve. Institucioni nëpërmjet bashkëpunimit me platforma të tilla si JSTORE ka mundësuar përdorimin e një rrjeti bibliotekash online me akses të lirë për studentët dhe personelin akademik. Si të tilla përmendim: jstore.org, academia.edu, gutenberg.org, ebsco.com/public-libraies etj. Aksesit i studentëve ndaj këtyre bibliotekave është falas. Nëpërmjet adresave zyrtare elektronike, studentëve u mundësohet lehtësisht aksesit në sistemin e bibliotekave on-line, si dhe kërkimi në burime të pasura të literaturës në gjuhë të huaj. Infrastruktura e bibliotekës mundëson që studentët të përdorin lehtësisht burimet e bibliotekave dixhitale. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 17"</i> <i>Evidenca nr. 92 "Rregullore e Bibliotekës"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Për të mundësuar shfrytëzimin e barabartë të mjedisëve të bibliotekës, biblioteka qëndron e hapur në dispozicion të studentëve në oraret nga ora 9.00-15.00 dhe 16.00-20.00 ditën e mërkurë, të enjten dhe të premten. Në ditët e tjera qëndron e hapur gjatë orarit zyrtar të punës. Kjo fashë orare mundëson aksesimin e bibliotekës edhe në orarin e mbasdites për studentët të cilët e zhvillojnë mësimin mbasdite. Ky orar mundëson shfrytëzimin e bibliotekës edhe për studentët që e zhvillojnë mësimin në orarin e mbasdites, përfshirë edhe studentët e këtij programi studimi. Në këtë mënyrë, mundësohet shërbimi i bibliotekës në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët që ndjekin programet e studimit pranë institucionit, pavarësisht nga orari i zhvillimit të mësimin. Biblioteka është e frekuentueshme gjatë gjithë vitit, me përjashtim të ditëve të

	festave zyrtare, muajit gusht dhe periudhës së pushimeve në fund të vitit. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 17"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 92 "Rregullore e Biblotekës"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i biblotekës së KUB"</i>
Kriteri 8.Bibloteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të biblotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bibloteka ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Rregulloren e Biblotekës si dhe përcaktimet në aktet brendshme rregullatore. Administrimi i biblotekës mundësohet nga një person përgjegjës, i cili ndjek dhe kordinon gjithë procedurat e shërbimeve pranë biblotekës si dhe mbarëvajtjen e fondit fizik. Personi i ngarkuar me administrimin e biblotekës bashkëpunon me njësitë kryesore dhe ato bazë, duke informuar për fondet e teksteve të reja apo fondin on-line të ofruar nga bibloteka. Si pasojë e bashkëpunimit me njësitë kryesore dhe ato bazë, dhe identifikimit të nevojave për rinovimin e literaturës, mundësohet pasurimi i fondit fizik dhe atij on-line të biblotekës. Aspekti më i rëndësishëm i inisiativës për pasurimin e burimeve të biblotekës janë kërkesat e njësive bazë referuar nevojave të personelit akademik për literaturë bashkohore. Bazuar në këto kërkesa, institucioni planifikon fonde për blerjen e literaturës dhe përfshin në fondin e shpenzimeve të buxhetit edhe fondet për blerjen e teksteve të reja dhe pasurimit të fondit on-line. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 17"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i biblotekës së KUB"</i> <i>Evidenca nr. 92 "Rregullore e Biblotekës"</i>
Konkluzione	<i>Syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi kanë pjesë përbërëse edhe literaturën bazë dhe atë të rekomanduar.</i> <i>Institucioni ka pjesë të infrastrukturës biblotekën dhe siguron akses të barabartë dha pa pagëse në fondin fizik dhe on line të saj.</i> <i>Studentët dhe stafi akademik i këtij programi studimi mund të përdorin falas shërbimet e biblotekës dhe të aksesojnë</i>

	<i>literaturën në funksion të nevojave të programit si dhe të veprimtarisë kërkimore shkencore.</i> <i>KUB mundëson pasurimin e fondit fizik dhe atij on-line të bibliotekës referuar nevojave të personelit akademik për literaturë bashkohore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	KUB administron dhe menaxhon të dhënat dhe dokumentacionin që lidhet me studentët nga regjistrimi i tyre, deri në momentin e diplomimit. Gjithashtu administron dhe menaxhon dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe gjithë ciklin akademik deri në përfundimin e programit të studimit. Për të mundësuar administrimin e të dhënave të studentëve, gjatë gjithë ciklit akademik, ngrihet dhe funksionon Sekretaria Mësimore. Kjo strukturë ushtron kompetencat e saj në përputhje me një rregullore të posaçme, Rregullorja e Sekretarisë Mësimore. Brenda institucionit janë ngritur dhe funksionojnë disa degë të Sekretarive Mësimore, të cilat kanë kompetenca të përcaktuara. Struktura përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit të studentëve të këtij programi studimi është Sekretaria Mësimore e FEDSHS. Në përputhje me Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, Sekretaria administron dokumentacionin e studentëve dhe atë që lidhet me procesin mësimor, ruan dhe administron dosjet e studentëve, si dhe administron regjistrat dhe procesverbalet e provimeve lidhur me programin Master i Shkencave (PI) në “Drejtësi”. Nga verifikimi në Sekretarinë Mësimore u konstatua se në lidhje me këtë program studimi, pranë Sekretarisë Mësimore administrohen regjistrat si vijon: • Regjistri themeltar i studentëve;

	• Regjistri i arritjeve akademike; • Regjistri i të diplomuarve. Nga vëzhgimi nuk u konstatuan parregullsi në administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave. Regjistri themeltar i studentëve administrohej, jo vetëm në format të shkruar, por edhe në format elektronik. GVJ verifikoi gjithashtu disa dosje të studentëve ku u konstatua administrimi i rregullt i të dhënave. <i>Evidenca nr. 20 "Organigrama e KUB & Vendim i Senatit Akademik"</i> <i>Evidenca nr 40 "Paketa e regjistrimit të studentit"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. "Dosja e Programit të Studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr. 94 "Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA"</i> <i>Evidenca nr. 95 "Regjistri i rezultateve/performancës së studentit"</i> <i>Evidenca nr.114 "Proces verbal verifikimi të dhënash regjistër amze/arritje akademike"</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nëpërmjet akteve të brendshme KUB ka mundur funksionimin e strukturave që administrojnë dhe menaxhojnë të dhënat, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, atij mbështetës dhe aktorëve të tjerë të angazhuar në programin e studimit. Aktet rregullatore të brendshme parashikojnë mbarëvajtjen dhe funksionimin e një sërë strukturash përgjegjëse si Sekretaria Mësimore, Zyra e Protokollit, Zyra e Burimeve Njerëzore, Departamentet etj. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për ruajtjen e proces verbaleve dhe regjistrave ku pasqyrohen të dhënat mbi realizimin e procesit mësimor nga personeli akademik efektiv ose me kontratë. Zyra e Burimeve Njerëzore administron dokumentacionin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Zyra e Protokollit gjithashtu administron dokumentacionin shkresor në lidhje me veprimtarinë akademike dhe administrative që zhvillohet brenda institucionit në përputhje me sferën e kompetencave. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale administron dhe menaxhon të dhënat lidhur me studentët

	dhe personelin akademik që mbulon programin e studimit. Aktet e brendshme kanë të përcaktuara qartë detyrat, funksionet si dhe sistemin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet strukturave, duke mundësuar një sistem efikas të administrimit dhe menaxhimit të informacionit. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale"</i> <i>Evidenca nr. 20 "Organigrama e Kolegjit Universitar "i Biznesit" & Vendim i Senatit Akademik"</i> <i>Evidenca nr.10 "Rregullore e Zyrës së Arkivit"</i> <i>Evidenca nr 40 "Paketa e regjistrimit të studentit"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 31 "Raport vjetori i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023"</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	KUB nëpërmjet strukturave të dedikuara menaxhon dhe administron informacionin dhe dokumentacionin mbi këtë program studimi, studentët e regjistruar në program si dhe personelin akademik që mbulon programin. Strukturat përgjegjëse administrojnë në mënyrë të rregullt dokumentacionin si dhe koordonojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë që të mundësohet një sistem efikas i administrimit dhe menaxhimit të informacionit. Për të rritur aksesin në informacion, KUB mundëson përdorimin e platformave të tilla si <i>portali</i> nëpërmjet të cilit mundëson shpërndarjen e informacionit nëpërmjet sistemeve të dedikuara. Përdorimi nga pedagogët i domainit në websiten e KUB, mundëson shkëmbimin në kohë reale të informacionit me studentët e këtij programi. Në këtë mënyrë, studentëve u mundësohet akses nëpërmjet sistemit të informacioneve lidhur me leksionet e shkruara, detyrimet ndaj lëndëve, detyrave të kursit, rezultateve të vlerësimit të vazhduar apo çdo informacioni tjetër që i referohet këtij programi studimi. Gjithashtu, edhe strukturat e tjera akademike dhe administrative posedojnë adresa të unifikuara zyrtare të emailit nëpërmjet të cilave komunikojnë në domainin e ëbsite të KUB duke

	mundësuar shkëmbimin dhe menaxhimi i informacionit nëpërmjet postës zyrtare elektronike. <i>Evidenca nr. 52 " Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e "GOOGLE APS"</i> <i>Evidenca nr. 74 "Guida e stafit për përdorimin e paltformës Classroom KUB"</i> <i>Evidenca nr. 96 "Guida e studentëve për përdorimin e paltformës Classroom KUB"</i> https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit të informacionit realizohet nëpërmjet platformës <i>portali</i> që mundëson forma të komunikimit interaktiv të informacionit. Mbi aspektet që i referohen procesit mësimor, nëpërmjet sistemit të dedikuar <i>portali</i>, mundësohet komunikimi dhe shpërndarja e informacionit mbi veprimtarinë mësimore, syllabuset e lëndëve, leksionet e shkruara dhe materialet, detyrat e kursit, vlerësimet e lëndëve etj. Nëpërmjet kësaj platforme studentët marrin në kohë reale dhe në distancë një sërë informacionesh mbi veprimtarinë mësimore, si dhe komunikojnë me pedagogët e lëndëve për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Pedagogët dhe personeli administrativ i KUB gjithashtu përdorin platformën <i>portali</i> i cili aksesohet nëpërmjet adresës zyrtare të emailit të unifikuar nën domeinin e KUB, nëpërmjet të cilës lehtësohet komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit. Të gjitha paisjet kompjuterike janë të vendosura në rrjet, i cili kontrollohet nga një main-server. Marrja e informacionit mundësohet edhe nëpërmjet faqes zyrtare të KUB, e cila përmban informacion të hollësishëm mbi aspekte të strukturës organizative, programeve të studimit, si dhe personelit akademik. <i>Evidenca nr. 52 " Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e "GOOGLE APS"</i> <i>Evidenca nr. 74 "Guida e stafit për përdorimin e paltformës Classroom KUB"</i> <i>Evidenca nr. 96 "Guida e studentëve për përdorimin e paltformës Classroom KUB"</i>

	<i>Faqja zyrtare e institucionit: ëëë.kub.edu.al</i> <i>https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	KUB ka vënë në funksion dhe përdor një platformë institucionale të menaxhimit të informacionit, platformën <i>portali</i>. Aksesimi në këtë platformë realizohet nëpërmjet logimit me adresat zyrtare të emailit. Nëpërmjet sistemit të <i>portalit</i> bëhet i mundur dokumentimi dhe shpërndarja e materialeve mësimore. Platforma e <i>portalit</i> të KUB mundëson jo vetëm komunikimin në kohë reale midis studentëve dhe pedagogëve, por edhe monitorimin e veprimtarisë akademike dhe gjithë komponentëve të procesit të mësimdhënies. Strukturat hierarkike mund të monitorojnë procesin akademik si dhe përmbushjen e detyrimeve në raport me procesin e mësimdhënies nga ana e pedagogëve. Në këtë mënyrë, strukturat përgjegjëse monitorojnë procesin mësimor që lidhet me këtë program studimi si dhe raportojnë tek autoritet drejtuese. Gjithashtu monitorimi realizohet në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet e brendshme, edhe nga struktura të tjera si NJSBC në kuadrin e proceseve të vetvlerësimit. Të gjitha spektet që lidhen me procesin mësimor, veprimtarinë akademike dhe cilësinë e mësimdhënies janë pjesë e raporteve vjetore, që nga niveli i njësisë bazë deri në Raportin Vjetor Institucional të KUB. Për sa i takon aktivitetit të strukturave administrative dhe ndihmëse, monitorimi i veprimtarisë së tyre realizohet nga autoritet drejtuese në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet e brendshme. Këto struktura janë gjithashtu pjesë e proceseve vlerësuese në kuadrin e sistemit të vetvlerësimit. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 30 "Raport vjetor i veprimtarive FEDSHS, viti akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 31 "Raport vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 46 "Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024"</i>

	<i>Evidenca nr. 58 "Raporti vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB, 2021-2022, 22-23, 23-24"</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KUB posedon dhe administron faqen zyrtare të internetit. Kjo faqe është një burim i rëndësishëm informacioni ku mundësohet akses në kohë reale mbi ofertën akademike dhe institucionale. Nga hulumtimi i kësaj faqeje, konstatohet se faqja zyrtare e KUB është ndërtuar dhe përmban informacion në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nga hulumtimi i faqes zyrtare të institucionit, konstatohet gjithashtu se kjo faqe përmban të dhënat kryesore mbi personelin akademik, strukturën organizative të institucionit, përmbajtjen e programeve të studimit etj. Në këtë faqe gjenden informacione mbi aktivitetet e ndryshme shkencore dhe veprimtari të tjera të ndërmara nga institucioni. Në këtë faqe mund të aksesohen edhe aktet rregullatore më të rëndësishme të KUB, si Statuti, Rregullorja e KUB, Raporti Vjetor i Veprimtarisë etj. Informacionet e publikuara në këtë faqe azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme. <i>Faqja zyrtare e institucionit: ëëë.kub.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni administron dhe monitoron aktivitetin akademik, të dhënat dhe dokumentacionin lidhur me programet e studimit. Nëpërmjet strukturave të dedikuara, KUB menaxhon dhe administron informacionin mbi këtë program studimi, studentët e regjistruar në program dhe personelin akademik që mbulon programin, si dhe monitoron aktivitetin akademik dhe administrativ.</i> <i>Sistemi i menaxhimit të informacionit mbi programin e studimit realizohet nëpërmjet platformës portali që mundëson komunikimin në kohë reale dhe shkëmbimin interaktiv të informacionit nëpërmjet studentëve dhe pedagogëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	KUB ushtron veprimtarinë financiare në përputhje me rregullimet e legjislacionit në fuqi si dhe aktet e brendshme rregullatore. Institucioni mbështet financiarisht programet e studimit që ofron, si dhe pasqyron gjendjen e tij financiare. Për këtë qëllim, në përputhje me aktet e brendshme rregullatore, struktura të tilla si, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit ushtrojnë edhe kompetenca në fushën financiare. Gjithashtu edhe struktura të tjera si drejtuesit e departamenteve apo njësi kryesore ushtrojnë kompetenca në fushën financiare. Këto struktura planifikojnë përdorimin e të ardhurave në nivel fakultetesh dhe departamentesh nëpërmjet hartimit të plan buxhetit ku përcaktojnë nevojat lidhur me mbarëvajtjen e programeve të studimit. Më tej, Bordi i Administrimit me propozim të Senatit, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikqyr zbatimin e tij. Gjithashtu, ky bord përcakton rregulla për shpërndarjen e të ardhurave si dhe mbikqyr përdorimin e burimeve financiare. KUB finalizon çdo vit veprimtarinë financiare nëpërmjet miratimit të Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë akademike dhe financiare” dhe hartimit të Pasqyrave Financiare Vjetore. Këto pasqyra përmbajnë informacione mbi të ardhurat që përfiton institucioni si dhe shpenzimet e kryera në funksion të realizimit të programeve të studimit si shpenzimet për paga, për bibliotekën, kërkimin shkencor, kostot operative dhe të mirëmbajtjes së mjediseve dhe teknologjive etj. <i>Evidenca nr.4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 5 “Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS”</i> <i>Evidenca nr. 47 “Relacion për realizimin e buxhetit 2022 dhe planifikimi 2023 KUB”</i> <i>Evidenca nr. 57 “Vendim i BA për mbështetjen financiare për kërkimin shkencor të stafit akademik KUB”</i> <i>Evidenca nr. 28 “ Raport vjetori i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2023-2024”</i>

Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	KUB menaxhon veprimtarinë e tij financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi veprimtarinë financiare dhe kontabilitetin. Parashikime mbi aktivitetin financiar pasqyrohen edhe në rregulloret e brendshme të institucionit. Në hartimin e projekt buxhetit konsiderohen nevojat e njësive kryesore dhe njësive bazë për financimin e programeve të studimit. Në miratimin e buxhetit, Bordi i Administrimit konsideron prioritetet e institucionit si dhe nevojën për financimin e programeve mësimore që ky institucion ofron. Pasqyrat financiare të KUB përmbajnë të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara nga institucioni. Nga dokumentacioni evidentohet se KUB realizon shpenzime të tilla si, shpenzime për financimin e burimeve njerëzore, kërkimin shkencor, shpenzime operative që i referohen infrastrukturës dhe teknologjisë, shpenzime për pasurimin e literaturës dhe shtimit të fondit fizik dhe online të bibliotekës etj. Pjesë e fondit të shpenzimeve janë edhe ato për financimin e botimeve të stafit, në funksion të kualifikimit shkencor për të cilat institucioni ndjek një politikë të veçantë. Ndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel departamentesh merr në konsideratë, nevojat për realizimin e programeve të studimit, numrin e studentëve dhe stafin akademik dhe administrativ të angazhuar. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 18"</i> <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për realizimin e Buxhetit 2022 dhe planifikimi 2023 KUB"</i> <i>Evidenca nr 57 "Vendim i BA për mbështetjen financiare për kërkimin shkencor të stafit akademik KUB"</i> <i>Evidenca nr 28 "Raport Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i>
--	---

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në përputhje me legjislacionin e brendshëm mbi kontabilitetin si dhe standartet e raportimit dhe kontrollit financiar, KUB ka ngritur një sistem të brendshëm të kontrollit të shpërnadarjes së të ardhura që gjenenron. Pranë KUB janë ngritur dhe funksionojnë struktura të cilat kanë kompetenca të menaxhimit financiar si Senati Akademik , Bordi i Administrimit, Zyra e Financës, Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar etj. Nëpërmjet strukturave të tij të brendshme, KUB realizon auditimin e brendshëm të gjendjes së tij financiare. KUB i nënshtrohet gjithashtu edhe detyrimeve që lidhen me procesin e auditimit të jashtëm. Lidhur me auditimin e jashtëm, nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se KUB prej disa vitesh realizon procesin e auditimit të jashtëm me një kompani ndërkombëtare të auditimit (<i>Grant Thornton</i>). Veprimtaria financiare e KUB i nënshtrohet kontrolleve nga organet tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Gjithashtu, në kuadrin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional, dhe të programeve të studimit nga ASCAL, realizohet edhe vlerësimi i gjendjes financiare dhe efektivitetit financiar të institucionit. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 18"</i> <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për realizimin e buxhetit 2003 dhe planifikimi 2024 KUB"</i> <i>Evidenca nr. 58 " Raport vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022,22-23,23-24"</i> <i>Evidenca nr. 58.1 "Raport i Grand Thornton mbi çertifikimin e pasqyrave financiare vjetore"</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	KUB zbaton detyrimet në lidhje me ushtrimin veprimtarisë financiare dhe hartimin e buxhetit. Në hartimin e buxhetit vjetor pasqyrohen nevojat në bazë të programeve të studimit që institucioni ofron, si dhe propozimet në nivel departamenti, njësie kryesore e deri institucioni, për fonde buxhetore. Buxheti pasqyron ndarjen e shpenzimeve në përputhje me kostot për mirëmbajtjen e programeve të studimit si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukture në mbështetje të programeve të studimit. KUB miraton çdo vit Raportin Vjetor të Veprimtarisë Akademike dhe Financiare si dhe Pasqyrat Financiare Vjetore.

	Këto dokumenta miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Senati Akademik k anë përbërje përfaqësues të personelit akademik si dhe studentëve. Pjesë e raporteve vjetore janë edhe konkluzionet që rezultojnë nga procesi i auditimit të veprimtarisë financiare. Njëkohësisht institucioni harton relacione mbi realizimin e buxhetit dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës. Nëpërmjet këtyre relacioneve institucioni informon njësitë bazë mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit si dhe financimin e shpenzimeve që i referohen mbarëvajtjes së programit të studimit. Evidenca nr. 47 “Relacion për Realizimin e Buxhetit 2003 dhe planifikimi 2024 KUB” Evidenca nr. 58 “ Raport vjetori i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022,22-23,23-24” Evidenca nr. 58.1 “Raport i Grand Thornton mbi çertifikimin e pasqyrave financiare vjetore”
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në legjislacionin në fuqi, KUB menaxhon burimet dhe kapacitetet e tij financiare për të mundësuar funksionimin normal të aktivitetit të tij. Me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare, KUB ka ngritur struktura që mbikqyrin veprimtarinë financiare të institucionit, si dhe përdorimin e burimeve dhe aseteve të tij. Ndër to, Bordi i Administrimit si organi më i lartë kolegjal administrativ ka pjesë të kompetencave të tij mbarëvajtjen financiare dhe administrative të institucionit. Për të mundësuar mbarëvajtjen e programeve mësimore që ofron, KUB mund të përdorë një sërë burimesh financiare si: të ardhurat që mblidhen nga tarifat e studimit, të ardhurat që krijohen nga shërbime të ndryshme, studime e projekte, si dhe të ardhurat që krijohen nga kontributet dhe donacionet e themeluesve, apo burime të tjera të ligjshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për të gjitha vitet akademike në këtë program studimi, pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit gjenerohet nga tarifat e studimit. Një përqindje tjetër e të ardhurave gjenerohet nga tarifat e shërbimeve dhe regjistrimit të studentëve, të ardhurat nga trajnimet etj. Nga analiza e të dhënave të institucionit mbi strukturën e të ardhurave deri në vitin 2024, rezulton se burimi kryesor i të

	ardhurave janë të ardhurat nga tarifat e studimit, të cilat variojnë nga 70.54%-99.2% të totalit të të ardhurave. Një element pozitiv është rritja e përqindjes së të ardhurave që gjenerohet nga shërbimet trajnuese. Siç rezulton nga dokumentacioni i paraqitur, të ardhurat që KUB përfon nga trajnimet janë në rritje për çdo vit akademik. Gjithashtu KUB ka përfutur të ardhura edhe si rezultat i projekteve në të cilat është shpallur fitues të cilat variojnë nga 0.51% deri në 0.6%. Në dokumentat e paraqitur, institucioni pohon se nuk ka patur probleme të qëndrueshmërisë financiare dhe vijueshmërisë së programeve të studimit. <i>Evidenca "Tabelat PIND, tabela 18"</i> <i>Evidenca nr. 22 "Raport i përfutueshmërisë së KUB nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve"</i> <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për realizimin e buxhetit 2003 dhe planifikimi 2024 KUB"</i> <i>Evidenca nr. 28 " Raport vjetori i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 58.1 "Raport i Grand Thornton mbi çertifikimin e pasqyrave financiare vjetore"</i> <i>Evidenca nr. 101 "Program trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme & Çertifikatë"</i>			
Konkluzione	<i>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KUB ka marrë masat për të siguruar mbështetjen financiare të programeve të studimit që ofron.</i> <i>Institucioni në përputhje me rregullimet e legjislacionit për arsimin e lartë si dhe aktet e brendshme rregullatore, mbështet financiarisht programet e studimit që ofron, si dhe vlerëson dhe pasqyron gjendjen financiare.</i> <i>Institucioni gjithashtu ka ngritur struktura e nevojshme që mbikqyrin menaxhimin financiar, si dhe zbaton detyrimet lidhur me auditimin e brendshëm dhe të jashtëm të veprimtarisë financiare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore, KUB zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Përcaktime në lidhje me politikat që institucioni zbaton dhe procedurat që ndjek lidhur me ciklin akademik parashikohen në një bazë të gjerë rregullatore të përbërë nga rregullore në nivel institucional, njësie kryesore, njësie bazë si dhe programi studimi. Akte të tilla si rregullorja e KUB, rregullorja e FEDSHS, rregullorja e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si dhe rregullorja e programit, kanë një sërë parashikimesh mbi ciklin e studimeve, kohëzgjatjen e tyre, organizimin e procesit mësimor, kontrollin e dijeve, diplomimin etj. Në mënyrë të veçantë, rregullorja e programit ka përcaktuar procedurat dhe modalitetet që lidhen me ciklin akademik të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave (PI) në “Drejtësi” të tilla si: kriteret e pranimit të studentëve, organizimin e studimeve, kohëzgjatjen e studimeve, ndërprerjen, rifillimin dhe transferimin e studimeve, njohjen e krediteve, kontrollin e dijes, diplomimin dhe lëshimin e diplomës. KUB mundëson njohjen e studentëve më këto parashikime nëpërmjet një sërë formash si publikimi në faqen eeb të institucionit, shpërndarjes së materialeve informuese

	përpara fillimit të vitit akademik, prezantimi në fillim të procesit mësimor nga pedagogët e lëndëve etj. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 39 "Rregullore për ekuivalentimin e studimeve"</i> <i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Aktet rregullatore të KUB marrin në konsideratë dhe janë në përputhje me legjisalcionin për arsimin e lartë dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Si të tilla, parashikimet mbi politikat dhe procedurat që lidhen me ciklin akademik në këtë program studimi mundësojnë zbatimin e tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë studentët dhe kandidatët për student. Kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi konsiderojnë edhe parashikimet dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin për arsimin e lartë. Këto kriteret mundësojnë barazi në konkurrim dhe përzgjedhje objektive, bazuar në meritë. Procedurat që i referohen zhillimit të studimeve dhe përparimit të studentëve, si dhe vlerësimit të dijeve dhe diplomimit gjithashtu garantojnë gëzimin e barabartë të të drejtave në përputhje me statusin si student, konkurrencën e drejtë dhe përparimin bazuar në meritë. Për të rritur transparencën, KUB i bën publike politikat dhe procedurat lidhur me ciklin akademik të studentëve <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 39 "Rregullore për ekuivalentimin e studimeve"</i>

	<i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	KUB zbaton kuadrin ligjor në fuqi dhe bashkëpunon me strukturat kompetente në procesin e pranimi të studentëve në programet e studimit që ofron. Referuar rregullores së këtij programi, pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me VKM dhe udhëzimet përkatëse të MAS të përditësuara për çdo vit akademik. Rregullorja e këtij programi studimi ka përcaktuar se kriteri bazë për pranimin në këtë program studimi është përfundimi me sukses i studimeve të maturës shtetërore. Për sa i takon kriterëve të veçanta, rregullorja përcakton se kriteret shtesë për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë miratohen dhe shpallen çdo vit nga KUB dhe i dërgohen MAS dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Si kriteret e përgjithshme, ashtu edhe ato shtesë për pranimin në programin e studimit, shpallen publikisht në faqen zyrtare të institucionit. Gjithashtu ato u bëhen të njohura të interesuarve edhe nëpërmjet fushatave informative që institucioni organizon përpara fillimit të vitit akademik. KUB respekton detyrimet ligjore lidhur me dërgimin në MAS të kuotave dhe kriterëve të pranimi të regjistrimit të studentëve për çdo vit akademik. <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 106 " Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimi"</i> <i>Evidenca nr. 106.2 " Propozimi i kuotave në MAS 2024-2025"</i> <i>Faqja ëeb e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve,	KUB ka një bazë të mirë rregullatore e përbërë nga rregullore të përgjithshme që nga niveli institucional deri në nivelin e njësisë si: Rregullorja e KUB, rregullorja e FEDSHS, Rregullorja e

përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si dhe rregullore për çdo program studimit. Njëkohësisht, aspekte të caktuara të veprimtarisë akademike, si zhvillimi i provimeve, transferimet etj, gjithashtu janë objekt i rregullimeve në akte të posaçme. Publikimi i akteve rregullatore në faqen web të institucionit lehtëson njohjen dhe aksesimin nga studentët. Nga ana tjetër, faja web e institucionit përmban një sërë informacionesh mbi programet e studimit që ofron institucioni, kriteret e pranimit të studentëve, kuotat, transferimet, infrastrukturën, diplomimin etj. Çdo vit akademik institucioni pregatit fletë palosje informative ku gjendet informacion mbi programet e studimit, kriteret e pranimit, tarifat e studimit si dhe kriteret e përfitimit të bursave studentore. Një informacion mjaft të detajuar përmban Guida studentore e cila gjithashtu hartohet çdo vit akademik. Guida Studentore i orienton studentët mbi të gjitha aspektet që lidhen me jetën studentore, veprimtarinë akademike dhe mbështetjen institucionale që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Mënyra e ndërtimit të Guidës është e tillë që jep informacion të detajuar, por me gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme. Studentët mund ta aksesojnë Guidën Studentore në bibliotekën e institucionit ose në faqen zyrtare web. Studentët marrin informacion të detajuar edhe gjatë javës së orientimit, përpara fillimit të vitit akademik ku zhvillohen takime orientuese dhe jepet i gjithë informacioni i nevojshëm për të interesuarit. Pedagogët e lëndëve, që në fillim të vitit akademik, vënë në dijeni studentët mbi format e kontrollit të njohurive, metodologjinë e testimit si dhe sistemin e vlerësimit. Menjëherë mbas fillimit të procesit mësimor si dhe në vazhdimësi, studentët orientohen dhe informohen nga Sekretaria Mësimore, departamenti apo struktura të tjera të dedikuara. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 39 "Rregullore për ekuivalentimin e studimeve"</i>
--	---

	<i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit janë pjesë përbërëse e informacionit të aksesueshëm nga studentët dhe të interesuarit lidhur me programet e studimit. Institucioni mundëson informacion të detajuar në formë dhe burime të ndryshme mbi kohëzgjatjen, përmbajtjen dhe kriteret që lidhen me programin e studimit. Ky informacion mund të gjenerohet si përpara fillimit të vitit akademik, ashtu edhe gjatë vazhdimësisë së procesit akademik. Kriteret e pranimit në këtë program studimi janë objekt rregullimi në nenin 5 të Rregullores së programit. Kriteret e përcaktuara për regjistrimin në këtë program studimi janë kriteret të hartuara në përputhje me udhëzimet dhe akte të tjera nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kriteri bazë për këtë program studimi është përfundimi i maturës shtetërore dhe niveli i notës mesatare. Kriteret e veçanta mund të përcaktohen gjithashtu çdo vit akademik. Këto kriteret së bashku me kuotat për çdo program studimi, dërgohen në MAS dhe bëhen publike për të interesuarit përpara fillimit të vitit akademik. Burimet e informimit që institucioni vë në dispozicion janë të tilla që mundësojnë informimin e gjerë të publikut dhe gjithë të interesuarve. Një burim i rëndësishëm i informimit është faqja zyrtare e institucionit, ku përveç të tjerash, gjendet informacion edhe mbi kriteret e pranimit dhe tarifat e studimit për çdo program studimi. Në faqen zyrtare mund të aksesohet edhe Guida e Studentit ku janë detajuar të gjitha informacionet mbi kriteret e pranimit, tarifat e shkollimit si dhe mundësitë e përfitimit të bursave. Guidën e Studentit të interesuarit mund ta tërheqin edhe në mjediset e institucionit, pranë bibliotekës. Gjithashtu KUB ka faqen e tij në disa platforma sociale on line si facebook, twitter, instagram, linkedin, youtube, ku çdo person i interesuar mund të gjejë lehtësisht informacion. KUB përdor edhe një sërë formash të tjera të informimit publik për të interesuarit përpara fillimit të vitit akademik si, fushata

	informuese me maturantët, spotet publicitare, shpërndarja e fletë palosjeve, javën informuese etj. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 106 " Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimi"</i> <i>Evidenca nr. 106.2 " Propozimi i kuotave në MAS 2024-2025"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret e përgjithshme të pranimi në programet e studimit, në përputhje me rregullimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe udhëzimet e MAS. Gjithashtu, për secilin nga programet e studimit, në përputhje me natyrën e programeve, institucioni mund të përcaktojë edhe kritere të veçanta të pranimi. KUB e ka parashikuar mundësinë e pranimi në programet e studimit të kategorive të veçanta, përfshirë edhe kandidatë me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. Nga të dhënat mbi kuotat e pranimi në programet e studimit që ofron FEDSHS për vitin akademik 2024-2025 ka parashikime mbi kuotat për personat me aftësi ndryshe, personat me statusin e jetimit, si dhe kuota për komunitetin rom dhe për kandidatët nga trojet. Në programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi", nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultojnë kuota për kandidatët nga trojet, Kosova dhe Maqedonia. KUB zbaton gjithashtu edhe politika të sistemit të bursave për kategori të veçanta dhe studentët në nevojë si studentët me probleme social ekonomike, studentët me statusin e jetimit etj. <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i>

	<i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 106 " Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit"</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin e ofertës akademike, në përputhje me kapacitetet akademike dhe financiare, KUB përcakton edhe kuotat për çdo program studimi. KUB zbaton politika të përzgjedhjes së studentëve që mundësojnë pjesëmarrjen e kategorive të veçanta të studentëve. Në totalin e kuotave për programet e studimit që KUB ofron, mund të përcaktohen kuota të veçanta edhe për studentë të huaj apo jashtë territorit shqiptar. KUB po punon gjithashtu për të integruar programet e tij të studimit në kuadrin e procesit të ndërkombtarizimit. Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi" është një program në gjuhë shqipe. Si i tillë në këtë program nuk ka studentë të huaj. Për këtë program studimi janë parashikuar mundësi për regjistrimin e studentëve nga trojet, si Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi etj. Institucioni në totalin e kuotave për këtë program studimi ka parashikuar kuota edhe për këtë kategori. Gjithashtu këta studentë mund të transferojnë dhe ekuivalentojnë kreditet për efekt të transferimit në këtë program studimi. Nga të dhënat mbi kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron FEDSHS për vitin akademik 2024-2025 ka parashikime mbi kuota për kandidatët nga trojet, përkatësisht nga Kosova dhe Maqedonia. <i>Evidenca nr. 106 " Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit"</i> <i>Evidenca nr. 106.1 " Propozimi i kuotave në MAS 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr. 106.2 " Propozimi i kuotave në MAS 2024-2025"</i> <i>Evidenca nr. 106.3 " Miratimi i kuotave në MAS 2022-2023"</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për	KUB mbështet pranimin në programet e studimit të kategorive të veçanta, përfshirë edhe kandidatë me aftësi të veçanta, apo shtresat me nevoja ekonomike dhe sociale. Nga dokumentacioni mbi kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron FEDSHS për vitin akademik 2024-2025 pasqyrohen të dhëna

institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	mbi kuotat për personat me aftësi ndryshe, personat me statusin e jetimit, si dhe kuota për komunitetin rom dhe kandidatët nga trojet. Për të mbështetur këtë kategori, KUB zbaton politika të akordimit të bursave. KUB harton dhe zbaton edhe politika të mbështetjes së studentëve me rezultate të larta me qëllim rritjen e cilësisë së programeve që ofron. Një formë tjetër e akordimit të bursave është edhe ajo që mundëson kompesimin e tarifës financiare për studentët që në vitin e parë parë të studimeve. Kjo kategori bursash ka si kriter rezultatet larta të shkollës së mesme dhe mund të përfitohet sipas kriterëve si vijon: studentët me notë mesatare 9.8-10 100% bursë e plotë studimi; studentët me notë mesatare 9.5-9.79 80% bursë studimi; studentët me notë mesatare 9.-9.49 50% bursë studimi; studentët me notë mesatare 8.5-8.99 30% bursë studimi; Gjithashtu KUB zbaton politika të përfitimit të bursave edhe për talentet në fusha të veçanta apo politika lehtësuese si pagimi i tarifës më të ulët, në varësi të kushteve ekonomike të studentit. Kriteret e përfitimit të bursave bëhen të njohura çdo vit akademik, si pjesë e ofertës akademike të institucionit. <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 106 "Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit"</i> <i>Evidenca nr. 109 "Lista e miratimit të studentëve të cilët përfitojnë bursa për vitin akademik 2023-2024"</i>
Konkluzione	KUB harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore. Nëpërmjet sistemit të bursave, institucioni zbaton politika të mbështetjes së kategorive të veçanta dhe shtresave në nevojë si

	<i>dhe politika të përthithjes së studentëve me rezultate të larta dhe talenteteve në fusha të veçanta.</i> <i>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve dhe ofertën akademike të KUB bëhen të njohura dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nëpërmjet një sërë mekanizmash, institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik. Aspektet që lidhen me përparimin akademik të studentëve janë disiplinuar në aktet rregullatore të institucionit. Rregulloret kanë parashikime mbi strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit të mësimdhënies, sezonet e provimeve, riprovimeve, përmirësimeve dhe diplomimit. Rregullorja e FEDSHS prashikon rregullime mbi sezonet e provimeve dhe riprovimeve, frekuentimet si dhe kriteret e kalimit në vitin pasardhës. Rregullime mbi përparimin akademik të studentëve, organizimin e provimeve dhe detyrimet e studentit ndaj lëndës parashikon gjithashtu edhe rregullorja e programit të studimit. Kjo rregullore përcakton qartë, detyrimet e studentit në raport me komponentë e lëndës, veçanërisht detyrimet në raport me leksionet, seminarat, projektet si dhe elementët e tjerë të syllabusit të lëndës dhe punimit të temës. Neni 12 i kësaj rregulloreje përcakton kushtet mbi frekuentimin e leksioneve dhe seminareve, përmbushjen e detyrimeve mbi projektet dhe detyrat e kursit. Nëpërmjet publikimit të akteve rregullatore në faqen zyrtare zyrtare të KUB, këto procedura bëhen të njohura dhe lehtësisht të kuptueshme për studentët. Një sërë strukturash si Sekretaria Mësimore, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

	luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve gjatë gjithë ecurisë së vitit akademik. Procesi i informimit është efikas dhe lehtësisht i aksesueshëm edhe nëpërmjet përdorimit të platformave si <i>portali</i> ku studentët aksesojnë të gjithë informacionin e nevojshme nga Sekretaria Mësimore ose pedagogët e lëndëve. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve mund të luajë edhe Këshilli Studentor, si dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, të cilat kanë si pjesë të kompetencave të tyre mbështetjen ndaj studentëve gjatë veprimtarisë së tyre. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 106 " Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit"</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në kuadrin e politikave që mundësojnë mobilitetin e studentëve, KUB ka sanksionuar procedura që mundësojnë njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme. Gjithashtu mundëson informimin e studentëve mbi këto kriteret dhe procedura si dhe i mbështet gjatë procesit. Aktet rregullatore të brendshme kanë parashikime të qarta mbi mundësinë e transferimit të studimeve si dhe vlefshmërinë dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Rregullorja e KUB përcakton parime të përgjithshme mbi njohjen e studimeve të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, dhe njehsimin e tyre nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimin, në programet që institucioni ofron. Referuar Rregullores së programit të studimit, KUB pranon transferime të studentëve në këtë program studimi në vitet e ndërmjetme nga institucionet e tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, publike ose private, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimit

	të studimeve përcaktohen në Rregulloren e posaçme “Për ekuivalentimin dhe transferimin e studimeve”. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, detajohen si dhe bëhen transparente të gjitha procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve që nga momenti i dorëzimit të dosjes, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Vendimi për njohjen e plotë apo të pjesshme të krediteve të fituara nga studenti që transferohet me qëllim vazhdimin e studimeve në KUB, meret nga një komision i posaçëm, “Komisioni i ekuivalentimit të studimeve”. Sekretaria Mësimore u jep të interesuarve informacionet e nevojshme mbi mundësitë e transferimit të studimeve, dokumentacionin dhe procedurat. <i>Evidenca nr.4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 5 “Rregullore e Njësië Kryesore FEDSHS”</i> <i>Evidenca nr 7 “Rregullore e programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr. 39 “ Rregullore për ekuivalentimin e studimeve”</i>																
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve gjejnë pasqyrim në një bazë të gjerë rregullatore. Komponentë mbi vlerësimin e dijeve parashikohen në, Rregulloren e KUB, Rregulloren e Programit të studimit, si dhe Rregulloren për zhvillimin e provimeve. Rregullorja e programit të studimit në <i>nenin 13</i> parashikon rregullime lidhur me kontrollin e dijeve dhe elementët e vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim ose me gojë, bëhet me pikë nga 0-100 pikë, dhe rezultati përfundimtar konvertohet me notë nga (katër) në 10 (dhjetë) sipas tabelës së mëposhtme: <table> <tr> <th>Pikët</th><th>Nota</th></tr> <tr> <td>1-40</td><td>4</td></tr> <tr> <td>41-50</td><td>5</td></tr> <tr> <td>51-60</td><td>6</td></tr> <tr> <td>61-70</td><td>7</td></tr> <tr> <td>71-80</td><td>8</td></tr> <tr> <td>81-90</td><td>9</td></tr> <tr> <td>91-100</td><td>10</td></tr> </table>	Pikët	Nota	1-40	4	41-50	5	51-60	6	61-70	7	71-80	8	81-90	9	91-100	10
Pikët	Nota																
1-40	4																
41-50	5																
51-60	6																
61-70	7																
71-80	8																
81-90	9																
91-100	10																

Pjesë e përmbajtjes së *nenit 13* janë edhe komponentët e vlerësimit të pregatitjes akademike të studententit. Vlerësimi i pregatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Vlerësimi për lëndën/modulin është rezultat i dy komponentëve, vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit në provimin përfundimtar. Format e kontrollit të njohurive në këtë program studimi janë si vijon:

Nr	Format e kontrollit të njohurive	Pjesa në % ndaj totalit
1	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
2	Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi)	10%
3	Testimet gjatë vitit	20%
4	Vlerësimi i vazhduar, total	40%
5	Provimi përfundimtar	60%
	Totali	100%

Sa më sipër, sistemi i testimit dhe vlerësimit të dijeve në këtë program, mundëson jo vetëm vlerësimin e njohurive të studentit, por edhe angazhimin e tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit akademik.

Sistemi i testimit dhe vlerësimit të njohurive është pjesë si një rubrikë e veçantë, e sylabuseve/moduleve e lëndëve të këtij programi. Nëpërmjet njohjes me sylabuset e lëndëve, studentët njihen me sistemin e vlerësimit të dijeve dhe detyrimet përmbyllëse që në fillim të procesit akademik. Studentët e aksesojnë informacionin edhe nga pedagogët e lëndëve/moduleve ose pranë Sekretarisë Mësimore. Komponentë e sistemit të vlerësimit janë edhe pjesë e Guidës Studentore, e cila mund të aksesohet në faqen zyrtare të institucionit.

Evidenca "Table PIND, tabela 15"

Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"

Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FEDSHS"

Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"

	<i>Evidenca nr.32 'Dosje e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr.64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Neni 104 i Rregullores së KUB dhe Neni 13 i Rregullores së programit të studimit përcakton se në Programin e Integruar të Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Drejtësi" detyrimet përmbillen me përgatitjen dhe mbrojtjen e një mikroteze. Në planin mësimor dhe kurrikulën e këtij programi përcaktohet se, mbrojtja e diplomës si detyrim përmbillës ka një total prej 14 kreditesh. Procedurat mbi mbrojtjen e diplomës janë objekt parashikimi i akteve rregullatore si Rregullorja e KUB; Rregullorja e Departamentit, si dhe Rregullorja e programit të studimit. Aspekte të detajuara mbi procedurat e mbrojtjes dhe vlerësimet parashikon një dokument i veçantë, Udhëzuesi për mbrojtjen e temës së diplomës. Këto akte rregullatore kanë përcaktuar edhe përgjegjësitë e Departamentit në procesin e hartimit dhe mbrojtjes së tezës së diplomës. Departamenti shpall brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik temat e diplomës. Udhëheqësi i temës për këtë program studimi përzgjidhet nga personeli akademik me gradën shkencore "Doktor", ose i kategorisë "Profesor" Pedagogët udhëheqës asistojnë dhe udhëzojnë studentët gjatë gjithë procesit të punimit të diplomës. Studentët njihen me procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës që në fillim të vitit akademik. FEDSHS vë në dispozicion të studentëve Udhëzuesin për mbrojtjen e diplomës. Procedurat që lidhen me përmbylljen e detyrimeve dhe diplomimin e studentëve, si pjesë e akteve rregullatore, bëhen të njohura e publike për studentët. Publikimi i akteve rregullatore në faqen zyrtare të institucionit e bën këtë informacion lehtësisht të aksesueshëm. Institucioni përdor edhe një sërë formash e metodash të informimit si shpërndarja e fletë palosjeve, hartimi i Guidës Studentore etj, ku studentët marrin informacion edhe mbi përmbylljen e detyrimeve në përfundim të studimeve. Nga takimi me personelin akademik dhe studentët GVJ u informuam mbi mbështetjen dhe orientimin që Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale mundëson në

	procesin përmbyllës së ciklit akademik. Studentët e vitit të pestë të studimeve pohuan se ishin të informuar mbi procedurat e punimit të tezës dhe mbrojtjes së diplomës mbështetur nga pedagogët udhëheqës. <i>Evidenca "Table PIND, tabela 9, tabela 10"</i> <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.32 'Dosje e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nëpërmjet një sërë formash të shpërndarjes së informacionit, KUB informon studentët dhe gjithë të interesuarit mbi programet e studimit që ofron, si dhe kapacitetet akademike dhe infrastrukturore në funksion të realizimit të programeve të studimit. KUB informon të interesuarit mbi programet dhe format e studimit, kriteret dhe procedurat e pranimit, tarifat e studimit, infrastrukturën, shërbimet dhe facilitetet, personelin akademik përgjegjës etj. Format e shpërndarjes së informacionit janë të larmishme si njoftimit në faqen zyrtare, njoftimit në rrjetet sociale apo nëpërmjet spoteve televizive, fushatat informuese me maturantët, njoftimet e shpallura në mjediset e brendshme të institucionit etj. Publikimi në faqen zyrtare të institucionit i informacioneve të hollësishme mbi programet e studimit, kriteret e pranimit, kuotat, transferimet, infrastrukturën, diplomimin etj lehtëson njohjen dhe aksesimin nga studentët dhe publiku i gjerë. Institucioni pregatit çdo vit fletë palosje informative dhe spote publicitare ku paraqet ofertën e tij dhe kapacitetet në mbështetje të programeve të studimit. Një informacion mjaft të detajuar përmban Guida Studentore e cila gjithashtu hartohet çdo vit akademik. Guida studentore i orienton studentët mbi të gjitha aspektet që lidhen me jetën studentore, veprimtarinë akademike dhe mbështetjen institucionale që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. KUB është pjesëmarës çdo vit në panairët e punës të tilla si "Work and Study" ku bën të njohur ofertën e tij akademike.

	Një sërë strukturash brenda institucionit si Sekretaria Mësimore, Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, informojnë studentët përpara fillimit të vitit akademik, dhe në vazhdimësi mbi komponentet e ofertës akademike që institucioni ofron. <i>Evidenca nr. 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca 110 "Program i Panairit Work and Study"</i> <i>Faqja zyrtare e KUB: ëëë.kub.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>Në aktet rregullatore të KUB, nga niveli institucional deri në atë të programit të studimit, parashikohen rregullime mbi procedurat e përparimit akademik të studentëve deri në diplomim.</i> <i>Aktet rregullore përmbajnë informacion të hollësishëm mbi përparimin akademik, transferimin e studimeve, vlerësimin e dijeve, përfundimin e studimeve dhe diplomimin.</i> <i>Nëpërmjet një sërë mekanizmash, institucioni mundëson procesin e informimit të studentëve mbi këto procedura, përpara fillimit të procesit mësimor dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe	Bazuar në rregulloren e programit, <i>neni 4</i> , Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi", zhvillohet me 300 kredite (ECTS), në përputhje me planin mësimor. Kohëzgjatja normale e këtij programi është pesë vite akademike ose dhjetë semesra.

kohëzgjatjen e programit të studimit.	Procesi mësimor në këtë program zhvillohet gjatë pesë ditëve të javës, jo më shumë se 6 orë mësimi në ditë, në formën e studimeve me kohë të plotë. Ky program zhvillohet në gjuhën shqipe. Rregullorja e këtij programi studimi ka gjithashtu rregullime mbi ngarkesën, kohëzgjatjen dhe kreditet e lëndëve. Duke përdorur burime të ndryshme të informacionit, KUB mundëson informimin e studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Aktet rregullatore të institucionit janë një burim i rëndësishëm informimi. Një burim tjetër informues është plani mësimor i programit të studimit, i cili përcakton të gjithë komponentët e nevojshëm si: lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje, kreditet për secilën lëndë, si dhe semesrin e zhvillimit të tyre. Çdo vit akademik, institucioni publikon kalendarin mësimor I cili orineton studentët mbi: strukturën mësimore ku përfshihen elementë të tillë si: kohëzgjatja vjetore ose semesrale e lëndëve, periudhat e pushimeve, si dhe sezonet e provimeve. Struktura e vitit akademik afishohet në tabelën e njoftimeve brenda mjediseve mësimore të KUB. Struktura e vitit akademik mund të aksesohet nga studentët edhe nëpërmjet sistemit të <i>portalit</i>. Njohjes në një shkallë sa më të gjerë të këtyre informacioneve edhe për publikun dhe të interesuarit, i shërben publikimi në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidenca "Table PIND, tabela 10"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.32 'Dosje e programit të studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Faqja zyrtare e KUB: :www.kub.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rregullorja e programit të studimit në <i>nenin 7</i> sanksionon parashikime lidhur me kategoritë karakterizuese të programit dhe kreditet për veprimtaritë akademike. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese në këtë program studimi janë organizuar në pesë kategori, të cilat emërtohen nga A në E. Referuar kurrikulës së këtij programi studimi, janë përcaktuar edhe kreditet për çdo grup lëndësh karakterizuese bazuar në sistemin e krediteve (ECTS). Për secilën nga lëndët, pjesë e

	kurrikulës së këtij programi studimi, janë specifikuar kreditet në orë mësimore të organizuara në orë mësimore në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve) dhe orëve të pavarura të studentit. Pjesë e kurrikulës janë dhe praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse nëpërmjet punimit të diplomës. I gjithë informacioni është lehtësisht i aksesueshëm për studentët dhe stafin akademik. Studentët marrin informacione nevojshëm mbi lëndët/modulet që janë pjesë e programit mësimor si dhe përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese që në fillim të vitit akademik. Që në javën e parë të procesit mësimor, studentët informohen nga pedagogët e lëndëve nëpërmjet syllabuseve mbi përmbajtjen e lëndës, konceptet themelore të saj, sistemin e vlerësimit dhe literaturën. Këtë informacion studentët mund ta aksesojnë edhe nëpërmjet sistemit të <i>portalit</i> ku titullaret e lëndëve përcjellin syllabuset e lëndëve si dhe informacionin e nevojshëm lidhur me lëndët ose modulet. Faqja eeb e institucionit ka gjithashtu në përmbajtje informacion mbi programet mësimore dhe komponentët e tyre. <i>Evidenca "Table PIND, tabela 9"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.32 'Dosje e programit të studimit master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i> <i>Faqja zyrtare e KUB: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Rritja e potencialit të punësimit dhe orientimit në tregun e punës janë pjesë përbërëse e objektivave strategjike dhe atyre formues të programit të studimit. Një nga objektivat specifike të programit të studimit është paisja e studentëve me dije të thelluara shkencore në të gjitha disiplinat, duke ofruar mundësinë e konceptimit të vlerës teorike, praktike, studimore dhe aplikative të parimeve dhe normave juridike në veprimtarinë e shoqërisë dhe institucionve të saj. Duke qënë një program i integruar pesë vjeçar, ky program i pais studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në të gjitha disiplinat e së drejtës duke i bërë konkurrues për tregun e punës. Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në këtë program studimi mund

	të punësohen si: ekspertë në të gjitha fushës e së drejtës penale, civile dhe publike duke patur më shumë mundësi punësimi. Nëpërmjet strukturave dhe politikave të tij, KUB informon dhe mbështet studentët në orinetimin drejt tregut të punës. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, kompani biznesi, organizata ka ndikuar jo vetëm në zhvillimin me sukses të praktikave profesionale, por edhe të zhvillimit të karrierës së studentëve. Për tu ardhur në ndihmë studentëve në profilizimin e karrierës së tyre, institucioni ka hartuar një dokument Udhëzuesin e Karrierës i cili është hartuar nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Në këtë udhëzues studentët e KUB gjejnë disa këshilla dhe orientime mbi zgjedhjen e karrierës së duhur për ta. KUB realizon edhe sondazhe e studime mbi nivelin e punësimit të studentëve në përputhje me profilin e programit të studimit nëpërmjet sistemit të gjurmimit dhe intervistimit të studentëve Alumni. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, luan Zyra e Studentëve dhe e Këshillimit të Karrierës në KUB. Evidenca nr. 9.1 <i>“Udhëzuesi i karrierës”</i> Evidenca nr 2.2 <i>“Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit”</i> Evidenca nr. 7 <i>“Rregullore e programit të studimit”</i> Evidenca nr 9 <i>“Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i> Evidenca 21 <i>“Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë”</i> Evidenca nr. 44 <i>“Studim tregu për programin e studimit Master Shkencave (PI) në “Drejtësi”</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	KUB u vë në dispozicion studentëve informacion mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe aspektet logjistike dhe infrastrukturore në funksion të realizimit të tij. Informimi i studentëve mundësohet nëpërmjet një sërë formash si: informimi në mjediset e institucionit, shpërndarja e guidave ose materialeve shpjeguese, marrja e informacionit në faqen zyrtare ose rrjetet sociale etj. Informacioni mbi procesin mësimor u bëhet i njohur studentëve që në javën e parë të vitit akademik. Struktura mësimore e vitit akademik shpallet përpara

	fillimit të semesrit në vende të dukshme të KUB si dhe në faqen zyrtare të tij. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit pasqyrohen në orarin e shpallur nga Sekretaria Mësimore. Përpara fillimit të vitit akademik, studentët informohen edhe mbi llogjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të procesit mësimor. Gjatë javës së parë të vitit akademik, javës informuese, ata informohen mbi mjediset e zhvillimit të procesit mësimor, zyrat e Sekretarisë Mësimore, zyrat administrative apo ato të departamenteve, bibliotekën, laboratorët, etj. Këto informacione mund të aksesohen edhe në faqen zyrtare të institucionit apo në Guidën Studentore. Faqja zyrtare e KUB përmban informacione të detajuara mbi infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të jetës studentore dhe realizimit të programeve të studimit. Më tej, studentët mund të kërkojnë informacion edhe në vazhdimësi për çdo komponent të shërbimeve apo infrastrukturës në funksion të programit të studimit. <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida Studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: ëëë.kub.edu.al</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet krijimit të platformave elektronike, KUB mundëson një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe marrjen e informacionit në kohë reale. Vënia në përdorim e platformave elektronike ka mundësuar jo vetëm një sistem efikas të menaxhimit të informacionit, por edhe komunikimin në kohë reale midis studentëve dhe pedagogëve mbi aspekte të procesit të mësimdhënies. Mbi aspektet që i referohen procesit mësimor, marrja e informacionit mundësohet nëpërmjet sistemit <i>portali</i>, i cili mundëson komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi veprimtarinë mësimore, si leksionet, detyrat e kursit, vlerësimet e lëndëve etj.

	Studentët mund të aksesojnë në këtë portal edhe informacionin që gjenerohet nga Sekretaria Mësimore si orari mësimor, njoftimet mbi sezonin e provimeve etj. Aksesit në këtë platformë për studentët mundësohet nëpërmjet adresave zyrtare të emailit me domeinin e institucionit. Në funksion të procesit mësimor, KUB përdor gjithashtu edhe platformën Google Classroom. Marrja e materialeve dhe informacionit nga pedagogët mbi aspekte të procesit mësimor mund të mundësohet edhe nëpërmjet kësaj platforme. Një burim i pasur për marrjen e informacionit në kohë reale dhe në distancë është edhe faqja zyrtare e institucionit. <i>Evidenca "Tabela PIND, tabela 17"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 52 " Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e portalit KUB"</i> <i>Evidenca nr. 54 "Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e "GOOGLE APPS"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>KUB vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, infrastrukturën dhe shërbimet në zbatim të këtij programi si dhe mundësitë e punësimit.</i> <i>Për informimin e studentëve KUB përdor një sërë burimesh si faqja zyrtare e institucionit, veprimtaritë informuese, si dhe informimi i vazhdueshëm nga strukturat kompetente brenda institucionit.</i> <i>Vënia në përdorim e platformave elektronike si portali, ka mundësuar jo vetëm një sistem efikas të menaxhimit të informacionit, por edhe komunikimin në kohë reale midis studentëve dhe pedagogëve mbi aspekte të procesit të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	KUB disponon dhe administron të dhëna statistikore vjetore mbi numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit si dhe të diplomuarve. Për administrimin e të dhënave institucioni respekton ligjin për arsimin e lartë si dhe aktet e tjera nënligjore. Gjithashtu, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, KUB administron të dhënat mbi studentët dhe mbi bazën e këtyre të dhënave harton raporte statistikore. Në përputhje me kriteret ligjore në fuqi, KUB raporton të dhënat dhe statistikat mbi studentët pranë strukturat kompetente të MAS. Përgjegjëse për administrimin e të dhënave është Sekretaria Mësimore, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Rregulloren e posaçme mbi Sekretarinë Mësimore. Sekretaritë Mësimore ngrihen dhe funksionojnë pranë çdo njësie kryesore. Të dhënat mbi studentët mbahen dhe administrohen për çdo program studimi. Të dhënat për studentët e diplomuar administrohen në një regjistër të veçantë, regjistrin e të diplomuarve. Ky regjistër përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar me sukses programin e studimit dhe janë diplomuar sipas programeve të studimit. Studentët që ndjekin programin Master i Shkencave (PI) në “Drejtësi”, ende nuk e kanë përfunduar ciklin e plotë të studimeve. Si rrjedhojë, nuk ka të dhëna mbi numrin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi. Nga verifikimi i GVJ pranë Sekretarisë Mësimore nuk u konstatuan problematika në mbajtjen dhe administrimin e regjistrave për studentët që ndjekin këtë program studimi. <i>Evidenca “Tabela PIND, tabela 21”</i> <i>Evidenca nr.28 “Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024”</i> <i>Evidenca nr.30 “Raport Vjetori i veprimtarive FEDSH viti akademik 2022-2023; 2023-2024”</i>

	<i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.30 "Raport Vjetori i veprimtarive FEDSH viti akademik 2022-2023; 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në përputhje me kompetencat, Sekretaritë Mësimore pranë çdo njësie kryesore administrojnë të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat mbi studentët. Administrimi i të dhënave për çdo njësi kryesore lehtëson administrimin e dokumentacionit si dhe përpunimin e tij për efekt të të dhënave statistikore. Dokumentacioni dhe të dhënat që lidhen me këtë program studimi administrohet nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Në përputhje me detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi, një pjesë e këtij dokumentacioni administrohet edhe në format elektronik. Ky sistem i menaxhimit të informacionit mundëson marrjen e të dhënave si dhe raportimin në kohë reale tek autoritetet drejtuese. Këto të dhëna, më tej pëpunohen për të evidentuar statistika mbi aspekte të ndryshme të ciklit akademik. Institucioni i përfshin të dhënat statistikore në raportet e hartuara në nivel instiucional ose njësie kryesore. Në raportet mbi veprimtarinë akademike dhe financiare të KUB pasqyrohen të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimi, atyre të transferuar dhe diplomuar. Gjithashtu pjesë e këtyre raporteve janë edhe të dhënat mbi cilësinë e studentëve, pasqyruar në notën mesatare. Nëpërmjet të dhënave të tilla statistikore institucioni nxjerr konkluzione mbi cilësinë e programeve të studimit që ofron si dhe marrjen e masave për përmirësimin e performancës. Këto të dhëna më tej raportohen edhe pranë strukturave kompetente të MAS në përputhje me detyrimet ligjore. <i>Evidenca "Tabela PIND, tabela 21"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.30 "Raport Vjetori i veprimtarive FEDSH viti akademik 2022-2023; 2023-2024"</i>

	<i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 94 " Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA "</i> <i>Evidenca nr. 95 " Regjistri i rezultateve/performancës së studentit "</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sistemi i menaxhimit të informacionit mundëson sigurinë në ruajtjen dhe administrimin e informacionit. Mënyra e menaxhimit të dokumentacionit, një pjesë e të cilit administrohet në format elektronik mundëson shpërndarjen në kohë reale tek personat e autorizuar. Gjithashtu nëpërmjet sistemit <i>portali</i>, edhe studentët dhe pedagogët mund të marrin informacion në kohë reale mbi aspekte që lidhen me procesin mësimor. Mbikqyrja dhe kontrolli mundësohen në përputhje me sistemin e hierarkisë që kanë sanksionuar aktet e brendshme rregullatore. Përdorimi i të dhënave statistikore të detajuara në analizat vjetore në rang institucional, njësie kryesore ose njësie bazë është një tregues që informacioni është lehtësisht i menaxhueshëm. Ai administrohet lehtësisht duke mundësuar që një sërë strukturash si rektorati, dekanati, departamentet të administrojnë dokumentacionin. Si i tillë ai i nështrohet edhe kontroleve nga strukturat që kanë kompetenca të kontrollit periodik dhe vlerësimit të gjendjes së informacionit. Për të mundësuar sigurinë dhe mirë administrimin e tij, sistemi mbikqyret edhe nga specialist të IT. <i>Evidenca "Tabela PIND, tabela 21"</i> <i>Evidenca nr.28 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.30 "Raport Vjetori i veprimtarive FEDSH viti akademik 2022-2023; 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 94 " Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA "</i> <i>Evidenca nr. 95 " Regjistri i rezultateve/performancës së studentit "</i> <i>Evidenca nr 114. " Proces verbal verifikimi të dhënash regjistër amze/arritje akademike "</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike,	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se KUB administron dhe manaxhon të dhënat mbi studentët, përfshirë të

periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe të dhënat mbi shkallën e punësimit të tyre. Dokumentacioni i vënë në dispozicion si pjesë e dosjes së vetvlerësimit, pasqyron të dhëna mbi mesataren në hyrje për pesë vitet akademike që i referohen këtij programi studimi. Gjithashtu institucioni ka përpunuar të dhënat mbi mesataren në dalje të studentëve. Mesatarja në dalje specifikohet për çdo vit akademik dhe për secilin nga vitet e studimit.

Nga të dhënat e administruara evidentohet se cilësia në hyrje e studentëve në këtë program studimi është në kufirin më të ulët dhe më të lartë të notës prej 7.14-7.28. Për sa i takon cilësisë në dalje, të dhënat e vërtetojnë kufijtë prej 7.6-8.46. Duke qënë se ky program studimi është në proces mësimor dhe nuk e ka mbyllur ciklin e tij, në të dhënat statistikore, mungon mesatarja në dalje për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025.

Statistikat sa më sipër janë pasqyruar edhe në raportet vjetore mbi veprimtarinë akademike dhe financiare që hartohen në nivel institucional. Gjithashtu edhe FEDSHS, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi përfshin në raportet vjetore të statistika mbi studentët dhe cilësinë e tyre. Përfshirja e të dhënave statistikore në raportet vjetore ndihmon në analizat mbi performancën dhe cilësinë e programeve të studimit si dhe hartimit të masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë.

Për sa i takon të dhënave mbi punësimin e studentëve, Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, në kuadrin e kompetencave të saj, kryen studime gjurmuese mbi studentët *alumni* dhe harton raporte vjetore mbi gjetjet. Pjesë e këtyre raporteve janë edhe statistikat mbi punësimin e studentëve dhe cilësinë e punësimit në përputhje me profilin e programit të studimit. Duke qënë se programi Masteri Shkencave (PI) në “Drejtësi” nuk ka studentë të diplomuar, ende nuk ka të dhëna mbi punësimin e studentëve në këtë program studimi.

Evidenca “Tabela PIND, tabela 21”

Evidenca nr.28 “Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024”

Evidenca nr.30 “Raport Vjetori i veprimtarive FEDSH viti akademik 2022-2023; 2023-2024”

	Evidenca nr.42 "Raport Vjetori i veprimtarive ZSKK 2023-2024"			
Konkluzione	KUB administron dhe përditëson të dhënat statistikore mbi numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit deri në diplomim, përfshirë të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe të dhënat mbi shkallën e punësimit të tyre. Administrimi i të dhënave mundësohet nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të informacionit i cili mundëson marrjen e të dhënave si dhe raportimin në kohë reale tek autoritetet drejtuese. Sistemi i menaxhimit të informacionit mundëson gjithashtu sigurinë në ruajtjen dhe administrimin e informacionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	KUB mundëson kontributin e studentëve në proceset e rëndësishme vendimmarrëse që lidhen me veprimtarinë akademike dhe garantimin e standarteve të cilësisë së institucionit. Përfshirja e studentëve mundësohet nëpërmjet përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse më të rëndësishme në nivel institucional. Forma e parë që promovon pjesëmarrjen e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe mundëson përfaqësimin e tyre në organet drejtuese janë Këshillat Studentore. Aktet e brendshme rregullatore parashikojnë të drejtën e studentëve të organizohen në Këshilla Studentorë si organizime të pavarura të studentëve. Nëpërmjet procesit të zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre, mundësohet përfshirja e studentëve në organe e struktura të rëndësishme si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, NJSBC etj. Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik si organi më i lartë kolegjal në rang institucional. Përfaqësuesit e studentëve

	në Senat zgjidhen nga Këshilli Studentëor për një mandate katër vjeçar. NJSBC si organi që mbikqyr dhe vlerëson në mënyrë periodike sigurimin e brendshm të cilësisë ka në përbërje një student të përzgjedhur nga Këshilli i Studentëve. Këshilli i Etikës gjithashtu ka në përbërje një përfaqësues nga studentët. Studentët përfshihen edhe në proceset e vlerësimit të cilësisë në nivel institucional apo programesh studimi në cilësinë e anëtarëve të GVB në këto procese. <i>Evidenca "Tabela PIND, tabela 24"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e ZSKK"</i> <i>Evidenca nr 11 "Rregullore e Këshillit të Etikës"</i> <i>Evidenca nr 13 "Rregullore e Senatit Akademik të KUB"</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nëpërmjet mekanizmave të pjesëmarrjes së studentëve në organet kolegjiale si dhe sistemit të vendimarrjes, KUB bën të mundur që kontributi i studentëve të jetë real, konkret dhe me rezultate të matshme. Nëpërmjet Këshillave Studentorë studentët shprehin opinionin dhe qëndrimet e tyre mbi çështjet me interes të përgjithshëm në nivel institucional, si procesi mësimor, cilësia e shërbimeve mbështetëse, veprimtaritë sportive e kulturore etj. Studentët janë anëtarë të disa prej strukturave më të rëndësishme drejtuese në KUB si: Senati Akademik, NJSBC, GVB-të, etj, në të cilat kontributi i tyre është i drejtpërdrejtë si anëtarë me të drejta të plota të këtyre strukturave. Përfaqësimi i studentëve në Këshillin e Etikës mundëson tërheqjen e mendimit të studentëve në çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit dhe të procesit mësimor dhe kërkimor. Si anëtarë të grupeve të vetvlerësimit të brendshëm të cilësisë, studentët përcjellin qëndrimet e tyre mbi komponentët e cilësë në nivel institucional ose të programeve të studimit. Në të gjitha organet dhe strukturat ku marrin pjesë, studentët janë pjesë e vendimarrjes si anëtarë të këtyre organeve në përputhje me rregullimet e akteve të brendshme si dhe përcaktimin e legjislacionit në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale. Institucioni tërheq në formë të drejtëpërdrejtë mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorëve dhe sondazheve, ku studentët

	shprehin mendimin mbi cilësinë e programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies si dhe çdo aspekt tjetër të veprimtarisë akademike dhe shërbimeve mbështetëse. <i>Evidenca "Tabela PIND, tabela 24"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierë"</i> <i>Evidenca nr 11 "Rregullore e Këshillit të Etikës"</i> <i>Evidenca nr 13 "Rregullore e Senatit Akademik të KUB"</i> <i>Evidenca nr. 59.2 "Format pyetësori i studentëve IQE"</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale ku diskutohen çështje të cilësisë si Senati Akademik apo NJSBC mundëson kontributin e tyre edhe në çështje të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik si organi me i lartë vendimmarrës, i cili merr vendime edhe mbi programet e studimit. Pranë Senatit Akademik diskutohen dhe miratohen programet e reja mësimore si dhe brenda përcaktimeve të kuadrit ligjor, ndryshimet e nevojshme në kurrikula në funksion të përmirësimit të cilësisë. Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Këshillat Studentor, studentët shprehin qëndrimet dhe vlerësimet e tyre mbi programin mësimor. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre edhe në NJSBC duke mundësuar shprehjen e qëndrimeve mbi cilësinë e programeve mësimore si dhe sugjerimet mbi përmirësimin e cilësisë. Mekanizmi i drejtpërdrejtë nëpërmjet të cilit studentët shprehin opinionin e tyre mbi cilësinë e programeve të studimit janë pyetësorët, ku vlerësohen një sërë komponentësh lidhur me cilësinë e programeve mësimore. Departamenti i Drejtësisë dhe i Shkencave Sociale si njësia bazë në të cilën ofrohet ky program studimi, në propozimet që i referohen përmbajtjes së programit mësimor, konsideron edhe vlerësimet dhe qëndrimet e studentëve për përmirësimin e përmbajtjes së programit. <i>Evidenca "Tabela PIND, tabela 24"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i>

	<i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr 11 "Rregullore e Këshillit të Etikës"</i> <i>Evidenca nr 13 "Rregullore e Senatit Akademik të KUB"</i> <i>Evidenca nr. 42 "Raport vjetori i veprimtarive të ZSKK 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 46 "Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 59.2 "Format pyetësori i studentëve IQE"</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	KUB u mundëson studentëve shprehjen e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit të dijeve. Institucioni garanton gjithashtu, të drejtën e studentëve për tu njohur me rezultatet e vlerësimeve, si dhe të drejtën e ankimimit në përputhje me parashikimet e akteve rregullore. Aktet e brendshme rregullore përcaktojnë parimet dhe procedurat lidhur me zhvillimin e provimeve, komunikimin e rezultatit dhe shqyrtimin e ankimimit si dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre. Aspekte mjaft të detajuara në këtë drejtim parashikon Rregullorja e posaçme mbi zhvillimin e provimeve. Rregullorja e posaçme ka përcaktuar edhe afate për korigjimin e provimeve dhe informimin e studentëve mbi rezultatet e provimit. Për të mundësuar objektivitetin në vlerësim, aktet rregullore kanë përcaktuar format e kontrollit të dijeve si dhe komponentët e vlerësimit. Komponentët e sistemit të vlerësimit janë edhe pjesë përbërëse e formatit të sylabuseve të lëndëve/moduleve. Studentët kanë të drejtën të njihen me vlerësimin në provimin përfundimtar si dhe të drejtën e ankimimit ndaj rezultatit. Për trajtimin e ankesës Përgjegjësi i Departamentit ngre komisionin <i>ad hoc</i> të përbërë nga tre anëtarë. Për të garantuar objektivitetin, pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Studentët informohen sërish mbi rezultatet e rishikimit të vlerësimit, jo më vonë se pesë ditë nga dita e paraqitjes së ankesës. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS"</i>

	<i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i>			
Konkluzione	<i>KUB mundëson kontributin e studentëve në proceset e rëndësishme vendimmarëse që lidhen me veprimtarinë akademike dhe garantimin e statndarteve të cilësisë, si dhe në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit.</i> <i>Nëpërmjet mekanizmave të pjesëmarjes së studentëve në organet kolegjiale si dhe sistemit kolegjial të vendimmarrjes, KUB bën të mundur që kontributi i studentëve të jetë real, konkret dhe me rezultate të matshme.</i> <i>Institucioni garanton gjithashtu, të drejtën e studentëve për tu njohur me rezultatet e vlerësimeve, si dhe të drejtën e ankimit në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nëpërmjet akteve rregullatore të brendshme, KUB ka mundësuar procedura dhe struktura të posaçme për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë ciklit akademik. Nëpërmjet një sërë procedurash, KUB realizon informimin dhe orientimin e studentëve përpara fillimit të procesit mësimor. Komunikimi institucional me publikun realizohet nga Zyra e Marëdhënieve me Publikun. Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, një strukturë e dedikuar në këshillimin e studentëve, organizon takimet informuese me maturantët mbi programet e studimit si dhe ditët e hapura pranë ambienteve të KUB ku informon mbi profilin dhe programet e studimeve.

	Përmes fushatave publicitare, KUB bën publike dhe të njohur për të gjithë të interesuarit ofertën e tij akademike. Një burim mjaft i rëndësishëm informacioni është faqja zyrtare e KUB në përmbajtjen e së cilës ka informacion të pasur mbi programet e studimit, tarifat e shkollimit, personelin akademik, infrastrukturën dhe shërbimet. KUB përditson në mënyrë sistematike faqen e tij zyrtare duke mundësuar informim edhe mbi aktivitetet shkencore, eventet, marëveshjet e bashkëpunimit me institucione partnere etj. Në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, KUB e pasqyron këtë informacion edhe në Guidën Studentore, e cila shërben si një dokument orientues për të gjitha aspektet e ciklit akademik. Për të mundësuar një shkallë sa të gjerë njohjeje, Guida Studentore publikohet edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë gjithë procesit akademik studentët mbështeten dhe orientohen nga struktura të dedikuara si: Sekretaria Mësimore, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës që orientojnë studentët mbi aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e programit të studimit. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr. 9.1 " Udhëzuesi i karrierës"</i> <i>Evidenca nr. 27 "Udhëzues për përgatitjen e praktikës profesionale"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 105 "Guida Studentore"</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin	Nëpërmjet strukturave të dedikuara, KUB ka ngritur dhe bërë funksional një sistem për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Një sërë strukturash si Sekretaria Mësimore, Departamentet, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës janë pjesë e këtij sistemi. Përpara fillimit të vitit akademik, Sekretaritë Mësimore orienetojnë kandidatët

mësimor dhe programin e studimit.	mbi dokumentacionin dhe procedurat e nevojshme për regjistrim në programet e studimit që KUB ofron. Gjatë ciklit akademik, studentët informohen mbi orarin mësimor, sezonet dhe kalendarin e provimeve. Nëpërmjet platformave si <i>portali Sekretaria Mësimore</i> shpërndan informacionin në kohë reale dhe e bën atë të aksesueshëm për të gjithë studentët e interesuar. Departamentet realizojnë programin e studimit dhe orientojnë studentët mbi aspektet e procesit mësimor. Departamentet luajnë veçanarisht një rol të rëndësishëm në drejtim të mbështetjes në zhvillimin e praktikave profesionale, temave të diplomave ku caktohen pedagogët përgjegjës për secilin student ose grupe studentësh. Një strukturë e rëndësishme në mbështetje të studentëve është edhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. ZSKK është zyra përgjegjëse që mban marëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, si dhe drejton procesin e këshillimit të studentëve. Evidenca nr. 4 “<i>Rregullore e KUB</i>” Evidenca nr. 5 “<i>Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS</i>” Evidenca nr. 7 “<i>Rregullore e programit të studimit</i>” Evidenca nr 9 “<i>Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës</i>” Evidenca nr. 9.1 “<i>Udhëzuesi i karrierës</i>” Evidenca nr. 27 “<i>Udhëzues për përgatitjen e praktikës profesionale</i>” Evidenca nr.66 “<i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>”
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	Një sërë strukturash, në kuadrin e kompetencave të tyre mbështesin dhe këshillojnë studentët gjatë procesit mësimor, zhvillimit të praktikave profesionale si dhe orientimit në tregun e punës. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është zyra përgjegjëse që mban marëdhënie të vazhdueshme me Këshillat Studentorë, si dhe drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve. ZSKK mbështet studentët duke u ofruar informim të vazhdueshëm, sugjerime dhe orientime mbi karrierën si dhe mundësi për zgjerimin e njohurive profesionale, përmes

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	marëdhënieve me institucione private dhe publike. Zyra gjithashtu, në bashkëpunim me departamentet përkatëse, ndihmon në dhe orientimin e tyre gjatë zhvillimit të praktikës profesionale. Me qëllim realizimin me sukses të praktikave profesionale, KUB ka lidhur një sërë marrëveshesh me organizata apo përfaqësues e kompani biznesi. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale cakton pedagogët mbikqyrës për të mundësuar orientimin dhe mbikqyrjen e studentëve gjatë zhvillimit të praktikës profesionale. Rregullorja e Departamentit përcakton detaje mbi procedurat dhe përgjegjësitë e Departamentit për zhvillimin e praktikës profesionale. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njesisë Kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr. 9.1 " Udhëzuesi i karrierës"</i> <i>Evidenca nr. 21 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë"</i> <i>Evidenca nr. 27 "Udhëzues për përgatitjen e praktikës profesionale"</i> <i>Evidenca nr. 44 " Studim tregu për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës ka si pjesë të kompetencave mbështetjen e studentëve duke u ofruar informim të vazhdueshëm, sugjerime dhe orientime mbi karrierën si dhe mundësi për zgjerimin e njohurive profesionale, përmes marëdhënieve me institucione private dhe publike. Kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, realizon studime gjurmuese mbi këtë kategori, grumbullon informacione mbi punësimin e studentëve <i>alumni</i>. Për sa i takon të dhënave mbi punësimin e studentëve, ZSKK, në kuadrin e kompetencave të saj, kryen studime gjurmuese mbi studentët <i>alumni</i> dhe harton raporte vjetore mbi gjetjet. Pjesë e këtyre raporteve janë edhe statistikatat mbi punësimin e studentëve dhe cilësinë e punësimit në përputhje me profilin e

	programit të studimit. Duke qënë së programi Masteri Shkencave (PI) në “Drejtësi” nuk ka studentë të diplomuar, ende nuk ka të dhëna mbi punësimin e studentëve në këtë program studimi. <i>Evidenca “Tabela PIND, tabela 23”</i> <i>Evidenca nr 9 “Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i> <i>Evidenca nr. 9.1 “ Udhëzuesi i karrierës”</i> <i>Evidenca nr.28 “Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2023-2024”</i> <i>Evidenca nr.42 “Raport Vjetori i veprimtarive ZSKK 2023-2024”</i>			
Konkluzione	<i>Nëpërmjet akteve rregullatore të brendshme, KUB ka mundësuar procedura dhe struktura të posaçme për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë ciklit akademik.</i> <i>Një sërë strukturash, në kuadrin e kompetencave të tyre, mbështesin dhe këshillojnë studentët gjatë gjithë procesit mësimor, zhvillimit të praktikave profesionale si dhe orientimit në tregun e punës.</i> <i>Nëpërmjet Zyras së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, realizon studime gjurmuese mbi këtë kategori, si dhe grumbullon dhe analizon informacione mbi punësimin e studentëve alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Një nga objektivat specifike të këtij programi, sanksionuar në Rregulloren e tij, është paisja e studentëve me dije të thellura për të qenë konkurrues në tregun e punës dhe kërkimin shkencor në fushën e së drejtës. Siç u pohua edhe nga takimi i GJV me personelin akademik, në funksion të formimit të studentëve me njohuritë e nevojshme teoriko-praktike personeli akademik përdor metoda të mësimdhënies që aftësojnë studentët, jo vetëm me njohuritë teorike, por edhe ato praktike. Kombinimi i leksioneve me praktikën gjyqësore, zgjidhja e kazuseve, zhvillimi i debateve, si dhe forma të tjera interaktive, nxisin aftësimin praktik dhe analitik të studentëve. Një element tjetër, është zbatimi i metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të formave të avancura të teknologjisë. KUB ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive innovative. Për këtë qëllim, klasat e leksioneve dhe seminareve janë të paisura me mjete e nevojshme si: Lab Top, video projektorë, kamera, tabela shkrimi si dhe akses të palimituar në internet. Në funksion të procesit të mësimdhënies, KUB përdor edhe platforma të tilla si <i>portali</i>, apo <i>Google Classroom</i> cilat lehtësojnë procesin e mësimdhënies, komunikimin student pedagog, si dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm në funksion të procesit të mësimdhënies. Për përdorimin efikas të këtyre platformave janë hartuar udhëzues të posaçëm. <i>Evidenca nr. 7 "Rregullorja e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr. 52 " Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e portali KUB"</i> <i>Evidenca 74 "Guida e stafit për përdorimin e platformës Classroom KUB"</i> <i>Evidenca 96 "Guida e studentit për përdorimin e platformës Classroom KUB"</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Cilësia e mësimdhënies është një nga komponentët më të rëndësishëm të vlerësimit të cilësisë. Si e tillë është pjesë e politikave të zhvillimit të cilësisë pasqyruar në dokumentat strategjike në nivel institucional. KUB ka ngritur një sistem të monitorimit të brendshëm të cilësisë si dhe ka krijuar mekanizmat e nevojshëm të monitorimit. Për këtë qëllim janë ngritur dhe bërë funksionale strukturat e brendshme të vlerësimit të cilësisë. Kompetencat e këtyre strukturave janë objekt rregullimi në aktet e brendshme rregullatore. Struktura më e rëndësishme në këtë drejtim është Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi monitoron cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve periodike ku tërhiqet mendimi i studentëve për procesin mësimor. Këto pyetësorë realizohen dy herë në vit, në periudhën përpara zhvillimit të provimeve. Nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura, Institucioni mundëson shërbimin e agjencive të jashtme si IQE në procesin e vlerësimit të cilësisë, për të bërë këtë proces sa më të besueshëm dhe objektiv. Institucioni përdor edhe mekanizma të tjerë të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies si, monitorimi i aftësive mësimdhënëse në auditor. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, mbikqyr gjithashtu cilësinë e mësimdhënies dhe veprimtarinë mësimore të stafit akademik. <i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC "</i> <i>Evidenca nr. 31 Raport vjetor i veprimtarive akademike Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023, 2023-2024 "</i> <i>Evidenca nr.45 "Plani Vjetor i NJSBC Viti Akademik, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.46 "Raport Vjetor i NJSBC Viti Akademik, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies,	Në kuadrin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, KUB monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike edhe cilësinë dhe metodat e mësimdhënies. Një nga mekanizmat e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, është sistemi i anketimit të studentëve ku pasqyrohet vlerësimi i studentëve mbi performancën e

të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	pedagogëve dhe cilësinë e mësimdhënies. Pyetësoret zhvillohen dy here gjatë vitit akademik, çdo fund semesri, përpara fillimit të sezonit të provimeve. Nga takimi me përfaqësues të NJSBC u evidentua se ka një pjesëmarrje të mirë të studentëve në pyetësorët e vlerësimit të cilësisë. Për të lehtësuar procesin, studentëve u mundësohet realizimi i pyetësorit edhe nëpërmjet formatit elektronik duke u loguar me adresën zyrtare të emailit. Rezultatet e anketimeve janë pjesë e raporteve përfundimtare të NJSBC të cilat bëhen të njohura për të gjitha strukturat. Studentëve u mundësohet shprehja e opinionit mbi sistemin e vlerësimit të dijeve edhe nëpërmjet të drejtës të ankimimit. Një sërë aktesh rregullatore të brendshme e sanksionojnë këtë të drejtë. Këto akte parashikojnë gjithashtu rregullime të detajuara mbi afatet, procedurat dhe strukturat e përfshira. Në takimin e realizuar nga GVJ me studentët e këtij programi studimi, ata pohuan se institucioni respekton dhe zbaton me korrektësi të drejtën e studentëve për ankimimin e rezultateve të provimit. Evidenca nr. 5 “Rregullore e Njesisë kryesore FEDSHS” Evidenca nr. 7 “Rregullore e programit të studimit” Evidenca nr. 14 “Rregullore e Zyrës së NJSBC” Evidenca nr. 64 “Rregullore për zhvillimin e Provimeve” Evidenca nr 46 “Raport vjetor i NJSBC, viti akademik 2023-2024”
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në kuadrin e sigurimit të cilësisë, një sërë strukturash si NJSBC, Zyra e Kurrikulave dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, ushtrojnë funksione të sigurimit dhe monitorimit të cilësisë së mësimdhënies. Çdo vit akademik NJSBC përpunon të dhënat që vijnë nga anketimet dhe instrumentat e tjerë të vlerësimit të cilësisë dhe harton Raportin Vjetor. Raportet e NJSBC dërgohen fillimisht në rektorat, dhe më tej bëhen të njohura edhe për fakultetet dhe departamentet. Më tej, raportet vjetore të NJSBC bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të Zyrës së NJSBC u pohua se raportet vjetore të NJSBC bëhen të njohura dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Gjithashtu rezultatet dhe konstatimet e raportit të NJSBC si dhe vlerësimet e departamenteve mbi monitorimin e cilësisë janë pjesë përbërëse e raporteve vjetore që hartohen në nivel

	institucional. Këto raporte gjithashtu bëhen të njohura dhe publikohen në faqen ëeb të institucionit. Personeli akademik dhe studentët janë pjesë e proceseve të sigurimit të cilësisë, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në strukturat e monitorimit të cilësisë si NJSBC. NJSBC ka në përbërje të saj përfaqësues të personelit akademik si dhe një student. Përfshirja në procesin e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit, mundëson studentët dhe pedagogët të jenë aktorë në këtë proces si dhe të kenë dijeni mbi procesin dhe rezultatet e tij. <i>Evidenca nr. 14 "Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr 28 "Raport vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raport vjetor i NJSBC, viti akademik 2021-2022, 22-23, 23-24"</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Monitorimi i cilësisë nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit të cilësisë që KUB zbaton, i shërben evidentimit të rezultateve dhe konkluzioneve mbi gjendjen aktuale si dhe propozimit të masave konkrete për përmirësimin e cilësisë. NJSBC si struktura kryesore e monitorimit të cilësisë, bazuar në konkluzionet që nxjerr nga përdorimi i instrumentave të vlerësimit të cilësisë, duhet të evidentojë problematikat dhe të propozojë masa për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Rezultatet që vijnë nga vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies janë pjesë e raporteve vjetore të NJSBC ku pasqyrohen edhe propozimet konkrete të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë. Institucioni përdor gjithashtu një sërë metodash për përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e aftësisë dhe kualifikimit shkencor të stafit akademik si pjesëmarrje në trajnime, aktivitete shkencore apo projekte shkencore. Nxitja e performancës së stafit akademik mundësohet edhe nëpërmjet mekanizmash stimulues të tillë si mbështetja dhe shpërblimet financiare për stafin me performancë pozitive. Zbatimi i këtij mekanizmi u pohua edhe nga përfaqësues të stafit akademik efektiv në takimin e zhvilluar me ekspertët e GVJ.

	<i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr. 21 "Lista e marëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë"</i> <i>Evidenca nr. 31 Raport vjetor i veprimtarive akademike Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023, 2023-2024 "</i> <i>Evidenca nr.45 "Plani Vjetor i NJSBC Viti Akademik, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr.46 "Raport Vjetor i NJSBC Viti Akademik, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 76 "Raport i planifikimit të zhvillimit të aktiviteteve të KUB nga marëveshja Erasmus+ "</i> <i>Evidenca nr. 82 "Revista Shkenore e Studimeve Profesionale KUB, 2024"</i>			
Konkluzione	<i>KUB zbaton politika të monitorimit të cilësisë, ku cilësia e mësimdhënies është një nga komponentët e rëndësishëm të monitorimit dhe vlerësimit.</i> <i>Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësi bazë përgjegjëse, NJSBC si dhe strukturat e tejsra të dedikuara të cilësisë në nivel institucional, monitorojnë cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësojnë aftësitë mësimdhënëse të stafit akademik.</i> <i>KUB mundëson përfshirjen e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet sistemit të anketimit ku pasqyrohet vlerësimi i tyre mbi performancën e pedagogëve dhe cilësinë e mësimdhënies.</i> <i>Rezultatet e nxjerra i shërbejnë evidentimit të konkluzioneve mbi gjendjen aktuale si dhe marrjes së masave konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	KUB ka hartuar politikat e tij të cilësisë si dhe ka ngritur strukturat e sigurimit të cilësisë. Politikat e zhvillimit të cilësisë në KUB, janë hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Standardet dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, Planin Strategjik të Zhvillimit të institucionit 2021-2026, Statutit dhe Rregullores së KUB, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë. Referuar akteve rregullatore të institucionit, sigurimi i cilësisë fokusohet në çështjet akademike siç janë: hartimi kurrikulave, akreditimi i programeve, rishikimi i brendshëm dhe i jashtëm, standardet akademike dhe etike. Pjesë e monitorimit të cilësisë janë edhe mësimdhënia, mësimnxënia, shërbimet që mbështetin studentët si dhe infrastruktura. Për implementimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave të cilësisë KUB ka ngritur strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë si Senati Akademik; NJSBC, Komisioni i Kurikulës, si dhe ka përcaktuar me akte rregullatore rolet dhe kompetencat e tyre. Një rol të rëndësishëm në monitorimin e cilësisë luajnë edhe njësitë kryesore dhe ato bazë brenda institucionit. <i>Evidenca nr 2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 8. "Rregullorja e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr. 13 "Rregullore e Senatit Akademik të KUB"</i> <i>Evidenca nr 14. "Rregullorja e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr 14.1 " Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe	KUB ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me planet strategjike institucionale. Në kuadër të strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në KUB, organi më i lartë

zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	kolegjal në nivel institucional është Senati Akademik. Senati Akademik është gjithashtu organi më i lartë përgjegjës që garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore. Senati Akademik ngre NJSBC si struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. NJSBC është struktura përgjegjëse për vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, aktet rregullatore institucionale dhe standartet shtetërore të cilësisë. Në kuadrin e monitorimit të cilësisë kjo njësi, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Ajo përgatit raportin vjetor të vlerësimit, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Zyra e Kurrikulave është një strukturë përgjegjëse për garantimin dhe sigurimin e cilësisë së kurrikulave dhe programeve të studimit të KUB. Njësitë kryesore në KUB, bashkërendojnë veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore si dhe veprimtaritë me karakter profesional dhe krijues. Departamenti si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Tërheqja e mendimit të studentëve mbi procedurat dhe politikat e zhvillimit të cilësisë mundësohet nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Senatin Akademik dhe NJSBC. Pjesë përbërëse e NJSBC është gjithashtu edhe një ekspert i jashtëm. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale"</i> <i>Evidenca nr 8. "Rregullorja e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr. 13 "Rregullore e Senatit Akademik të KUB"</i> <i>Evidenca nr 14. "Rregullorja e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për	Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, KUB ka përdorur instrumentat e duhur për sigurimin, menaxhimin dhe ruajtjen e standarteve të cilësisë. Institucioni i është nënshtruar

sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, si në kuadrin e akreditimit institucional, ashtu edhe në kuadrin e vlerësimit të programeve të studimit që ofron. KUB është liçensuar me VKM nr. 651, datë 14.09.2011, "Për liçensimin si Institucion i Arsimit të Lartë". Ky institucion ka nisur aktivitetin akademik në vitin akademik 2011-2012, fillimisht me emërtimin "Akademia Profesionale e Biznesit". KUB ka realizuar akreditimin institucional në vitin 2012 dhe më tej, akreditimet periodike në vitin 2017 dhe 2022. Me vendim nr. 3, datë 07.01.2022, "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar i Biznesit" është akredituar institucionalisht për 4 vite akademike. Vlefshëmëria e akreditimit është deri më datë 06.01.2026. Gjatë vitit akademik 2020-2021 me urdhërin nr. 236, datë 15.07.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka riorganizuar programet e studimit Bachelor në "Drejtësi" dhe "E drejtë Biznesi" në Programin e Integruar të Nivelit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi". Programin e Integruar i Nivelit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi", është hapur me VKM nr. 651, datë 14.09.2011 "Për liçensimin si institucion i arsimit të lartë mësimor 2011-2012". Ky program akreditohet dhe diplomon studentët për herë të parë. <i>Evidenca nr. 15 "Dokumentacion mbi liçencimin e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 46 "Raport vjetori i NJSBC viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 58 "Raport vjetori i veprimtarsisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,	Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komponentëve të saj, është pjesë e planeve strategjike të zhvillimit të institucionit. KUB ka hartuar dhe pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumenta ku parashikohen parimet dhe standartet e sigurimit të cilësisë. Aktet rregullatore të institucionit i japin një hapësirë të gjerë proceseve të sigurimit të cilësisë dhe komponentëve të vlerësimit të cilësisë si

institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe kualifikimi i personelit akademik. Në përputhje me aktet rregullatore, institucioni përdor treguesit e duhur të cilësisë për vlerësimin e gjendjes, si dhe identifikimin e anëve pozitive dhe mangësive. Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor konsiderohen si shtylla baza të sigurimit të cilësisë. Institucioni ka përcaktuar tregues që identifikojnë cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, dhe nëpërmjet mekanizmave të monitorimit të cilësisë përcakton arritjet më të mira dhe mangësitë më qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikula i nënshtrohen proceseve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Mbi bazën e vlerësimit dhe analizës së treguesve të cilësisë, institucioni nxit dhe promovon arritjet më të mira në komponentët e programit të studimit. Performanca e punës kërkimore dhe cilësia e mësimdhënies së stafit vlerësohen nëpërmjet promovimit të personelit akademik edhe stimujve financiarë. <i>Evidenca nr 2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 46 "Raport vjetori i NJSBC viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 58 "Raport vjetori i veprimtarsisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i>
Konkluzione	<i>Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe aktet rregullatore të brendshme, KUB ka përdorur instrumentat e duhur për sigurimin, menaxhimin dhe ruajtjen e standarteve të cilësisë.</i> <i>Për implementimin dhe monitorimin e politikave dhe procedurave të cilësisë, KUB ka ngritur dhe bërë funksionale strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë.</i> <i>Në përputhje me aktet rregullatore, institucioni përdor treguesit e duhur të cilësisë për vlerësimin e gjendjes, si dhe identifikimin e anëve pozitive dhe mangësive.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	KUB ka vënë në zbatim mekanizmat e duhur për mbikëqyrjen periodike të këtij programi studimi si dhe përdor struktura dhe procedura për vlerësimin e cilësisë së programit. Në këtë proces përfshihen një sërë strukturash si Senati Akademik, NJSBC, Zyra e Kurikulës, Dekanati dhe Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Në procesin e mbikëqyrjes periodike të programit të studimit përfshihen gjithashtu edhe studentët, si në formë të drejtpërdrejtë nëpërmjet anketimeve, ashtu edhe në formë indirekte nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet e vlerësimit të cilësisë si Senati Akademik apo NJSBC. Programet e studimit vlerësohen edhe çdo fillim viti akademik, nëpërmjet procesit të miratimit të programeve të reja mësimore ku mundësohen përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme. Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i administruar, GVJ konstaton se rishikimi i syllabuseve për përditësimin e materialeve bëhet në fillim të çdo viti akademik. Rezultatet që evidentohen nga mbikëqyrja periodike dhe vlerësimi i programit, pasqyrohen në raporte vjetore nga niveli institucional deri në nivelin e njësive bazë. KUB harton raporte vjetore në nivel institucional, nivel fakultetesh dhe nivel departamenti. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi", harton raportin vjetor në fund të vitit akademik i cili analizon cilësinë e programit mësimor dhe veprimtarisë akademike dhe shkencore të kësaj njësie. Raportet ku pasqyrohen edhe rezultatet e vlerësimeve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse që nga niveli më i lartë deri në nivel departamenti. Konkluzionet dhe propozimet pasqyrohen në dokumente në formën e planit të masave ku

	përcaktohen masat që duhet të marrë institucioni për korigjimin e mangësive dhe arritje më të mira. <i>Evidenca "RVB Programi i integruar në Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 18 "Procesverbal pune GVB"</i> <i>Evidenca nr. 19 "Plani i punës GVB"</i> <i>Evidenca nr. 31 Raport vjetor i veprimtarive akademike Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023, 2023-2024 "</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike, KUB ka ngritur dhe zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë. Nëpërmjet këtij sistemi, institucioni vlerëson komponentë lidhur me programet e studimit që ofron, cilësinë e mësimdhënies si dhe kualifikimin shkencor të stafit akademik, standartet e infrastrukturës etj. Rezultatet që evidentohen nga mbikqyrja periodike dhe vlerësimi i cilësisë janë pjesë e raporteve të strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Një sërë strukturash si NJSBC, departamentet dhe fakultetet hartojnë raporte apo analiza vjetore të veprimtarisë së tyre. Raportet vjetore hartohen gjithashtu edhe në rang institucional. Raporti vjetor i institucionit analizon shkallën e realizimit të veprimtarive të njësive përbërëse të KUB, si dhe përcakton objektivat dhe rekomandimet përkatëse. Format dhe përmbajtje të ngjashme kanë edhe në raportet mbi veprimtarinë e njësive kryesore apo atyre bazë. Në raportet e saj, NJSBC pasqyron rezultatet që vijnë nga vlerësimi i treguesve të cilësisë, përpunimi i anketimeve si dhe arritjet dhe mangësitë e konstatuara. Pjesë e këtyre raporteve janë edhe analizat dhe konkluzionet mbi çështjet e evidentura nga procesi i vlerësimit të cilësisë, si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Raporti shqyrtohet nga organet vendimmarrëse të institucionit dhe vërejtjet dhe sugjerimet kthehen në masa konkrete. Raporti shpallet publikisht

	duke u bërë në këtë mënyrë i njohur për të gjithë të palët e interesuaruara. Gjetjet e këtyre raporteve shërbejnë për hartimin e planeve të veprimit dhe marrjen e masave konkrete që i referohen përmirësimit të komponentëve të cilësisë. <i>Evidenca "RVB Programi i integruar në Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 31 Raport vjetor i veprimtarive akademike Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023, 2023-2024 "</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	KUB në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së këtij programi studimi, përdor mekanizma të drejtpërdrejta të vlerësimit si vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës së programit të studimit, aftësitë e të nxëniet, rezultate e studentëve gjatë testimeve të ndërmjetme dhe atëre përfundimtare, vlerësimin e detyrave të kursit, rezultatet në praktikën profesionale dhe mbrojtjen e diplomës etj. Këto metoda i referohen si vlerësimit të përmbajtjes së programit të studimit, ashtu edhe vlerësimit të komponentëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodatat e drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë janë objekt rregullimi në aktet e brendshme rregullatore si Rregullorja e NJSBC dhe rregulloret në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Këto akte rregullatore përcaktojnë në detaje metodatat e vlerësimit të dijeve si dhe përparimit akademik të studentëve, si dhe përmbajtjen e lëndëve dhe veprimtaritë formuese. Këto elementë janë gjithashtu edhe pjesë e syllabuseve të lëndëve/ moduleve. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si struktura përgjegjëse bazë për zbatimin e programit të studimit, vë në zbatim metodatat e drejtpërdrejta të vlerësimit të mësimdhënies. Për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, institucioni gjithashtu përdor edhe një sërë metodash të tjera, si anketimet e studentëve, vlerësimi i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore nga

	Departamenti, vlerësimi i aftësive dhe metodave të mësimdhënies nëpërmjet vëzhgimit në auditor etj. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 14 "Rregullore e Zyrës së NJSBC";</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	KUB me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron, përdor një sërë metodash dhe instrumentash të tërthorta vlerësimi. Në këtë proces institucioni përfshin një sërë subjektsh si studentët, personelin akademik dhe atë ndihmës akademik dhe administrativ, studentët <i>alumni</i>, punëdhënësit e tyre si dhe institucionet partnere. Vlerësimi i cilësisë së programit mundësohet nëpërmjet përdorimit të instrumentave të tërthorta të vlerësimit si, sondazhe të studentëve që ndjekin programin e studimit, sondazhe të studentëve <i>alumni</i>, vlerësimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ etj. Studentët e këtij programi studimi ende nuk janë diplomuar, si pasojë vlerësimi i cilësisë së këtij programi nuk përfshin sondazhe të studentëve <i>alumni</i>. NJSBC-ja është përgjegjëse për vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në KUB. Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, NJSBC përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Institucioni e përfshin këtë informacion në vlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vlerësimeve të brendshme periodike.

	<i>Evidenca "RVB Programi i integruar në Drejtësi"</i> <i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i>			
Konkluzione	<i>KUB ka vënë në zbatim mekanizmat e duhur për mbikqyrjen periodike të këtij programi studimi si dhe përdor struktura dhe procedura për vlerësimin e cilësisë së programit.</i> <i>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së këtij programi studimi, institucioni përdor një sërë mekanizmash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit.</i> <i>Të dhënat që rezultojnë nga proceset e vlerësimit shërbejnë për të evidentuar arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të treguesve të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në zbatim të strategjive institucionale dhe akteve rregullatore, KUB ka hartuar politika dhe zbaton procedura të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka ngritur strukturat e nevojshme si dhe ka përcaktuar kompetencat e tyre në proceset e vlerësimit të cilësisë. Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë janë përfshirë një sërë strukturash si Senati Akademik, NJSBC, Zyra e Kurrikulave, fakultetet, departamentet etj. Në zbatim të procedurave të vlerësimit të cilësisë, institucioni garanton përfshirjen e një sërë aktorësh si dhe mundëson kontributin e tyre në këtë process. Nëpërmjet pyetësorëve dhe sondazheve ku japin vlerësimin e tyre për komponentët e cilësisë së programit të studimit, në këtë proces përfshihen studentët e këtij programi. Ndonëse ky program nuk ka ende student <i>alumni</i>, institucioni mban kontakte dhe realizon sondazhe që i referohen

	cilësisë edhe me studentët alumni, të diplomuar në programet që ofron KUB. NJSBC, nëpërmjet instrumentave që zbaton në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit, mundëson përfshirjen e një sërë aktorësh të brendshëm dhe të jashtëm si të studentëve, të diplomuarve, të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin e programit të studimit. KUB ka mundësuar përfshirjen në proceset e vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi edhe bashkëpunëtorë të huaj si IQE, Grant Thornton etj. <i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC";</i> <i>Evidenca nr 14.1 " Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr. 25 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-Grant Thornton"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 46.3 "Format pyetësori i studentit KUB"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	KUB ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore që i referohet të gjithë aspekteve të veprimtarisë akademike në institucion. Gjithashtu nëpërmjet akteve të brendshme ka ngritur dhe bërë funksional sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në zbatim të këtij sistemi, aktet rregullatore kanë përcaktuar strukturat përgjegjëse si dhe detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për secilën prej tyre. Kompetencat dhe detyrat e strukturave kryesore të vlerësimit të cilësisë si Senati Akademik, NJSBC, Zyra e Kurrikulave, fakultetet, departamentet, parashikohen në akte rregullatore të posaçme. Struktura bazë në këtë drejtim është Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, që ndjek dhe monitoron cilësinë e programit të studimit si dhe aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Departamenti harton raporte vjetore mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore ku evidentohen çështje të cilësisë mbi veprimtarinë akademike dhe programin e studimit. NJSBC në

	bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik. Njëkohësisht, nëpërmjet pyetësorëve, vlerëson performancën dhe aftësitë akademike dhe didaktike të personelit akademik. Përdorimi i pyetësorve si instrumenta të vlerësimit të cilësisë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të cilësisë. Gjithashtu aktet e brendshme rregullatore kanë parashikuar rolin dhe kontributin e studentëve dhe palëve të tjera të angazhuara në proceset e vlerësimit të cilësisë si ekspertë, agjenci të huaja të kontartkuara si IQE, Grand Thourton etj. <i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 8. "Rregullorja e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr. 25 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-Grant Thornton"</i> <i>Evidenca nr. 46.3 "Format pyetësori i studentit KUB"</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nëpërmjet akteve të brendshme rregullatore KUB ka përcaktuar kompetencat, detyrat dhe rolin e strukturave të brendshme dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Në këtë mënyrë KUB garanton përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit ndihmësakademik e administrativ dhe studentëve të programit të studimit në këtë proces. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale pranë Fakultetit të Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Referuar rregullores përkatëse, Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale mbikqyr veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative që lidhet me këtë program studimi. Si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti ka një sërë kompetencash lidhur me mbarëvajtjen e programit të

	studimit, procesin e hartimit të programeve mësimore, literatures, metodave të mësimdhënies si dhe veprimtarisë shkencore të stafit akademik. Për pasojë, luan një rol të rëndësishëm për ruajtjen e standarteve të cilësisë të programit të studimit. Për arritjen e objektivave të tij, Departamenti bashkërendon veprimtarinë e mbikqyrjes së cilësisë me njësinë kryesore FEDSHS si dhe strukturat e dedikuara në fushën e cilësisë. Njësia kryesore për këtë program studimi FEDSHS, bashkërendon punën akademike dhe administrative nëpërmjet strukturave përkatëse. Aktet regullatore përcaktojnë gjithashtu rolin dhe kompetencat e strukturave ndihmës akademike dhe administrative në mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC";</i> <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FEDSHS"</i> <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale"</i> <i>Evidenca nr. 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 8. "Rregullore e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në procesin e sigurimit të cilësisë KUB zbaton procedura që mundësojnë gjetje objektive mbi komponentët e cilësisë së jetës akademike dhe institucionale si dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit. Gjithashtu aktet e brendshme rregullatore hartohen në zbatim të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Politikat si dhe strategjitë zhvillimore të institucionit udhëhiqen nga respektimi i parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit në zbatimin të procedurave të mbikqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë. Këto parime udhëheqin gjithashtu veprimtarinë akademike, kërkimore dhe shkencore të personelit akademik. Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi, respekton lirinë akademike të stafit akademik, në procesin e hartimit të përmbajtjes së syllabuseve dhe programeve të lëndëve si dhe veprimtaritë e ndryshme akademike. Bazuar në parimin e barazisë, institucioni nxit dhe mbështet financiarisht aktivitetet dhe veprimtarinë shkencore e

	profesionale të personelit akademik. Kompetenca profesionale dhe cilësia e mësimdhënies janë pjesë e vlerësimit periodik nëpërmjet pyetësorëve të studentëve duke mundësuar objektivitetin në procesin e vlerësimit të cilësisë. Respektimit të parimit të objektivitetit dhe barazisë i shërben dhe përfshirja e strukturave të pavarura si IQE, në procesin e vlerësimit të cilësisë. <i>Evidenca nr 14.1 " Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC, viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 46.3 "Format pyetësori i studentit KUB"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	KUB zbaton politika dhe procedura që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë si dhe garantojnë kontributin e tyre real në këtë proces. Aktet rregullatore parashikojnë përbërjen e ekspertëve të jashtëm në strukturat e vlerësimit të cilësisë. Në përbërjen e NJSBC, si organi kryesor i vlerësimit të cilësisë në nivel institucional, është edhe një ekspert i jashtëm. Një formë e angazhimit të aktorëve të jashtëm, është përfshirja e stafit akademik me kontratë në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi. Stafi akademik me kontratë që mbulon këtë program studimi karakterizohet nga një eksperiencë e gjatë profesionale në fusha që lidhen me përmbajtjen e programit të studimit. Kjo ndihmon ritjen e cilësisë së programit dhe cilësinë e mësimdhënies. Në takimin e GVJ me stafin akademik u konstatua një pjesëmarrje dhe angazhim aktiv i tyre në procesin e vlerësimit të programit të studimit. Për realizimin e praktikave profesionale KUB ka lidhur marëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh, publike e private si dhe aktorë në fushën e biznesit, kontributi i të cilëve ndikon pozitivisht në përputhshmërinë e programit me kërkesat e tregut të punës. Nëpërmjet marëveshjeve të bashkëpunimit KUB ka mundësuar ekspertizën e huaj në proceset e sigurimit të

	cilësisë. KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Institutin për Cilësi në Arsim (IQE)), një institut privat i specializuar në vlerësimin e komponentëve të cilësisë. IQE jep kontributin në procesin e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet realizimit të pyetësorit të studentëve dhe dhe më tej hartimit të raporteve ku pasqyrohen gjetjet që rezultojnë nga pyetësorët. <i>Evidenca nr. 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC";</i> <i>Evidenca nr. 59 "Marëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i> <i>Evidenca nr. 59.1 "Raporti i IQE për staf akademik 2023"</i> <i>Evidenca nr. 59.4 "Raporti i IQE për studentët 2023"</i>			
Konkluzione	<i>Në kuadrin e procesit të vlerësimit të cilësisë, KUB ka përcaktuar kompetencat, detyrat dhe rolin e strukturave të brendshme dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.</i> <i>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të cilësisë bazohet në parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit.</i> <i>KUB zbaton politika që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë si IQE, Grand Thourton etj, dhe garanton kontributin e tyre real në këtë proces.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	KUB harton plane strategjike, politika të zhvillimit të cilësisë si dhe raporte vjetore që i referohen veprimtarive në kuadrin e vlerësimit të cilësisë. Gjithashtu në aktet rregullatore të brendshme përfshihen një sërë parashikimesh që i referohen procedurave dhe strukturave të sigurimit të cilësisë. Politikat,

programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	strategjitë dhe parashikimet e aktet rregullatore në çështje të sigurimit të cilësisë janë transparente dhe bëhen të njohura për palët e interesuara, përfshirë personelin akademik, atë ndihmës akademik dhe administrativ si dhe studentët. NJSBC komunikon rezultatet që vijnë nga procesi i monitorimit të cilësisë, fillimisht në Rektorat, dhe më tej nëpërmjet sistemit të komunikimit vihen në dijeni strukturat drejtuese në nivel fakultetesh dhe departamenti. Rezultatet dhe raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm të NJSBC bëhen të njohura nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit. Personeli akademik dhe studentët përfshihen në veprimtaritë dhe procedurat e sigurimit të cilësisë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në strukturat e sigurimit të cilësisë si, Senati Akademik apo NJSBC. Kjo mundëson që ata të jenë aktorë të drejtpërdrejtë në proceset e vlerësimit të cilësisë. <i>Evidenca nr. 2 "Plani strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr. 45 "Plani vjetori i NJSBC Vitik Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Faqja zyrtare e institucionit: www.kub.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në procesin e sigurimit të cilësisë KUB zbaton procedura që mundësojnë objektivitet mbi vlerësimin ekomponentëve të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit. Politikat si dhe strategjitë zhvillimore të institucionit udhëhiqen nga respektimi i parimeve të lirisë akademike në veprimtarinë mësimore dhe atë shkencore. Gjithashtu parashikimet në aktet e brendshme rregullatore hartohen në zbatim të legjit për arsimin e lartë si dhe kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Në përputhje me ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale, publikimi i rezultateve që vijën nga procesi i vlerësimit të programeve të studimit merr në konsideratë edhe parimin e mbrojtja së privatësisë. Ndonëse raportet vjetore të NJSBC

	shapallen publikisht, publikimi i referohet konkluzioneve dhe rekomandimeve të natyrës së përgjithshme që i referohen treguesve të cilësisë. Rezultatet e sondazheve dhe vlerësimit të studentëve për secilin nga pedagogët transmetohen në rrugë zyrtare. <i>Evidenca nr 14. "Rregullorja e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet vjetore që hartohen nga strukturat kompetente të vlerësimit të cilësisë si dhe raportet e vlerësimit periodik të veprimtarive kanë pjesë të formatit të tyre edhe konkluzionet që evidentohen nga analiza e treguesve të cilësisë. Në përmbajtjen e këtyre raporteve evidentohen rezultatet që vijnë nga vlerësimi i treguesve të cilësisë, elementët cilësorë dhe mangësitë e konstatuara, si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë në institucion. Raporti vjetor i NJSBC përmban gjithashtu konkluzionet dhe rekomandimet për marrjen e masave për korrigjimin e mangësive. Ky raport përmban edhe analizën SWOT, pjesë e të cilës janë pikat e forta, pikat e dobta dhe rekomandimet që evidentohen nga pyetësorët dhe instrumentat e tjerë të cilësisë. Këto raporte u bëhen të njohura strukturave përkatëse drejtuese dhe më tej, shërbejnë për hartimin e planeve të masave me qëllim përmirësimin e komponentëve të cilësisë. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 45 "Plani vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 74 "Plani i veprimtarive akademike shkencore 2022-2023, 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 75 "Plani i aktiviteteve për përmbushjen e rezultateve të pyetësorëve në kuadrin e aktiviteteve të përmirësimit të cilësisë"</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	KUB vlerëson dhe mundëson e efektivitetin e veprimtarive të ndërrmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë për të përmirësuar

efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	komponentët e cilësisë së programit. Përmirësimi i treguesve të cilësisë është pjesë e objektivave strategjike të KUB. Institucioni evidenton gjetjet që rezultojnë nga veprimtaritë e monitorimit të cilësisë dhe mer masat për përmirësimin e cilësisë. Për këtë qëllim, KUB miraton akte të posaçme në formën e planeve zhvillimore strategjike ku evidentohet vizioni i përmirësimit të cilësisë si dhe planeve të masave ku pasqyrohen hapat konkrete për përmirësimin e cilësisë. Në aktet ku pasqyrohen masat për përmirësimin e cilësisë, përcaktohen edhe kompetencat dhe roli i strukturave në zbatimin e masave për përmirësimin e cilësisë së programit. Në këtë proces, si njësi përgjegjëse për zbatimin e këtij programi studimi, një rol thelbësor luan Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca 2.2 "Plani Strategjik i zhvillimit të programit të studimit 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 31 "Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, viti akademik 2022-2023, 23-24"</i> <i>Evidenca nr 75 "Plani i aktiviteteve për përmbushjen e rezultateve të pyetësorëve në kuadrin e aktiviteteve të përmirësimit të cilësisë"</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	KUB përdor mekanizma të informimit të studentëve dhe stafit akademik mbi politikat e vlerësimit të cilësisë dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në procedurat e sigurimit të cilësisë. Konkluzionet që evidentohen nga raportet vjetore të NJSBC diskutohen në mledhjet e departamenteve. Nga ana tjetër, publikimi në faqën zyrtare të planeve strategjike si dhe raporteve të NJSBC i shërben jo vetëm transparencës, por edhe informimit në një shkallë të gjerë të personelit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ mbi veprimtaritë e ndërrmara në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, dhe masat e nevojshme për përmirësimin e cilësisë. Njohja me këto raporte rrit ndërgjegjësimin mbi përgjegjësitë dhe rolin e personelit akademik dhe studentëve në përmirësimin e treguesve të cilësisë. Informimi i studentëve dhe stafit akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë mundësohet edhe nëpërmjet përfaqësimit të

	tyre në organet e vlerësimit të cilësisë si, NJSBC apo Senati Akademik. Në përbërjen e NJSBC dhe Senatit Akademik të KUB ka në përbërje anëtarë të personelit akademik si dhe përfaqësues të studentëve. Përfaqësimi i tyre në këto struktura mundëson shprehjen e mendimit mbi cilësinë e programit të studimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në procesin e sigurimit të cilësisë. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, 22-23, 23-24"</i> <i>Evidenca nr. 59.1 "Raporti i IQE për staf akademik 2023"</i> <i>Evidenca nr. 59.4 "Raporti i IQE për studentët 2023"</i>			
Konkluzione	<i>KUB harton plane strategjike, politika të zhvillimit të cilësisë si dhe raporte vjetore që i referohen veprimtarive në kuadrin e vlerësimit të cilësisë që janë transparente dhe bëhen publike për të interesuarit.</i> <i>Institucioni vlerëson efektivitetin e veprimtarive të ndërrmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit, si dhe merr masat për përmirësimin e cilësisë.</i> <i>Institucioni përdor mekanizma të informimit të studentëve dhe personelit akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimin të tyre mbi përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të Integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave në: "Drejtësi",

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. KUB ofron një larmishmëri programesh studimi duke mundësuar një ofertë të gjerë akademike për studentët në fusha të ndryshme të specialiteteve në përputhje me tendencat e tregut të punës dhe kërkesat e punëdhënësve;
2. KUB mundëson kapacitetet e nevojshme infrastrukturore për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në këtë program studimi, si dhe paisjen e tyre me mjetet e nevojshme teknologjike për realizimin e procesit mësimor përmes përdorimit të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies;
3. KUB ka strategji të qarta si dhe ka ngritur instrumentat e duhur efektivë për vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të gjithë komponentët e cilësisë dhe aspektet e veprimtarive akademike;
4. KUB mundëson kontributin e studentëve në proceset e rëndësishme vendimmarëse që lidhen me veprimtarinë akademike dhe garantimin e standarteve të cilësisë, si dhe përditësimin dhe përmirësimin e programit të studimit;
5. Institucioni nxit kërkimin shkencor dhe mbështet veprimtarinë akademike të stafit akademik nëpërmjet një sërë formash si: pjesëmarrja e stafit në aktivitete shkencore brenda apo jashtë vendit, pjesëmarrja në projekte, programe mobiliteti si dhe financim të punimeve shkencore;

b. Pika të dobëta:

1. Në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi janë angazhuar, ndonëse në një numër të vogël, edhe staf akademik të kategorisë "Master i Shkencave", çka nuk përputhet me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik të nevojshëm për angazhimin akademik në këtë cikël studimi. (*Standarti I.2, Kriteri 1; Standarti IV.1. kriteri 1*)
2. Numri i vogël i stafit akademik të brendshëm të Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, i cili vetëm me 8 pedagogë mbulon përpos tre programeve të studimit në fushën e drejtësisë edhe 2 programe në fushën e shkencave sociale. Numri i vogël i stafit mbart rrezikun e mospërmbyshjes në të ardhmen të detyrimeve të programit dhe cënimit të cilësisë; (*Standarti II.2, Kriteri 1*)

Rekomandime:

1. Institucioni të marrë masat e nevojshme për të mundësuar që i gjithë stafi akademik që përfshihet në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”, në përputhje me nenin 59/6 të Ligjit Nr. 80/2015 i cili kërkon që: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”*;
2. Rekomandohet që, në rastet kur personeli akademik mbulon më shumë se sa një lëndë mësimore/modul, ngarkesa të mundësojë mbulimin e lëndëve që kanë natyra, veçori, dhe fusha studimore të përafërta dhe përputhen me fushën akademike kërkimore të personelit akademik që mbulon këto lëndë/module;
3. Rekomandohet të shtohet stafi i brendshëm i këtij Departamentit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale për të krijuar kushte optimale për të ofruar programin e integruar 5 vjeçar të drejtësisë;
4. Sugjerohet që IAL të sigurojë dhe ofrojë periodikisht programe trajnimi për stafin akademik të tij, me qëllim për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik;
5. Nga IAL (KUB) njësia bazë dhe njësia kryesore të hartohet dhe miratohet një udhëzues i plotë për procedurat, afatet dhe modelet e dokumentave që duhet të hartojë studenti për të plotësuar detyrimet e praktikës profesionale, sipas kërkesave të planit mësimor. Në këtë udhëzues duhet të përmbahen të gjitha modelet dhe formatet standarte: *Kërkesa drejtuar institucionit/entit privat për kryerjen e praktikës profesionale; Raporti i studentit praktikant; Raporti i institucionit/entit pritës për rezultatet e studentit; Raporti i vlerësimit të pedagogut udhëheqës, etj*;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Integrated Second Level Program in “Law”

a. Strengths and affirmations:

1. KUB offers a variety of study programs, enabling a wide academic offer for students in different fields of specialization in accordance with labor market trends and employer requirements;
2. KUB provides the necessary infrastructural capacities for the development of teaching activities in this study program, and has enabled their equipment with the necessary



technological tools for the implementation of the teaching process through the use of contemporary teaching methodologies;

3. The institution has clear strategies and has established appropriate and effective instruments for continuous quality assessment in all quality components and aspects of academic activities;
4. KUB enables student input into important decision-making processes related to academic activity and the guarantee of quality standards, as well as the updating and improvement of the study program;
5. The institution promotes scientific research and supports the scientific activity of academic staff through a number of forms such as: staff participation in scientific activities within or outside the country, participation in projects, mobility programs, and funding of scientific works;

b. Weaknesses:

1. In the teaching process in this study program, although in a small number, academic staff of the Msc category have also been involved, which does not comply with the legal requirements in force for the appropriate level of academic qualification necessary for involvement in the teaching process in this study cycle; (*Standard I.2., criterion 1; Standard IV.1. criterion 1*)
2. The small number of internal academic staff of the Department of Justice and Social Sciences, which with only 8 lecturers covers, in addition to the law study programs, even two social sciences programs. The small number of staff carries the risk of failing to meet program obligations and compromising quality in the future; (*Standard II.2, Criterion 1*)

Recommendation

1. The external evaluation team recommends that the institution take the necessary measures to enable that all academic staff involved in the teaching process in this study program, to have at least the "Doctor" scientific degree in accordance with Article 59/6 of Law No. 80/2015 which requires that: "Academic staff engaged in teaching must have at least the qualification of the next cycle";
2. The external evaluation team recommends that in cases where academic staff covers more than one subject/module, the teaching load should enable the coverage of subjects that have similar nature, characteristics, and fields of study and are consistent with the academic research field of the academic staff covering these subjects/modules;



3. It is recommended that the full time staff number of the Department of Law and Social Sciences to be increased, in order to create optimal conditions to offer the 5-year integrated law program;
4. It is suggested that the HEI periodically provide and offer training programs for its academic staff, in order to improve the didactic competencies and advance the capacities of the academic staff;
5. The HEI (KUB), the Department and the Faculty should draft and approve a complete guide for the procedures, deadlines and models of documents that the student must draft to fulfill the obligations of professional practice, according to the requirements of the curriculum. This guide should contain all the standard models and samples such as: *The request addressed to the institution/private entity for the performance of professional practice; The report of the intern student; The report of the host institution/entity on the student's results; The evaluation report of the supervising pedagogue, etc;*



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X